


Anketë
Universitetet
me mungesa
elementare

Fq.4



LIRITË
FETARE
DASH
përmend
xhaminë e Prilepit

Fq.5



Nuk jemi
favoritë në
Botërorin
e Rusisë

MESI

Fq.22



Koha

www.koha.mk



Pse Sarkozy e
vrau Gadafin

Fq.17

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3377 · E enjte, 31 maj 2018

14°C | 29°C

15 DEN

EDITORIAL

Në xhunglën
e iluzioneve
tona



Shqiptarët në Maqedoni, sa i përket çështjes së emrit të shtetit, nuk mundën të sillen politikisht ndryshe dhe emocionalisht ndryshe. Ka një tendencë për shkapërdhje energjish dhe ka një prirje që pakënaqësitë tona ti kanalizojmë gabimisht, duke krijuar një kontra-alibi kujdestare për çdo rast që nuk na konvencionon. Gjithsesi kjo çështje mjaft e mprehtë nuk...

Fq.2

RAJON

EULEX-i nuk
do t'i mungojë
askujt

Fq.14

GLOBI

Izraeli njofton:
Jemi në prag
lufte me
Gazën

Fq.15

FORUM

Javë e bukur

Fq.10



RATIFIKIM NË PARLAMENT, PASTAJ REFERENDUM

ZGJIDHJA FINALE

PARA SAMITIT

TË NATO-s?



Kryeministri Zaev siguroi se marrëveshja me Greqinë do të ratifikohet në Parlament, ndërsa më pas e njëjta do t'i nënshtrohet referendumit. E gjitha kjo, sipas tij, me qëllim që Greqia ti dërgojë shkresë NATO-s para Samitit në korrik, kur edhe pritet që Maqedonia të merr ftesë për anëtarësim

Fq.3

Borxhet drejt linjës së kuqe!

Shkup, 30 maj - Gjatë tre viteve të ardhshme Maqedonia do të duhet të futet në borxhet të reja në vlerë të përgjithshme prej 2.3 miliard, ndërsa për të njëjtën periudhë shteti duhet të kthejë borxh të vjetër në vlerë prej 1.5 miliard euro, për borxhin bazë dhe 500 milion euro kamata. Kështu thuhet në "Strategjinë fiskale të Republikës së Maqedonisë 2019-2021", të publikuar nga Ministria e Financave. Në këtë stra-

tegji përveç që parashihet rritje rrogash, rritje e konsumit personal, rritje të Bruto Prodhimit Vendor parashihet dhe rritja e borxhit publik që të mundet Maqedonia në kohë të kthejë borxhet e vjetra, të paguaj kamatat si dhe të realizojë investimet e planifikuara. Njëherësh parashihet dhe dhënia e eurobligacionit të ri në tregun e jashtëm financiar. Sipas paralajmërimeve deficitit buxhetor gjatë...

Fq.7



EDITORIAL

NË XHUNGLËN E ILUZIONALEVE TONA



Emin AZEMI

Shoqëria shqiptare asnjëherë nuk do të mund t'i mbyllë dilemat nëse udhëhiqet prej iluzionistëve të cilët mendimet e tyre të ngatërruara i paraqesin si vizion i së ardhmes. Fatkeqësisht iluzionistët të tillë ka plotë, por ka pak pragmatikë që dinë çka duan dhe nuk bëhen trungje të prera në rrugët e proceseve

Shqiptarët në Maqedoni, sa i përket çështjes së emrit të shtetit, nuk mundin të sillen politikisht ndryshe dhe emocionalisht ndryshe. Ka një tendencë për shkapërderdhje energjish dhe ka një prirje që pakënaqësitë tona ti kanalizojmë gabimisht, duke krijuar një kontra-alibi kujdestare për çdo rast që nuk na konvenon. Gjithsesi kjo çështje mjaft e mprehtë nuk lejon shumë romantizëm në qasje, ashtu siç po krijohet përshtypja kur lexon njeriu lloj-lloj reagimesh për dhe kundër. Është shumë e logjikshme që tema të tilla të mëdha asnjëherë të mos prodhojnë një konsensus maksimal, por duhet të ekzistojë një masë kritike që e determinon zgjidhjen, me kusht që ajo të mos jetë e dëmshme.

Krijohet përshtypja se kakofonia e reagimeve tona, më shumë po e dëmton se sa po e ndihmon procesin. Çdo kush prej nesh po të ishte në vend të politikanëve, do ta kishte vështirë të vendos për çfarëdo zgjidhjeje, për arsye se ambientin që ne po e krijojmë është kontraproduktiv, kurse xhungla e mendimit tonë publik e frikëson edhe derrin e egër, e jo më cilindo politikan vullnetmirë.

Reagimet e mediave maqedonase, përkitazi me çështjen e emrit, kanë një dinamikë mendimesh që lëvizin nga njëri ekstrem në tjetrin, mirëpo atje, megjithatë, kultura e presionit publik nuk e dëmton procesin. Kjo është kështu, sepse, për dallim nga opinionin publik shqiptar i cili është shumë hermafrodit, në anën tjetër, opinionin publik maqedonas ndahet në dy sfera kryesore ideologjike dhe brenda këtij korpusi divergjencash politike zhvillohen edhe betejat ideologjike. Vetëm te shqiptarët konfrontimet politike kuptohen si tragjedi kombëtare, prandaj edhe nuk mund të vijmë te një kompromis pragmatik që do të kënaqte pak a shumë palët. Prija për të qenë non-stop kritizues por pa sensin e duhur të kritikës objektive, ia humbë pikët morale çfarëdo lloj argumentimi. Shikojeni skenën politike të shqiptarëve. Atje të pakënaqurit e paradites, i ke pushtetarë të pasdites, kurse opozitarizmi vjen në shprehje vetëm atëherë kur dështon ambicia për të qenë pjesë e pushtetit. Opozitarët e djeshëm, sot i ke çuna të shkapërderdhur nëpër livadhin e gjerë të kauzave, ndërkohë që kryebaloshi i qeverisë si ujk i kërlëshur fut nën sqetull qengjin e uritur për pushtet.

Si ta kemi ne një qëndrim unik rreth çështjes së emrit të shtetit, kur ende parapëlqejmë të luajmë vallen "njëri thumbit, tjetri patkoit". Ato pak autoritete morale që janë brenda shoqërisë shqiptare, ose janë lodhur në rrugëtimin e tyre për të unifikuar mendimin dhe veprimin politik, ose nuk kanë arritur t'i kontekstualizojnë diskutet e tyre publike në rrafshin e politikave vendimmarrëse.

Do të ishte tepër utopike të mendojmë se çdo shoqëri funksionin mbi parimet e një koherence perfekte të brendshme. Mirëpo, iluzioni i pritjeve asnjëherë nuk do të shuhej, sidomos kur në shoqëri ka të hapura më shumë se një dilemë. Shoqëria shqiptare asnjëherë nuk do të mund t'i mbyll dilemat nëse udhëhiqet prej iluzionistëve të cilët mendimet e tyre të ngatërruara i paraqesin si vizion i së ardhmes. Fatkeqësisht iluzionistët të tillë ka plotë, por ka pak pragmatikë që dinë çka duan dhe nuk bëhen trungje të prera në rrugët e proceseve.

KEQ E KENI HANGËR KEPËN

"Ma lire kish' kushtu sikur te ish pagu një ushtri mercenare me luftu gjatë viteve të 90'ta për Kosovën. I kishin marr paret me vakt, ishin shku, edhe mo s'kishi ni as për veteranë, as për deti, as për komandanta e as për epopeja të paqena. Ish harru ajo punë motiit.

Tashti keni me na pas n'qaf sa t'kemi jetë ne veteranët. E jetë besoj kemi me pas, se kogja t'ri jemi e nuk jetojmë fort keq. Plus s'keni me pas qare pa i ngu edhe tregimet tona heroike si të filmave që i prodhon Marvel Studio. Plluuss, tash edhe n'deti. Jetë o jetë... Keq e keni hangër kepën...", ironizon në profilin e tij në Facebook, gazetari Ilir Mirena, lidhur me kërkesën e veteranëve të UÇK-së së Kosovës për ndarjen të mjeteve financiare nga buxheti i Kosovës për pushimet verore e veteranëve.



NJË KRYEMINISTËR SI MAHATIR MUHAMED

"Në moshën e tij 93 vjeçare populli e kthen në pushtet. Mahatir Muhamed kishte udhëhequr vendin nga viti (1981-2003), ngriti Malajzinë dhe e renditi ndër shtetet më të zhvilluara të botës. Pas tij filloi degjenerimi dhe korrupsioni. Populli e riktheu në postin e kryeministrit në moshën e tij shumë të thyer. Vetëm pas 5 ditëve në pushtet, arkës së shteti ia ktheu 50 miliard \$ pasi kishte burgosur ish kryeministrin Nexhib Ibrahim dhe 9 ministra. Ai po këtë ditë burgosi personalitetet më të korruptuara të vendit. Nën akuzën e korrupsionit burgosi 144 biznesmenë, 50 gjykatës, 200 policë. A thua vendi shqiptarëve në kujtesën e tij ka një njeri si ky!? Nëse jo, pse nuk e ka...? A thua populli nuk mund ta gjejë...!? Jo, jo ai është, por ai nuk gjendet ndër shtresat e larta të elitave tona politike", shkruan në profilin e tij në Facebook, dr.Muhamed Kajolli.



SHQIPTARËT FAKTORË STABILIZUES

"Deklarata e MPJ të Greqisë flet për përfundimin me suksese të bisedimeve greko-maqedonase për ndërrimin e emrit të Maqedonisë dhe anëtarësimin e saj në NATO brenda vitit 2018. Marrëveshja u arrit fal diplomacisë të SHBA dhe mbështetjes pa rezerva të Shqipërisë, të votave të shqiptarëve në Maqedoni duke votuar për Zaevin dhe qeverinë e tij. Edhe njëherë u vërtetua se shqiptarët janë faktor stabilizues dhe përcaktues për të ardhmen e sigurt të Maqedonisë. Në të ardhmen do ketë shumë befasisarsh për politikanët e Maqedonisë", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, historian Arben Llalla.



MEDIACitate

ARRESTOHEN SHQIPTARËT NË SPANJË, VODHËN SHTËPINË E SUAREZIT

Policia katalanase ka vënë në pranga një grup kriminal të cilët kishin kryer më shumë se 30 vjedhje ndërtesash në Barcelonë, përfshi dhe shtëpinë e yllit të futbollit Luis Suarez.

Tetë prej tyre janë shqiptarë, thotë "El Pais", dhe ishin pjesë e një grupi që rekrutoni patriotët e tyre duke i strehuar dhe në këmbim u kërkoni të vidhnin shtëpi. Agjentët ranë në gjurmët e grupit të shqiptarëve që në tetor, dhe mësohet se ata vidhnin shtëpi të shtrenjta larg qendrave të qytetit dhe për këtë përdornin makina të vjedhura, ose ecnin në këmbë për orë të tëra, e prisnin në pyll momentin e duhur, thotë "El Pais".

Sipas policisë, grupi i kapur konsiderohen hajdutë të specializuar pasi merrnin masa paraprakisht dhe zgjidhnin me kujdes "prezë" e tyre. Në janar të këtij viti ata vodhën shtëpinë e futbollistit të Barcelonës Luis Suarez, duke hyrë në vilën e tij në Castelldefels, pa e ditur në fakt se ajo ishte shtëpia e futbollistit, thotë "El Pais", duke vjedhur një sasi bizhuterish me vlerë.

(El Pais, 30 maj)

KOSOVA HEQ ROAMING-UN ME SHQIPËRINË

Në seancën e djeshme të Kuvendit të Kosovës, deputetët votuan një rezolutë për heqjen e tarifave të roaming-ut në telekomunikim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Rezoluta është propozuar nga grupi parlamentar i Partisë Social-demokrate. Dardan Molliqaj, nga kjo parti, tha se heqja e roaming-ut me Shqipërinë do të rrisë komunikimin mes vendeve dhe do të ulë koston e shpenzimeve të qytetarëve të Kosovës.

(MIA, 30 maj)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KU NDODHET ZAGORIA?

Zagoria (Tejmali) është zonë gjeografike dhe etnografike në rrethin e Gjirokastrës. Kufizohet nga mali i Dhëmbelit në lindje dhe i Lunxhërisë në perëndim. Është e ndërtuar nga flishi paleogjenik që formon një sinklinal dytësor në trajtë lugine në brezin antiklinal të Beratit. Lugina ka fund të ngushtë dhe shpate të pjerrëta. Përmes saj rrjedh lumi i Zagorisë (degë e Vjosës). Në krahuin e djathtë të shtratit të



lumi dalin një sërë burimesh karstike. Mbulesa pyjore është e rrallë. 9 fshatra të vendosura në të dy anët e luginës deri në lartësinë 800 m, përbëjnë fshatin e bashkuar Nivan.

KORNIZA E MARRËVESHJES PËR EMRIN

“Republika e Maqedonisë Veriore” me siguri është emri i dakorduar nga korniza e cila janë marrë vesh Dimitrov dhe Kocias për arritje të zgjidhjes për emrin. Korniza e kontraktuar mes dy ministrave parasheh edhe planin për mbyllje përfundimtare të kontestit, i cili përbëhet prej 11 hapave, ndërsa e cila pritet të jetë e verifikuar nesër nga kryeministrat Zaev dhe Cipras në bisedën telefonike, që do të ishte hyrje për takimin e tyre në Prespë për zyrtarizim të marrëveshjes së arritur.

- Maqedonia në qershor do të marrë date për fillim të bisedimeve me Bashkimin Evropian, me ose pa marrëveshje përfundimtare për emrin me Greqinë. Pa marrëveshje përfundimtare të arritur deri në Samitin e BE në qershor, datën për fillim të bisedimeve Brukseli do ta kushtëzonte me arritje përfundimtare të marrëveshjes për emrin deri në dhjetor.

- Referendumi në lidhje me qëndrimin për emrin e ri do të mbahej në muajin shtator ose tetor, ndërsa 8 shtatori është data e cila shqyrtohet si termin për referendumin. - Të dyja palët obligohen të zyrtarizojnë marrëveshjen, Zaev duhet dokumentin ta parashtrijë deri në Parlamentin e Maqedonisë për votim, por jo me dy të tretën e shumicës. Pasi marrëveshja të fitojë dritën jeshile nga ana e Parlamentit të Maqedonisë, Greqia përmes letrës do të informojë NATO-n se miraton anëtarësimin e Maqedonisë në Aleancë, por me kusht që të bëjë ndryshime kushtetuese.

- Hapi i ardhshëm do të ishte 28 dhe 29 qershori, në Samitin e BE-së, Maqedonia të marrë datën për bisedime me Unionin, pas çka më 11 dhe 12 korrik do të merrte ftesën zyrtare për anëtarësim në NATO në Samitin e Aleancës në Bruksel.

- Hapi i ardhshëm do të ishte Maqedonia në shtator të mbajë referendum për emrin e ri, pas çka Parlamenti i Maqedonisë do të duhet me dy të tretën e shumicës të miratojë ndryshimet kushtetuese.

- Pas referendumit dhe revizionit të Kushtetutës së Maqedonisë, sipas planit, marrëveshja duhet t'i dorëzohet Parlamentit grek për ratifikim.

Kryeministri Zaev siguroi se marrëveshja me Greqinë do të ratifikohet në Parlament, ndërsa më pas e njëjta do t'i nënshtrohet referendumit. E gjitha kjo, sipas tij, me qëllim që Greqia ti dërgojë shkresë NATO-s para Samitit në korrik, kur edhe pritet që Maqedonia të merr ftesë për anëtarësim

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 30 maj - Kryeministri Zoran Zaev të mërkurën gjatë një konference për gazetarë bëri të ditur se procesi rreth zgjidhjes së emrit po shkon drejt fundit. Duke pranuar faktin se ende nuk është arritur një marrëveshje konkrete me shtetin fqinj Greqinë, Zaevi konfirmoi se përmes ministrave të Punëve të Jashtme të të dyja vendeve, është arritur korniza e parimeve formale që do të çojë drejt zgjidhjes së emrit. "Ministrat e Jashtëm të dy shteteve janë dakorduar për parimet formale të zgjidhjes, ndërkohë që do të kem një bisedë telefonike me kryeministrin Cipras gjatë ditëve të ardhshme. Kjo është shumë e rëndësishme. Po punohet aspekti formal juridik se si do të implementohet marrëveshja eventuale", theksoi Zoran Zaev.

RATIFIKIM NË PARLAMENT PARA SAMITIT TË NATO-S

Ai dha siguri se marrëveshja me Greqinë do të ratifikohet në Parlament, ndërsa më pas e njëjta do t'i nënshtrohet referendumit. E gjitha kjo, sipas Zaevit, me qëllim që Greqia ti dërgojë shkresë NATO-s para Samitit në korrik, kur edhe pritet që Maqedonia të merr ftesë për anëtarësim. "E dini se në Maqedoni të gjithë qëndrojmë pas referendumit dhe Greqia ka për këtë mirëkuptim, është e logjikshme të vendosen hapat e realizimit të marrëveshjes eventuale. Ratifikim para referendumit që të mund Greqia t'i dërgojë shkresë NATO-s, të marrim ftesë për në NATO, qoftë edhe një muaj më parë. Gjithsesi, ratifikimi i marrëveshjes është ratifikim i diçkasë pas së cilës qëndrojnë dy Qeveritë dhe me gjasë - edhe shumica parlamentare. Shpresoj që të jetë shumicë e madhe parlamentare, bashkë me opozitën", deklaroi Zaevi. Ai është përgjigjur edhe në pyetjen e reagimit të Ivanovit, i cili tha se nuk është i informuar për atë se çka ndodhë rreth emrit. "Për gjitha detajet se ku kemi arritur Ivanov është i informuar në takimin e liderëve. Për takimet e reja në Nju Jork dhe Bruksel, ministri që sot do të kërkojë takim me Ivanovin që ta informojë se ku kanë arritur me bisedimet me ministrin e jashtëm grek. Kjo është risia e procesit negociues, ndërsa qytetarët e dinë se

ZAEVI PARALAJMËRON RATIFIKIM NË PARLAMENT, PASTAJ REFERENDUM

ZGJIDHJA FINALE PARA SAMITIT TË NATO-S?



IVANOVI NUK PRANON ERGA OMNES PËR EMRIN

Për presidentin Gjorge Ivanov, nuk është pranueshme zgjidhja për emrin erga omnes, kumtuan dje nga kabineti i presidentit të Republikës së Maqedonisë. "Qëndrimi i presidentit Ivanov është parimor, ndërsa njëherit edhe konzistent me qëndrimet e të gjithë presidentëve të deritanishëm të Republikës së



Maqedonisë. Ky qëndrim është se presidenti Ivanov nuk pranon zgjidhje për çështjen e emrit për përdorim të përgjithshëm ose erga omnes", qëndron në kumtesën e Kabinetit të Ivanovit. Njëherësh, nga atje informojnë se shefi i shtetit gjatë ditës së sotme do ta pritë ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov.

pason bisedë mes meje dhe kryeministrin Cipras dhe menjëherë pas kësaj, do ti informojë institucionet adekuate, liderët dhe presidentin Ivanov", ka thënë Zaev.

Ai ka potencuar se në negociatat për emrin nuk ka ndryshime të historisë maqedonase. "Asnjëherë më afër zgjidhjes s'kemi qenë, kurse miqësia ndërmjet dy vendeve asnjëherë s'ka qenë më e madhe. Gjuha maqedonase është e vërtetuar, identiteti është vërtetuar, nuk është e lehtë kjo çështje", është shprehur Zaevi, ndërsa ka shtuar se Maqedonisë i duhet leadership për hapat e ardhshme, dhe jo vetëm fjalë boshe. Më tej, ka thënë Zaev, patriotët të vërtetë janë ata që i si-

gurojnë ardhmëri qytetarëve të Maqedonisë pas zgjidhjes së çështjes së emrit. Por, gjatë konferencës për shtyp enkas për njëvjetorin e qeverisjes së tij, Zaevi nuk deshi të tregojë nëse propozimi "Republika e Maqedonisë Veriore" do të jetë zgjidhja finale për emrin e shtetit. Jo zyrtarisht flitet se në Prespë të Maqedonisë do ketë takim mes dy kryeministrave ku do të kumtohet dhe nënshkruhet marrëveshja përfundimtare për emrin e shtetit.

MICKOVSKI ANKOHET SE NUK INFORMOHET NGA ZAEV

Pikërisht nga Prespa, lideri i VMRO-së, Hristijan Mickosvki, të

mërkurën ka adresuar kritika të forta ndaj kryeministrin Zoran Zaev. Ai ka thënë se për negociatat që zhvillon Qeveria për emrin e shtetit, informohet nga mediat. "Këto janë spekulime gazetarske, gjysmë informacione, gjysmë të vërteta.

Ne jemi jashtë procesit, tërësisht jemi të shqyçur nga çfarëdo loj informacioni, ajo që më së shumti e marrim si informacion është nga gazetarët dhe shkrimet e tyre dhe ajo që fqinji ynë jugor e liferon si lajm. Prespa është qytet në Maqedoni, ku ka një liqen të shkëlqyer", tha Mickoski para të pranishmëve në tubimin partiak në Manastir.

CIPRAS: NEGOCIATA TË RËNDA, POR TË DOMOSDOSHME PËR EMRIN

Vërehet perspektiva për zgjidhjen e emrit, tha kryeministri grek Aleksis Cipras në fjalimin në Parlamentin e përgjithshëm vjetor të Federatës së Ndërmarrjeve të Greqisë. Duke folur për rolin e Greqisë si shtyllë e stabilitetit të Ballkanit, Cipras si shembull e përmendi "perspektivën për zgjidhje që vërehet në negociatat e rënda, por të domosdoshme me IRJM-në", njoftoi korrespondentja e MIA-s nga Athina. "Negociata me të cilat



menaxhuam dhe vazhdojmë të menaxhojmë me ndjenjën e përgjegjësisë dhe patriotizmit. Por, edhe me vendosmëri dhe besim në nevojën për gjetjen e zgjidhjes", tha Cipras. Kryeministri grek theksoi se pasqyra për Greqinë në planin ndërkombëtar ngadalë po ndryshon dhe po përforcohet, por për atë nevojiten vendime të rënda dhe të guximshme. Mund të arrihet nëse lihet anash çmimi politik, ndërsa të merret parasysh interesi i vendit.

Edhe një parti shqiptare, LSHD me seli në Tetovë

Tetovë, 30 maj - Para një kohe kanë përfunduar edhe procedurat teknike që partia më e re të marrë edhe dritë jeshile nga Gjykata Themelore në Tetovë. Kështu, Lëvizja për Shtet dhe Drejtësi (LSHD) pas grumbullimit të nënshkrimeve njofton se është regjistruar si parti politike në regjistrin e partive të tjera që veprojnë në Maqedoni. "Në bazë të kërkesës së një grupi të qytetarëve, shtetas të Maqedonisë, të deponuar në gjykatë më datë 13 prill të këtij viti për regjistrimin e subjektit politik 'Lëvizja për Shtet dhe Drejtësi', me vendimin gjyqësor më 2 maj i njëjti subjekt është regjistruar me të drejtë veprimi në skenën politike të Maqedonisë. I njëjti vendim nga ana e gjykatës, më datë 17 maj i është dorëzuar personit të autorizuar të subjektit politik LSHD", ka bërë të ditur shërbimi për informim në këtë parti. Me këtë rast, Kryesia e kësaj partie ka bërë edhe përgatitjet e fundit për promovimin publik të subjektit, ndërkohë pritet caktimi i datës dhe vendit të promovimit nga ana e "Këshillit të Pleqve", që është përbërë nga anëtarë brenda dhe jashtë shtetit, si organ më i lartë partiak që qëndron mbi Kryesinë e subjektit dhe vet kryetarin e saj. "Në ndërkohë, njoftojmë se subjekti politik 'Lëvizja për Shtet dhe Drejtësi', do të jetë me seli në Tetovë, ndërsa subjekti është caktuar që ti prijë Adnan Abdullah-Voka nga Tetova", bëjnë të ditur nga LSHD. (U.H)

Rreth 60 për qind e studentëve të anketuar nga UNSH-ja e kanë përshkruar si "shumë të dobët" gjendjen me bibliotekat, mbi 50 për qind janë të pakënaqur sa i përket çështjes me pajisjet kompjuterike, ndërsa nuk është aspak e vogël përqindja e atyre që shprehen të pakënaqur me kushtet e sallave në të cilat zhvillohen ligjëratat dhe provimet

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 30 maj - Nuk janë vetëm librat dhe profesorët ata që ndikojnë në krijimin e perceptimeve mbi cilësinë e studimeve, pavarësisht rolit kyç që kanë të dyja këto elemente në performansën akademike të institucioneve të arsimit të lartë. Jo më pak të rëndësishme janë kushtet e studimit, në rastin konkret posedimi i laboratorëve, kabineteve dhe pajisjeve të teknologjive të ndryshme. Mungesën e këtyre kushteve në shumë universitete nuk kanë se si mos ta vërejnë studentët. Madje, sikurse del nga një anketë e realizuar kohë më parë nga ana e Unionit të Studentëve Shqiptarë (USSH), mungesat në fjalë konsiderohen si problem dhe pakënaqësi në perceptimin e studentëve mbi gjendjen në përgjithësi të universiteteve ku ata studiojnë. Kështu, rreth 60 për qind e studentëve shqiptarë e kanë përshkruar si "shumë të dobët" gjendjen me bibliotekat, mbi 50 për qind janë të pakënaqur sa i përket çështjes me pajisjet kompjuterike, ndërsa nuk është aspak e vogël përqindja e atyre që shprehen të pakënaqur me kushtet e sallave në të cilat zhvillohen ligjëratat dhe provimet.

Të lutur të japin mendimin rreth gjendjes së sallave ku zhvillohen ligjëratat, 48 për qind e të anketuarve i përshkruajnë sallat

SIPAS ANKETËS SË UNIONIT TË STUDENTËVE SHQIPTARË

UNIVERSITETET ME MUNGESA ELEMENTARE



në "gjendje të mirë", 38.7 për qind në "gjendje jo të mirë", ndërsa 14.2 për qind thonë se "nuk ka kushte për zhvillim të ligjëratave". Po kaq shqetësuese sa është masa që ka dhënë përgjigjen e fundit, është edhe masa ende më e madhe e atyre që në pyetjen vijuese thonë se institucioni ku ata studiojnë, nuk ka pajisje kompjuterike. Pyetjes "Në çfarë niveli është i pajisur universiteti juaj me pajisjet kompjuterike" i janë përgjigjur me "nuk ka fare" hiç më pak se 25.7 për qind e studentëve. Po kaq, pra 25.7 për qind janë përgjigjur me "shumë dobët", 30.4 për qind me "mesatare" dhe vetëm 18.2 për qind me "shumë mirë". Në pyetjen "Cili është mendimi juaj rreth bibliotekave të disponueshme në universitetet tuaja", vetëm 13.5 për qind pohojnë "shumë mirë". Mbi 28 për qind "mesatar" dhe 58.1 për qind "shumë dobët". Anketa e UNSH-së u realizua kohë më parë në kuadër të aktiviteteve për sensibilizimin e sfidave në arsimin e lartë në Maqedoni, kurse ishin

përfshirë studentë nga Universiteti i Tetovës (28.4 për qind), Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik (36.5 për qind), Universiteti "Kirili dhe Metodi" (23 për qind) dhe nga Universiteti i Evropës Juglindore (8.8 për qind). Mungesa e bibliotekave, pajisjeve kompjuterike dhe kushteve të ngjashme për studime me standarde bashkëkohore, nuk është diçka e panjohur në Maqedoni. Sot e kësaj dite ka universitete, të cilat nuk i posedojnë fare këto kushte dhe qëndrojnë shumë larg detyrimeve ligjore për Standardin e studentëve. Paradoxke të këtyra janë konfirmuar edhe zyrtarisht dhe gjenden lehtësisht dhe në Raportin e Entit Shtetëror të Statistikave për regjistrimin e objekteve dhe pajisjeve të institucioneve të arsimit të lartë në Maqedoni për vitin 2017.

Sipas të dhënave në këtë raport, jo vetëm universitetet private, por edhe ata shtetërorë figurojnë si institucione me mungesa thelbësore në realizimin e studimeve. Universiteti "Apostol Pavle" në Ohër dhe Uni-

versiteti "Nënë Tereza" në Shkup, për shembull, nuk posedojnë fare hapësira me pajisje kompjuterike dhe as leximore. Ose shprehur me numra, si UAP-ja ashtu edhe dhe UNT-ja rezultojnë me zero hapësira kompjuterike. Sakaq, hapësirat e bibliotekave janë vetëm sa për të thënë edhe atë UAP me vetëm 56 metra katrorë dhe UNT-ja me vetëm 20 metra katrorë.

Mirëpo, në mesin e universiteteve me karakter publik, nuk qëndron më mirë as Universiteti i Tetovës, i cili rezulton të ketë vetëm 4 hapësira me pajisje kompjuterike me 294 metra katrorë) 4 biblioteka me 237 metra katrorë dhe 2 leximore me 187 metra katrorë. Në këtë pikë UT-ja qëndron shumë larg Universitetit "Kirili dhe Metodi" në Shkup, i cili sikurse shihet në Raportin e ESHS-së disponon pjesën më të madhe të këtyre hapësirave. Pra, UKM ka 30 hapësira me pajisje kompjuterike me gjithsej 3.956 metra katrorë, 29 biblioteka me 5.272 metra katrorë dhe 14 leximore me 2.958 metra katrorë.

PROMOVHET PLATFORMA PËR KOMUNIKIMIN ONLINE

MEDIAT SOCIALE TË PANJOHURA PËR ORGANIZATAT CIVILE

Shkup, 30 maj - Marrëdhëniet me publikun dhe komunikimi me qytetarët vendosen në plan të dytë në pjesën më të madhe të organizatave joqeveritare në Maqedoni. Sipas të dhënave dhe anketave të kryera, publikimi i materialeve të pjesës më të madhe të organizatave nëpër rrjetet sociale bëhet kryesisht në Facebook, e më pak në Twitter apo tepër rrallë në Instagram dhe LinkedIn, më pak se gjysma i azhurojnë faqet e tyre dy deri në tre herë në javë, dhe vetëm 33 për qind i përditësojnë çdo ditë. Por edhe mëny-

ra dhe cilësia e këtyre formave të komunikimit vihet në pikëpyetje për vetë faktin se më shumë se gjysma e organizatave nuk kanë as sektor dhe as të punësuar që të kujdeset për marrëdhëniet me publikun. Vetëm 10 për qind e organizatave shpenzojnë 500 deri në 1000 euro në muaj për marrëdhëniet me publikun, ndërsa pjesa më e madhe shpenzojnë më pak se 500 euro në muaj. Të dhënat janë publikuar në panelin e organizuar nga Instituti i studimeve të komunikimit me temë "Komunikimi më efikas me

qytetarët përmes mediumeve digjitale", është diskutuar për përfitimet nga marketingu social dhe dilemat etike, si edhe mundësitë që ofrojnë mediumet e reja në aspektin e nxitjes së ndryshimeve shoqërore. Po ashtu i promovua platforma e resurseve online digitakt.mk, si edhe Udhëzuesi për komunikimin sa më efikas me qytetarët përmes mediumeve digjitale.

"Që një organizatë të ndërtojë imazhin e vet, kredibilitetin, perceptimin pozitiv dhe besimin tek ai publik që i intereson duhet të ven-

dosë disa principe të komunikimit efektiv në secilën pjesë të punës së vet. Vetëm përmes komunikimit efektiv organizata mund t'i u përgjigjet të gjitha sfidave dhe ndryshimeve që i sjell interneti dhe teknologjia e reja. Informacioni që duhet të komunikohet nënkupton pranimin, dekodimin e drejtë të mesazheve të caktuara dhe një reagim. Prandaj edhe mesazhi duhet të jetë i qartë dhe i thjeshtë", thuhet në udhëzues. Udhëzuesi ka si qëllim që t'i vijë në ndihmë organizatave civile që të komunikojnë në mënyrë

sa më efektive me publikun përmes mediumeve digjitale, sesi të promovojnë aktivitetet e tyre, projektet dhe iniciativat. Po ashtu udhëzuesi përmban edhe këshilla praktike për të krijuar mesazhe efektive, segmentimin e publikut, si edhe këshilla për përdorimin e atyre mjeteve digjitale adekuate për publik të caktuar, si matet me lehtësi ndikimi i mediumeve sociale dhe sot ë përgatitet një plan për mediumet sociale që do t'i ndihmojë organizatave civile që të afrohen me target grupet e tyre. (E.H)

Departamenti amerikan i Shtetit ka notuar ankimet e Bashkësia Fetare Islame, konkretisht atë se në fshatin Lazhec dhe në Kriva Pallankë, po bëhen bllokime për ndërtimin e xhamive nën presion nga banorët lokalë, si dhe bllokimin e autoritetet lokale për rikonstruimin e xhamisë në Prilep, të djegur gjatë konfliktit të vitit 2001

DEPARTAMENTI I SHTETIT PUBLIKON RAPORTIN PËR DALLIMET FETARE

DASH PËRMEND XHAMINË E PRILEPIT



Washington, 30 maj - Departamenti amerikan i Shtetit e publikoi raportin vjetor për liritë fetare për vitin 2017, në të cilin në pjesën për Maqedoninë ceket se dallimet fetare vazhdojnë të figurojnë në procese penale dhe qytetare gjyqësore. Departamenti i Shtetit e noton procesin e përsëritur kundër peshkopit Jovan Vranishkovski.

"Gjykata themelore Shkup vitin e kaluar e dënoi Vranishkovskin, arqipeshkv i Arqipeshkvisë së Ohrit, për larje parash. Peshkopi u dënua me shtatë muaj burg. Gjykata, gjithashtu, urdhëroi konfirmim të tokës të AO në vlerë prej 140 mijë eurove, që më vonë edhe u krye", ceket në raport. Janë notuar edhe ankimet nga Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni. Për atë se në fshatin Lazhec dhe në Kriva Pallankë, po bëhen bllokime për ndërtimin e xhamive nën presion nga banorët lokalë, të cilët e kundërshtojnë ndërtime.

BFI, gjithashtu, është ankuar se autoritetet vazhdojnë ta bllokajnë rikonstruimin e xhamisë në Prilep, e djegur gjatë konfliktit të vitit 2001. Në raportin për vitin 2017 ceket edhe se Kisha ortodokse e Maqedonisë është ankuar se komuna e Strugës ende nuk ka sjellë vendim për ndërtimin e kishës ortodokse në fshatin Belicë dhe se Komuna e Tetovës ka refuzuar të ndërtojë rrugë deri te kisha e qytetit.

Në raportin e Departamentit të Shtetit më tutje ceket se ambasadori amerikan dhe përfaqësues të tjerë të ambasadës patën takime me përfaqësues qeveritarë dhe parlamentarë, bashkësi fetare dhe organizata nga shoqëria qytetare, me të cilët diskutuan për çështje lidhur me lirinë fetare.

Departamenti i Shtetit festoi 20-vjetorin e miratimit të Ligjit për liri ndërkombëtare fetare. Prej atëherë çdo vit para-

shtrojnë raporte në Kongresin amerikan për mbështetje të lirive dhe të drejtave fetare të qytetarëve nëpër botë, për të cilat SHBA-ja është mbrojtëse e madhe. Me rastin e përvjetorit, sekretari amerikan i Shtetit, Majk Pompeo, këtë verë do të jetë nikoqir i këshillit ministror për mbështetje të lirive fetare ku do të tubohen liderë fetarë, aktivistë për të drejta të njeriut dhe shoqëria civile nga e mbarë bota. (E.H)

26-vjeçari e rrëmben dhe për 10 ditë abuzon seksualisht 16-vjeçaren

Shkup, 30 maj - Një vajzë e mitur nga Shkupi para dhjetë ditësh është rrëmbyer dhe fizikisht është abuzuar në shtëpinë e një burri 26-vjeçar. Siç njoftoi MPB-ja, dje rreth orës 3:30 një burrë i moshës 53-vjeçare nga Shkupi ka denoncuar se ditë më parë, rreth

orës 23:50, ka pranuar thirrje telefonike nga një mik, i cili e kishte parë vajzën e tij 16-vjeçare, e cila dukshëm e shqetësuar ka ecur në rrugë në Lagjen e Shuto Orizarës. Xh.R është drejtuar në vendin e caktuar dhe e ka gjetur të bijën e tij, e cila i ka treguar se me

dhunë është mbajtur nga një burrë 26-vjeçar në shtëpinë e tij. Ai, sipas tregimit të vajzës, nga 18 maji i vitit 2018 nuk e ka lejuar të largohet nga shtëpia e tij, ku fizikisht e ka abuzuar atë. Nga policia informojnë se po punohet për zbardhjen e plotë të rastit.

Shkup, 7 të lënduar në 7 aksidente

Shkup, 30 maj - Gjithsej tetë persona janë lënduar lehtë në tetë aksidente të regjistruara gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB-së Shkup. Policia e komunikacionit ka sanksionuar 68 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, ndërsa ka përjashtuar nga komunikacioni 10 para se të marrin patentë shoferi, dy fillestarë dhe tetë të tjerë. Siç informon MPB, nga komunikacioni janë përjashtuar 36 automjete të paregjistruara, dy me defekte teknike dhe 201 automobila të cilat janë parkuar në mënyrë të paligjshme. Me ndihmën e autotjetit special karrotreci janë mënjeluar 62 automjete.

Viojnë kontrollet ndaj motoçiklistëve

Tetovë, 30 maj - Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë të martën nga mesdita e deri në orët e mbrëmjes ka realizuar edhe një tjetër kontroll ku në qendër të vëmendjes kanë qenë përsëri motoçiklistët. "Gjatë kontrollit dhe aktiviteteve të realizuara në qytetin e Tetovës, janë zbuluar gjithsej 22 kundërvajtje, nga të cilët 12 kundërvajtje për mospërdorim të helmetës mbrojtëse, pesë motoçiklistë kanë drejtuar pa leje për vozitje dhe katër me regjistrim apo policisë të skaduar të regjistrimit etj. Kundërvajtjet e konstatuara gjatë këtyre aktiviteteve, janë sanksionuar me 22 fletëpagesa për kundërvajtje, 5 shkyçje nga trafiku, si dhe 10 ftesa për edukim në komunikacion", njoftoi zëdhënësi i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë, Fatmir

Rexhepi. Numri i përgjithshëm i këtyre lloji të kundërvajtjeve në aktivitetet e Gostivarit është gjithsej 21. "Prej tyre, 14 janë për mos shfrytëzimin e helmetës mbrojtëse, 4 janë për drejtim pa leje për vozitje, si dhe 3 për skadim të regjistrimit. Kundërvajtësve u janë përgatitur 21 fletëpagesa për kundërvajtje, 7 motoçiklistë janë shkyçur nga trafiku, dhe 14 janë ftuar në orë për edukim në komunikacion. Kontrollet e përforcuara ndaj motoçiklistëve, do të vijojnë edhe për gjatë muajve të ardhshëm verorë, shkak ky që përgjatë dhjetëra ditëve të kaluara, në rajonin e Tetovës dhe të Gostivarit, kanë ndodhur disa aksidente trafiku, në të cilat pjesëmarrëse direkt kanë qenë motoçiklistët", deklaroi zëdhënësi i policisë së Tetovës, Fatmir Rexhepi. (U.H)

KRONIKË

Konfiskohen plumba në Xhepçisht

Pjesëtarët e policisë nga Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë, të martën rreth orës 16.00, kanë kryer bastisje në shtëpinë e personit A.S. 61-vjeç nga Xhepçisht i Tetovës. Gjatë bastisjes, të cilën e kanë kryer me urdhër të gjykatësit, janë gjetur 94 plumba të kalibrit 7.9 milimetër, 8 plumba të kalibrit 9 milimetër, 4 plumba për armë gazi, një karikator për armë zjarri, si dhe mjete për pastrim të armëve. Gjësendet e gjetura gjatë bastisjes, janë fotodokumentuar dhe marrë për ekspertizë, derisa A.S. është privuar nga liria, ku pas zbardhjes së plotë të rastit dhe të gjitha detajeve në veçanti, kundër tij do të iniciohet padi adekuate.

Ofendon policët, arrestohet tetovari

43-vjeçari E.M. nga Tetova, të martën rreth orës 12.00, i ka ofenduar pjesëtarët e policisë të Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë, të cilët kanë qenë duke marrë masa lidhur me ata që janë parkuar gabimisht, në bulevardin "Iliria", në afërsi të tregut të gjelbërt në Tetovë. Vetura e tij, "Pasat" me targa të Tetovës, ka qenë gabimisht e parkuar ku gjatë përgatitjeve që e njëjta të ngritet nga ana e "shërbimit të merimangës" që të mundësohet qarkullim i lirshëm, menjëherë ka arritur E.M. dhe i njëjti ka filluar me fyerje dhe kërcënime. Personi në fjalë është arrestuar dhe kundër tij do të inicohet padi adekuate.

Vidhet arka në Arabati Baba Teqe

75-vjeçari F.S. nga fshati Balindoll i Gostivarit, të martën rreth orës 16 ka paraqitur se natën e kaluar, deri më tani persona të panjohur, kanë kryer vjedhje në objektin fetarë "Arabati Baba Teqe" në Tetovë. Të njëjtit, pa mos u vërejtur nga askush, kanë vjedhur arkën metalike për donacione vulnetare të parave nga ana e besimtarëve, e cila ka qenë e vendosur në rrethin e objektit, në të cilën ka pasur shuma të vogla të parave, dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes. Janë duke u ndërmarrë të gjitha masat dhe aktivitetet për zbardhjen e plotë të rastit të paraqitur, si dhe zbulimin dhe identifikimin e kryerësve të veprës.

Aksidentohet 45-vjeçari nga Banjica e Poshtme

Në udhëkryqin në mes të rrugëve "Vëllezërit Gjinoovski" dhe "JNA" në Gostivar, të martën në mesditë, vetura e tipit "Mercedes" me targa të Republikës së Italisë, e drejtuar nga 60 vjeçari F.A nga fshati Balindoll i Gostivarit, ka aksidentuar këmbësorin F.A. 45-vjeçar nga fshati Banjicë e Poshtme - Gostivar. Këmbësori i lënduar është dërguar në Spitalin e përgjithshëm "Ferd Murat" në Gostivar, për dhënien e ndihmës mjekësore. Pas kryerjes së hetimeve, punohet në zbardhjen e plotë të shkakut dhe detaleve në veçanti të ndodhjes të këtij aksidenti. (U.H)

Brenda komunës zhvillohen jo vetëm manifestimet që kanë si organizator vetë komunën, por edhe individë, shoqata, institucione..., janë të detyruar që të realizojnë aktivitete me logon komunale. Kjo formë e organizimit do të vazhdojë të jetë e tillë edhe në të ardhmen, ku nuk planifikohet ndonjë ndërmarrje më serioze, si ndërtimi i ndonjë qendre, apo kompleksi më të madh në këtë zonë

Koha Evis HALILI

Shkup, 30 maj - Sheshi "Skënderbeu", ambientet e Komunës së Çairit, Qendra teatrore për fëmijë, Qendra Informativ Kulturore... janë ndër mjediset e vetme ku zhvillohet jeta kulturore artistike brenda komunës kryesore të shqiptarëve. Disa vjet më parë, shërbime të ngjashme ofronte edhe Teatri Shqiptar, në skenat e të cilit janë zhvilluar që nga koncertet e ansambleve, koncertet, ekspozita e deri në manifestime humanitare e partiake. Jo vetëm pa kinema, galeri arti, librari e biblioteka, por edhe manifestimet kulturore dhe artistike, koncerte, promovimet, tribuna, konferencat..., ndodhin rëndom në sallën e Komunës, në sheshin Skënderbeu, apo Parkun, ndërsa të tjerat zhvendosen në anën tjetër të Vardarit, apo edhe në Çarshi.

Brenda objektit të komunës zhvillohen jo vetëm manifestimet që kanë si organizator vetë komunën, por edhe individë, shoqata, institucione..., janë të detyruar që të realizojnë aktivitete me logon komunale. Kjo formë e organizimit do të vazhdojë të jetë e tillë edhe në të ardhmen, ku nuk planifikohet ndërtimi i ndonjë qendre, apo kompleksi më të madh në këtë zonë. Nëse i referohesh Strategjisë për zhvillimin katërvjeçar të komunës, investimet infrastrukturo-

MUNGESË INSTITUCIONESH

KULTURË NË RRUGË, ÇAIRI PA ASNJË QENDËR SERIOZE



re me destinacion kulturën nuk i kalojnë 16 milionë denarët. Vetë komuna parashikon ndërtimin e katër qendrave për tubimin e të rinjve, ndërsa tre prej tyre do të jenë qendra që do të ngrihen në kuadër të tre shkollave (Jashar Bej Shkupi, Ismail Qemali dhe Liria) qendra e katërt është në lagjen Seravë dhe sipas Strategjisë për zhvillimin katërvjeçar të komunës, në objektin e bashkësisë vendore. Ky është projekti më i kushtueshëm financiar për komunën, realizimi i të cilit kap një kosto prej më shumë se 15 milionë denarë.

"Hapësirat aktuale kulturore, të cilat shfrytëzohen për shënimin e datave historike dhe organizimin e shumë ekspozitave dhe promovimeve të librave janë sheshi Skënderbeu, Parku, Teatri për fëmijë, Suli Han, Hamami i Daut Pashës dhe Kurshumli Han. Po ashtu, në përdorim të shpeshtë është edhe vetë Salla e Komunës, hapësirë që e shfrytëzojnë me kërkesë të tyre shumë autorë librash dhe organizata joqeveritare, duke e vlerësuar

si opsion të shkëlqyeshëm për manifestimin që synojnë të organizojnë. Edhe përkundër këtij numri të madh të objekteve kulturore, komuna ka vendosur të investojë në përmirësimin e mëtejshëm të kapaciteteve hapësinore për jetë më të shëndoshë kulturore", thotë zëdhënësi i Komunës, Kushtrim Alla. Rikonstruktimi dhe adaptimi i këtyre qendrave të kulturës do të realizohet gjatë katër viteve të ardhshme. Megjithatë, sipas publicistit Xhabir Ahmeti, perdja e errësirës kulturore në këtë zonë duhet të griset dhe zhvillimi i kulturës duhet të fillojë duke krijuar kushte për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve përmes artit.

"Pas defaktorizimit të gjatë të shqiptarëve, duhet të krijohen disa kushte për zhvillimin e jetës kulturore në Shkup. E para, Komuna dhe Kuvendi i Qytetit të Shkupit duhet të bashkëpunojnë intensivisht me arsimin, me institucionet kulturore dhe, në radhë të parë, me intelektualët që në fillim të gjenden format më të përshtatshme për

emancipimin e shoqërisë dhe për orientimin e saj nga vlerat e njëmendta të kulturës sonë, duke e larguar nga kërcënimi i shundi. Kuptohet ky bashkëpunim si cak duhet ta ketë rininë, e cila tash nuk ka njohuri të mjaftueshme për traditën kulturore shqiptare. E dyta, duhet të bëhen dy teatro të rinj. Njëri teatër për fëmijë dhe të rinj e tjetri teatri i kukullave. Kjo, sepse edukimi filon që nga çerdhet dhe shkollat fillore", thotë Ahmeti. Ai shton se është mëse i nevojshëm largimi i Bit Pazarit nga Çarshia. Në këtë mënyrë do të hapej një shesh nga i cili njerëzit do të kishin qasje në Teatrin shqiptar, në tempujt e fesë dhe mbi të gjitha - Çarshia do të bëhej një qendër e rëndësishme për ngjarje të ndryshme kulturore, nga ekspozitat, promovimet e deri te mbremjet me koncerte të muzikës së lehtë, por edhe botimin e ndonjë reviste letrare që do të subvencionohej nga Qyteti Shkupit.

Në Institutin e Trashëgimisë janë të mendimit se më shumë sesa qendra, ose objekte zhvillimi i

SKËNDERASANI

Zgjidhjen duhet ta kërkojmë tek kërkesat e tërësishme dhe joparziale për kthimin e një sërë objekteve të rëndësishme të veçantë, si hanet, apo edhe Kalanë në dispozicion të komunës. Administrimi i vetëm një pjese të Çarshisë nga ana e Komunës vazhdimisht do të jetë një pengesë për zhvillimin e projekteve afatgjate, të cilat komuna fare mirë mund t'i realizojë në partneritet me Ministrinë e Kulturës

XHABIRAHMETI

Komuna dhe Kuvendi i Qytetit të Shkupit duhet të bashkëpunojnë intensivisht me arsimin, me institucionet kulturore dhe, në radhë të parë, me intelektualët që në fillim të gjenden format më të përshtatshme për emancipimin e shoqërisë dhe për orientimin e saj nga vlerat e njëmendta të kulturës sonë, duke e larguar nga kërcënimi i shundi. Kuptohet ky bashkëpunim si cak duhet ta ketë rininë, e cila tash nuk ka njohuri të mjaftueshme për traditën kulturore shqiptare

jetës kulturore të Çairit, duhet të fillojnë nga Çarshia, që është pika nevralgjike e kësaj komune.

"Komuna duhet të iniciojë ndryshime ligjore, ligjet për Çarshinë edhe atë të ndarjes territoriale. Shkupi është Çarshia dhe duhet të ngjallim pikërisht shpirtin e kësaj zone që do të ndikojë në zhvillimin e kulturës, sidomos shqiptare dhe rritjen e vetëdijes qytetare. Zgjidhjen duhet ta kërkojmë tek kërkesat e tërësishme dhe joparziale për kthimin e një sërë objekteve të rëndësishme të veçantë, si hanet, apo edhe Kalanë në dispozicion të komunës. Administrimi i vetëm një pjese të Çarshisë nga ana e Komunës vazhdimisht do të jetë një pengesë për zhvillimin e projekteve afatgjate, të cilat komuna fare mirë mund t'i realizojë në partneritet me Ministrinë e Kulturës", thotë drejtori i ITSHKSH, Skënder Asani.

GJYKATA ADMINISTRATIVE NË ANËN E QYTETARËVE

Kazinoja në Tetovë nuk do të hapet

Tetovë, 30 maj - Objekti në Tetovë, ku duhej të hapet kazino, për çka më 4 maj protestohesh kundër këtij vendimi, nuk do të hapet, informuan në konferencën e djeshme për media nga lëvizja kundër bastit në Tetovë për vendimin e Gjykatës kompetente Administrative.

Sipas anëtarit të Shoqatës Xhemal Abdiu, e cila edhe e organizoi protestën në fillim të këtij muaji, kjo i dha rezultatet e para por paralajmëroi edhe se ata do të vazh-

dojnë edhe më tutje me aktivitetet e tyre.

"Reagimi i qytetarëve kundër degradimit, mjerimit, prostitucionit, varfërisë që po përhapet shumë nga këto lojëra të fatit për çdo ditë po rritet dhe po merr formë dhe guxim që të përhapet mbarë shtetin, si dhe ato të përfshihen në sjelljen e vendimeve për këto dukuri negative", tha Abdiu. Sipas kolegut të tij nga Shoqata, Jushi Emrullai, edhe institucionet në sistem pozitivisht janë përgjigjur në kërkesat e

tyre për ndalim të hapjes së kazinosë. Emrullai dhe Abdiu së bashku paralajmëruan se aktivitetet e Shoqatës do të vazhdojnë në drejtim që në këtë pjesë të qytetit ku në distancë shumë të afërt gjenden dy universitete dhe nga dy shkolla fillore dhe të mesme, kurrsesi të mos lejohet hapja e kazinosë së re, bastoret sportive ose objektit tjetër për organizim të lojërave të fatit. Ata theksuan se do të tentojnë që në ligjin e ri për lojëra të fatit të mos pranohet dispozita e propo-

zuar që kazinotë të jenë së paku 300 metra nga objektet publike, por edhe ato ekzistuese dhe kazinotë e reja, bastoret dhe objektet tjera për lojëra të fatit të jenë së paku tre kilometra nga secili mjedis urban. Për këtë kërkesë për largimin e kazinovës dhe objekteve të ngjashme, së paku tre kilometra nga vendet e banuara nga Shoqata do të përgatisin amendamente së bashku me avokatët e tyre që do të dërgohen deri te të gjitha grupet parlamentare, me qëllim siç u tha

të parandalohet sjellja e ligjit skandaloz të përgatitur nga Ministria e Financave.

Në kuadër të aktiviteteve të ardhshme nga Shoqata kundër bastit paralajmëruan se do të kërkojnë edhe përgatitje të strategjisë për arsim të nxënësve, studentëve dhe të gjithë qytetarëve tjerë për dëmin që e shkaktojnë lojërat e fatit, ndërsa do të financohet nga tatimet shtesë me të cilat duhet të ngarkohen objektet e tilla. (U.H)

Duhani rrit për 12 për qind rastet e vdekjes nga sëmundjet e zemrës

Shkup, 30 maj - Përdorimi i duhanit dhe ekspozimi i pirjes pasive kontribuojnë përafërsisht për 12 për qind të të gjitha rastet e vdekjes të sëmundjet e zemrës, ndërsa eliminimi i përdorimit të duhanit mund të mbrojë miliona njerëz të vdesin nga zemra ose sulmi në tru, deklaroi sot ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe me rastin e 31 Majit, Ditës Botërore pa duhan. Nën moton "Zgjidh shëndet, e jo duhan", Ministria e Shëndetësisë edhe këtë vit në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe Institutin për Shëndet Publik tradicionalisht e shënojnë Ditën Botërore pa duhan.

"Në Republikën e Maqedonisë, sipas të dhënave të Institutit për Shëndet Publik, në vitin 2016 nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut kanë vdekur 10.920 persona me shkallë të vdekshmërisë prej 526,9 në 100.000 banorë. Sëmundjet e sistemit kardio-vaskular marrin pjesë me 53,5 për qind në mortalitetin e tërësishëm dhe janë në vend të parë në strukturën e shkaqeve të vdekjes", deklaroi Filipçe.

Potenco i se pirja e duhanit paraqet rrezik të dëshmuar për shëndetin e popullatës, rrezik për sëmundje dhe problem global publik-shëndetësor, për shkak të së cilës e domosdoshme është të ndërmerren masa urgjente për të dëshmuar kundërdikacionin e duhanit. (D.K)

STRATEGJIA FISKALE 2019-2021

BORXHET DREJT LINJËS SË KUQE!

Deri në vitin 2021 Maqedonia do të merr borxhe të reja si në tregun ndërkombëtar dhe atë vendor në vlerë prej 2.3 miliard denarë duke e çuar borxhin publik në nivel prej 7 miliard euro, nga 5 miliard sa është për momentin. Njëkohësisht deri në fund të vitit 2021, Maqedoni do të duhet të kthejë borxhe të vjetra në vlerë prej 1.5 miliard euro.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 30 maj - Gjatë tre viteve të ardhshme Maqedonia do të duhet të futet në borxhet të reja në vlerë të përgjithshme prej 2.3 miliard, ndërsa për të njëjtën periudhë shteti duhet të kthejë borxh të vjetër në vlerë prej 1.5 miliard euro, për borxhin bazë dhe 500 milion euro kamata.

Kështu thuhet në "Strategjinë fiskale të Republikës së Maqedonisë 2019-2021", të publikuar nga Ministria e Financave. Në këtë strategji përveç që parashihet rritje rrogash, rritje e konsumit personal, rritje të Bruto Prodhimit Vendor parashihet dhe rritja e borxhit publik që të mundet Maqedonia në kohë të kthejë borxhet e vjetra, të paguaj kamatat si dhe të realizojë investimet e planifikuara. Njëherësh parashihet dhe dhënia e eurobligacionit të ri në tregun e jashtëm financiar.

Sipas paralajmërimeve deficitit buxhetor gjatë periudhës së ardh-



me do të zvogëlohet si në vlerë absolute ashtu edhe në përqindje të Bruto Prodhimit Vendor (BPV), gjegjësisht në vitin 2019 parashihet të jetë 2.5 për qind nga BPV ndërsa në vitin 2021 do të jetë vetëm 2 për qind.

"Financimi i deficitit të planifikuar do të sigurohet përmes huamarrjeve të reja nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankave komerciale apo fondeve vendore. Futja në borxh tek institucionet e jashtëm financiare do të bëhet përmes tërheqjes së kredive me kamata të volitshme për financimin e disa projekteve kapitale si dhe përmes dhënies së eurobligacionit të ri në tregun ndërkombëtar", thuhet në Strategjinë Fiskale.

Gjithashtu edhe politika disiplinore fiskale do të sigurojë lëvizje stabile të borxhit publik dhe në kohë afatmesme do të arrijë nivelin prej 54,8 për qind të BPV-së dhe në vitin 2020 si rezultat i përsheptimit të projekteve kapitale do të zvogëlohet në 53,8 për qind të BPV-së në vitin 2021.

"Më saktë borxhi publik do të

lëvizë nën limitin e caktuar për afatmesëm dhe afatgjatë në nivelin prej 60 për qind të BDP-së", thonë nga Ministria e Financave, duke shtuar se llogaritjet e strategjisë fiskale për tre vitet e ardhshme bazohen në rritjen ekonomike dhe BPV-së si pasojë parashikimeve të volitshme për ekonominë Evropiane, rritjen e investimeve në Maqedoni, rritjen e pagave dhe uljen e papunësisë.

"Në vitin 2019 parashihet që rritja ekonomike të jetë 3.5 për qind, në vitin 2020 - 4 për qind dhe në vitin 2021 rritja ekonomike parashihet të jetë 5 për qind", thonë nga Ministria e Financave.

Për ekspertët ekonomikë parashikimet e "Strategjisë fiskale 2019-2021" nuk janë edhe aq optimiste ku kemi parasysh paralajmërimet për futje të reja në borxh që mundet në mënyre direkt të ndikojnë në mosrritjen ekonomike. Eksperti ekonomik Marjan Petreski shprehet se nuk ka dilemë se shteti po shkon drejt linjës së kuqe sa i përket rritjes së borxhit publik për shkak se pjesa më e madhe e këtyre borxheve

shkojnë për mbulimin e harxhimeve rrjedhëse të buxhetit apo thjeshtë thënë për kthimin e borxheve të vjetra.

"Borxhi publik relativisht për një kohë shumë të shkurt u dyfishua prandaj konsolidimi i borxhit publik është më se i nevojshëm. Kjo do të thotë se në të ardhmen për çdo huamarrje të re në tregun e brendshëm financiar, Qeveria duhet të jep informata të sakta se për çka futet në borxhe të reja, që do të thotë se çdo cent që do të merret borxh të tregohet sakte se për çfarë nevojë merren këto para dhe se shpenzimi i këtyre parave të jetë transparente nga ana e Qeverisë. Rritja e borxhit publik, i cili për momentin është 5 miliard euro, pas tre viteve do shkojë në 7 miliard euro", thotë Marjan Petreski ekspert ekonomik.

Instituti për analiza ekonomike të politike "Finance Think" ka dalë më qëndrimin se se projektimet në strategjinë më saktë projektimet makroekonomike duken arbitrare dhe jo mjaftueshëm të bazuara në logjikën ekonomike.

"Edhe pse rritja ekonomike prej 5 për qind për afat të mesëm është qëllim legjitim, përsheptimi i rritjes ekonomike prej 4 për qind në vitin 2020 dhe 5 për qind në vitin 2021 duken si një rrezik i theksuar. Rreziqet e jashtëm diktojnë një rritje jo të mjaftueshme të kërkesave nga tregjet e huaja si dhe pasiguria e Maqedonisë rreth integriteteve Evropiane. Rreziku vendor është i mundshëm për shkak të proceseve politike jo stabile, mosrealizmi i mjaftueshëm i investimeve kapitale si dhe përkrashje jo e mjaftueshme e qeverisë aktuale për investime në sektorin privat", thonë nga Finance Think.

GATI VENDIMI I RI LIGJOR

ASKUSH NUK SIGURON SE ÇMIMI I RRYMËS DO TË JETË MË LIRË



Shkup, 30 maj - Askush me siguri nuk mund të thotë nëse çmimi i energjisë elektrike në të ardhmen do të jetë më i ulët. Kjo është sikur ta parashtroni pyetjen se a do të jetë çmimi i naftës ose i ndonjë metali tjetër më i ulët, porositi zëvendëskryeministri përgjegjës

për çështje ekonomike, Koço Angjushev.

Ai këtë e tha duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve në punëtorinë përmbyllëse për Përkrahje teknike të Republikës së Maqedonisë në tregun e organizuar për energji elektrike, e në lidhje me çmimet e rrymës në përputhje me Ligjin për energjetikë. "Gjithsesi mund të garantoj se me Ligjin e ri, çmimi i energjisë elektrike për qytetarët gjithmonë do të jetë më i favorshëm në krahasim me atë që e ofronte ai paraprak", tha Angjushev. Ai sqaroi se kjo mundësohet me mekanizmin e furnizuesit universal, që vendoset me Ligjin. Sipas vendimit të ri ligjor, duhet të sh-

pallet konkurs për furnizuesin universal në afat prej 90 ditëve nga hyrja në fuqi të Ligjit. Këto 90 ditë tashmë vazhdojnë, duke marrë parasysh se ligji para pak kohe u miratua, ndërsa furnizuesi universal do të zgjidhet në tender dhe në këtë zgjidhje më nuk do të ketë pranim të shpenzimeve joproduktive nga ana e Komisionit rregullator. "Kompanitë do të mund që me shpenzimet e tyre t'i përfshijnë në ndonjë kornizë mbi energjinë e furnizuar elektrike dhe këtu do të jetë konkurrenca e tyre. Ligji stimulon kompani të orientuara të tregut, që në bazë konkurruese do të stimulohen t'i zvogëlojnë shpenzimet joproduktive", sqaroi Angjushev.

Ai shtoi se furnizuesi universal garanton dy punë. Së pari qytetarët janë të mbrojtur. Bashkësia energjetike është pajtuar që në dispozitat kalimtare të Ligjit të qëndrojë se vitet e para, duke filluar që nga viti i parë i implementimit, 80 për qind nga energjia e prodhuar elektrike nga prodhuesi vendore ELEM të shkojë deri te qytetarët nëpërmjet furnizuesit universal, me çka qytetarët në afat më të gjatë do të jenë të mbrojtur nga goditjet e çmimeve të tregut. Ligji i mëparshëm ofronte mbrojtje deri në vitin 2020, ndërsa ky i riu ofron mbrojtje në shtatë-tetë vitet e ardhshme, në të cilat në vazhdimësi do të bie përqindja e

energjisë së prodhuar elektrike nga ELEM, që do të shkojë për amvisëritë. E dyta, do të ketë përfitim për kompanitë e RM-së dhe për të gjithë ata që duan të jenë në tregun e lirë, sepse kompanitë e mesme sot paguajnë 140 deri 150 euro për megavat orë, ndërsa konkurrenca e tyre nga Evropa paguan 50 deri 60 euro megavat orë. Kjo u mundëson që ata të luftojnë në tregun botëror. Ligji mundëson që Maqedonia të jetë pjesë e familjes evropiane edhe në kuptim energjetik, tha Anxhushhev. Ai theksoi se për momentin në shtet për tregti me energjinë elektrike janë të licencuara mbi 50 kompani, ndërsa për furnizim mbi dhjetë. (Z.V)

Më pak ekspozita dhe artistë, më shumë vizitorë

Shkup, 30 maj - Gjatë vitit të kaluar janë organizuar 575 ekspozita të artit figurativ, dhe në krahasim me vitin paraprak numri është zvogëluar për dy për qind, publikoi Enti Shtetëror për Statistikë. Në këtë periudhë për 1,9 për qind është zvogëluar numri i artistëve të artit figurativ - pjesëmarrës në ekspozitat, ndërsa për 20,7 për qind është rritur numri i vizitorëve të ekspozitave të artit figurativ. Në vitin 2017 janë organizuar 20 koloni të artit, ndërsa numri i pjesëmarrësve, në krahasim me vitin 2016, është rritur për 33,2 për qind.

Edhe një padi për ish-kryetarin e Vasilevës

Strumicë, 30 maj - Sektori për punë të brendshme Strumicë deri te Prokuroria Themelore Publike në Strumicë ka ngritur kallëzime penale kundër V.S. (51) nga fshati Edernikovë dhe kundër G.C. (55) nga fshati Dobroshincë, për shkak të dyshimit se kryerësi i parë ka kryer veprë penale "Keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit", ndërsa i akuzuari i dytë veprë penale "Nxitje" dhe "Parashtrim të dëshmimeve të rreme". Siç informoi në konferencën e sotme për shtyp Toni Bozhikov, inspektor i pavarur në SPB Strumicë, i akuzuari i parë e ka shfrytëzuar pozicionin e tij zyrtar dhe me tejkalim të autorizimit, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për veprim me objektet e ndërtuara pa leje, i ka mundësuar të denoncuarit të dytë të përfitojë dobi pronësore.

Anulohet seanca kundër Llatasit

Shkup, 30 maj - Për shkak të kërkesës së mbrojtjes dje në Gjykatën Penale u anulua lënda "Total" e Prokurorisë Publike Speciale. "Në "Total" i dyshuar është gazetari Dragan Pavloviq-Llatas për fshehjen e tatimit. Sipas aktakuzës së PPS-së, i dyshuari ka dhënë të dhëna të rrejshme në llogaritë përfundimtare dhe fletëparaqitjet për tatimin me ç'rast përmes personave juridikë ka fshehur tatim në shumë prej 7.466.981 denarë apo 121.414 euro, ndërsa personalisht personi fizik ka fshehur 3.876.471 denarë apo 63.032 euro.

(PA)PERSPEKTIVAT E TURIZMI MALOR

BUKURITË NATYRORE, NJË ASET I PASHFRYTËZUAR

Njohësit e kësaj fushe mendojnë se shteti duhet të ndihmojë zhvillimin e turizmit rural pikë së pari me ndërtimin e rrugëve për shkak se nuk mund të sjellim turistë të huaj me një infrastrukturë të pazhvilluar rrugore, ndërsa duhet të mendohet edhe për mbështetjen financiare të banorëve në revitalizimin e shtëpive për bujtje të turistëve, duke u fokusuar në ndërtimin e etno-fshatrave me ruajtjen e origjinalitetit të shtëpive tradicionale të Sharrit

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 30 maj - Mali i Sharrit por edhe malet tjera në Maqedoni, janë një nga pjesët më të bukura malore në të gjithë Evropën. Këto masive malore mund të kthehen në një nga pikat më të frekuentuara të turizmit malor në rajon, me kusht që shteti do të përgatiste një plan serioz zhvillimor për këtë zonë, dhe nëse mbështeten seriozisht banorët e kësaj ane në hapjen e vendeve të reja të punës.

Ekspertët e lëmisë së turizmit vlerësojnë se Mali Sharr i pasur me livadhe, pyje, burime të ftohta uji, liqene malore, stane të dhenve, djathëra e bylemtëra të tjerë, mund të shndërrohet në një nga pikat më të fuqishme të turizmit malor në Evropën juglindore duke e shndërruar turizmin malor pikë destini mi në të gjitha stinët.

Sipas profesorit universitar, Mislim Zendeli, pasuria e madhe natyrore që e posedon Mali Sharr për tu shndërruar në një burim të ardhurash për banorët e zonës, kërkon në radhë të parë një strategji zhvillimore për turizmin e qëndrueshëm rural, që më pas do të hapte rrugën edhe për realizimin e projekteve dhe plan-bizneseve të ndryshme.

"Mali Sharr mund të ketë një turizëm malor mjaft të zhvilluar, por vetëm me kusht që të dihet se çka dhe si do të zhvillohet, cilat janë prioritetet e kështu me radhë. Pra, zhvillimi i turizmit malor në këtë zonë kërkon një planifikim shumë-



dimensional dhe heterogjen me pjesëmarrjen e subjekteve si në nivel lokal ashtu edhe në nivel republikan", sqaron Zendeli. Sipas tij, shteti duhet të ndihmojë zhvillimin e turizmit rural pikë së pari me ndërtimin e rrugëve për shkak se nuk mund të sjellim turistë të huaj me një infrastrukturë të pazhvilluar rrugore, ndërsa duhet të mendohet edhe për mbështetjen financiare të banorëve në revitalizimin e shtëpive për bujtje të turistëve, duke u fokusuar në ndërtimin e etno-fshatrave me ruajtjen e origjinalitetit të shtëpive tradicionale të Sharrit.

"Në këtë drejtim duhet të mendojmë për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm në aspektin ekonomik që do të jetë fitimprurës për banorët e zonës, do të hapë vende të reja të punës, do të ruajë biodiversitetin e natyrës, nuk do të shkatërrojë ambientin si dhe do të tërheqë turistë nga jashtë me origjinalitetin e vet duke filluar nga ushqimi, bukuritë natyrore, qeni i Sharrit, delet e Sharrit etj", shpjegon më tej Zendeli.

Një vëmendje e veçantë në këtë drejtim, shton më tej ai, duhet kushtuar edhe organizimit të banorëve të kësaj ane në aspektin e trajnimeve se çka dhe si të investojnë, ngritjes së kapaciteteve profesionale në aspektin e turizmit malor. Gjithashtu nevojitet një ndihmë profesionale edhe nga ana e inxhinierëve të blegtorisë apo kopshtarisë, si dhe ekspertëve të lëmvive të tjera, me qëllim që turizmi malor të jetë një biznes i leverdishëm thekson Zendeli.

THETHI SI MODEL

Në ndërkohë, masivi malor i Thethit afër Shkodrës në vitet e fundit, frekuentohet nga vizitorë

vendas e të huaj, ndërsa banorët e këtij fshati turistik kanë nisur të përshtatin banesat e tyre në funksion të turizmit, duke e parë këtë si një mundësi ekonomike me interes. Kjo ka ndikuar që të shtohet interesi i vizitorëve të huaj, që kryesisht janë ekplorues të natyrës, turistë, alpinistë apo të apasionuar pas shëtitje me biçikletë. Vetëm para tre vitesh, mbi 12 mijë turistë të huaj kanë vizituar këtë pikë turistike në Shqipëri.

Përveç kësaj, në stinën e verë janë të shumta familjet nga Thethi që jetojnë në Shkodër, që rikthehen atje për të veruar por dhe për të shfrytëzuar mundësitë ekonomike që u jep turizmi malor. Prej disa viteve, banorët e Thethit kanë filluar të kthejnë sytë nga vendlindja e tyre, aty ku kanë shtëpitë ku janë lindur e rritur. Një pjesë e shtëpive janë ndihmuar edhe nga GTZ Gjermane. Në këto shtëpi të përshtatura për pushuesit, tashmë ka krevatë, raftë, dyshekë, çarçafë e batanije të reja si dhe pajisje hidrosanitare, enë kuzhine me aksesoret përkatës etj. Kështu banesat janë kthyer në pansione të vogla, mini-hotele, shtëpi pushimi ku afrohen shërbime si fjetja dhe ushqimi. Po kështu GTZ ka mundësuar dhe vendosjen e sinjalistikës turistike në të gjithë parkun kombëtar të Thethit. Ndhimë familjeve nga Thethi në biznesin e tyre u ka dhënë dhe UNDP dhe ambasada holandeze, e cila ka mbështetur rikonstruksionin e dritareve të banesave dhe pjesëve të tjera të tyre.

RIKTHIMI I HANEVE

Në Shqipëri, edhe projekti ambicioz "40 Hanet", i cili ka disa vjet që funksionon, ofron për turistët e huaj dhe vendas mundësitë për të njohur nga afër jo vetëm breg-



MISLIM ZENDELI

Mali Sharr mund të ketë një turizëm malor mjaft të zhvilluar, por vetëm me kusht që të dihet se çka dhe si do të zhvillohet, cilat janë prioritetet e kështu me radhë. Pra, zhvillimi i turizmit malor në këtë zonë kërkon një planifikim shumëdimensional dhe heterogjen me pjesëmarrjen e subjekteve si në nivel lokal, ashtu edhe në nivel republikan

detin shqiptar, por edhe traditat shqiptare të hershme. Këto banesa mahnitëse dhe relaksuese rigjallërojnë turizmin në zonat rurale të vendit, duke përmirësuar ekonominë e banorëve të zonave të thella të vendit, të cilët tashmë kanë një alternativë më tepër, përveç emigracionit apo bujqësisë për të siguruar jetesën. Konkretisht, janë shtëpitë e fshatit me kushtet reale të banimit, sigurisht, të mobiluara sipas traditave të zonave ku janë ngritur. Katër itineraret e këtij projekti përfshijnë në gjurmën e veta hanet, duke nisur nga Alpet e Shqipërisë, më pas bujtinat përgjatë rrugës së njohur si "Via Publica", për të vazhduar me "Via Egnatia" dhe në fund itinerarin e Jugut. Ndërkohë që ekziston një mori kombinimesh dhe akomodimesh, të cilat i japin dorë të lirë turistit dhe agjencive turistike për të eksploruar itinerare të tilla.

TRAJTIMI I PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

SHTETI TË NDJEK MODELET EUROPIANE



Kujdesi human e profesional i shtetit ndaj personave me aftësi të posaçme është në nivelin e pritjeve, kurse prindërit kërkojnë ndryshimin e qasjes së shoqërisë ndaj këtyre personave

BUJAR HOXHA

Nëpër shkolla duhet të ketë specialistë të defektologjisë, psikologjisë dhe logopedisë në mënyrë që të trajtohen fëmijët me nevoja të posaçme, sepse përndryshe, këta persona pengojnë mësimin edukativo-arsimor dhe duhet të përjashtohen nga shkolla, gjë që paraqet diskriminim. Duhet të angazhohen pedagogë apo ekspertë të përgatitur që do të punonin me plan-program të veçantë për aftësimin psiko-fizike të këtyre fëmijëve

ARAFAT SHABANI

Për t'i inkuadruar këta fëmijë në procesin arsimor duhet njëherë të ketë infrastrukturë jo vetëm në institucione, por edhe rrugore. Si profesor në UEJL, kemi pasur disa studentë me nevoja të veçanta, ku sistemi i pranon dhe infrastruktura brenda kampusit është në nivel. Por, deri në hyrje të universitetit ata kanë probleme

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 30 maj - Një shoqëri nuk mund të jetë e kompletuar në pikëpamje humane nëse brenda saj nuk përfshin edhe persona me nevoja të posaçme. Por a do të mund të arrihet kjo nëse shteti nuk siguron kushte të nevojshme që do të ishin të domosdoshme për një funksionim normal të këtyre personave?

Një pyetje e tillë vjen edhe prej Bujar Hoxhës, prind i fëmijës me autizëm, i cili ka vërejtje të shumta në adresë të institucioneve shtetërore sa i përket kujdesit profesional e human ndaj personave me nevoja të veçanta.

"E para është fusha e shëndetësisë, e cila u përket më shumë këtyre personave (e kam djalin me autizëm) dhe nuk kemi analiza adekuate në fushën e pediatriisë neurologjike, domethënë nuk kemi mjek adekuat, subspecialist të fushës së neurologjisë, që të merren vetëm me sindromin autik. Por, çfarë ndodh, të gjitha sindromet simotra qoftë Doën sindromi, qoftë paraliza cerebrale trajtohen njëkohësisht, që thënë kushtimisht të gjithë këta pacientë futen në një 'kosh', gjë që nuk është në rregull sepse këto dy diagnoza ndryshojnë njëra prej tjetrës. Nëse njëra ka parametra gjenetikë, tjetra mund të ketë parametra psikologjikë. Aspekti i dytë janë institucionet e arsimit, në të gjithë botën, pra dihet që prej moshës parashkollore, deri në përfundim të universitetit, këtyre personave u garantohet shkollim paralel me të ashtuquajturit e tjerë "persona normal", sepse është shumë diskutabile, pra biokimia mes normalitetit dhe abnormalitetit, (ku mund të diskutohet si në aspektin esencial ashtu edhe filozofik). Për mua këta persona nuk

CAROVSKA: TË MËSOHEMI ME FËMIJËT NË KARROÇË

Mila Carovka, ministre e Punës dhe Politikës Sociale, e cila thotë se deri më tani për personat me nevoja të veçanta nuk është biseduar për aspektin e potencialeve të tyre. "Për ata është folur vetëm si problem, si një individ që të harxhojë para nga buxheti", thotë ajo ndërsa apelon që të këta persona të përfshihen në shoqëri, kurse nxënësit dhe personeli arsimor duhet të adaptohet me pamje të fëmijëve në karrocë, por edhe të dimë si të komunikojmë dhe të sillemi me atë fëmijë.



janë abnormal, siç paragjykojnë. Si shembull, tek autizmi, fusha e inteligjencës te ata është më e prekur edhe pse në dukje mund të dallohen se kanë kapacitetin e ulët, dhe është e jofaleminderuese që të matet te ne inteligjenca e tyre. Mirëpo, duhet të bëhet diçka tjetër nga ana e specialistëve, të vërtetohet me metodat e kompensimit, të plotësohet ajo që i mungon me anë të inteligjencës. Kjo gjë nuk bëhet, vetëm se në funksion të pak institucioneve private, për të cilët prindërit paguajnë shumë të lartë, bie fjala, unë në muaj jap 1000 euro, për trajtimin "psiko-behaviorist" (sjelljet mendore) të djalit tim, i cili akoma është joverbal dhe është 9 vjeç, por nuk mund të gjej doktor adekuat që të kujdeset për analizat e gjakut, analizat gjenetike, incizimin e trurit, që në botën perëndimore bëhen në çdo të tretin muaj, kurse këtu nuk praktikohen", thotë prindi Hoxha për gazetën Koha.

Nëpër shkolla duhet të ketë specialistë të defektologjisë, psikologjisë dhe logopedisë, thotë Bujar Hoxha, në mënyrë që të trajtohen fëmijët me nevoja të posaçme, sepse, përndryshe këta persona pengojnë mësimin edukativo-arsimor dhe duhet të përjashtohen nga shkolla, gjë që paraqet diskriminim. Hoxha shton se duhet të an-

gazhohen pedagogë apo ekspertë të përgatitur që do të punonin me plan-program të veçantë për aftësimin psiko-fizike të këtyre fëmijëve. Bëhet fjalë për procesin e nxënies, mirësjelljes, ndaljen e sjelljeve të tyre repeditive dhe stereotipike që e kanë, sepse këta kanë një zhvillim atipik psikologjik dhe ne i quajmë neorodiziv dhe jo neorotipik siç janë njerëzit normal dhe kjo nuk është hendikep, por është "pasuri", sepse këta persona dikur mund të aftësohen, ku edhe kemi shumë shembuj në botë me faza të zhvillimit të autizmit, që kanë tjera aftësi perceptive dhe konjuktive, që mund të zbulojnë. Ky prind kërkon inkuadrimit e menjëhershëm të këtyre personave në sistemin arsimor, pa diskriminim dhe dhënien e kushteve së paku të subspecialistëve të fushës së mjekësisë dhe mikrobiologjisë. Fëmija e tij shkon në shkollë të rregullt, me përcjellje vetëm dy orë, por duke i paguar defektologët dhe logopedët.

"Deri tani kemi dërguar në aktivitete te 'Kalinka', ku paguajmë 200 euro, në gjuhën maqedonase, por deri tani nuk ka patur efekt, sepse këtyre fëmijëve u duhet mësim në gjuhën amtare, ku tani e zbuluam Çairin, ku e dërgoj në shoqatën 'Bota e re', katër herë në javë dhe shoqata "Dua ylberin", si dhe te një lo-

gopede Ajshe Beqiri, por për fat të keq këta persona nuk janë të punësuar zyrtarisht dhe kjo është hendikepi më i madh. Fëmijën tim e kam dërguar në aktivitet sportiv një kohë, për të luajtur basketboll me personat me nevoja të veçanta, por janë mbyllur. Tani e dërgojmë në pishinë, ku e ushton një person i aftësuar për këtë kategori të njerëzve. Pra, shpenzimet e aktiviteteve shkollore, por edhe jashtë shkollore, medikamenteve që përdor fëmija arrijnë shumë në një mijë eurove, ku duhet ti sigurojë shteti, siç ndodh në vendet e zhvilluara", tha Hoxha.

Edhe profesorin universitar Arafat Shabani, është i mendimit se personave me nevoja të veçanta shteti nuk iu ofron kushte që ata të integrohen në jetën shoqërore.

"Nuk jemi në dijeni se sa është numri i personave me nevoja të veçanta këtu në Maqedoni, ajo që shihet janë pak, por ndryshe flasin statistikën e BE-së dhe institucioneve të saj. Për rajonin e Ballkanit Perëndimor, statistikën tregojnë se janë shumë, por se ku janë ata, është çështje e diskutueshme për arsye se shumica e atyre personave mbahen të mbyllur, për shkak të një mentaliteti që ndikohet nga shoqëria. Për t'i inkuadruar këta fëmijë në procesin arsimor duhet njëherë të ketë infrastrukturë jo vetëm në institucione, por edhe rrugore. Si profesor në UEJL, kemi pasur disa studentë me nevoja të veçanta, ku sistemi i pranon dhe infrastruktura brenda kampusit është në nivel. Por, deri në hyrje të universitetit ata kanë probleme", thotë Arafat Shabani, profesor në Fakultetin e Komunikimit dhe Gjuhëve për gazetën Koha. Ai shton se përpos që mësimdhënësit duhet të integrohen në procesin arsimor për përfshirjen

e personave me nevoja të veçanta, këtu ka edhe kosto të lartë, për materialet, gjë që shteti nuk ka potencial ta mbulojë.

Edhe pse Konventat ndërkombëtare për të drejtat e personave me nevoja të veçanta mbrojnë këtë kategori të njerëzve, kjo megjithatë nuk has në mirëkuptim të duhur në Maqedoni për arsye se personat me aftësi të veçanta ende paragjykojnë dhe ata nuk mund të punësohen në arsim, shëndetësi, administratë etj.

Por, në anën tjetër inkuadrimit i këtyre personave, është një përfitim për shoqërinë dhe këtë mendim e mbështet edhe Mila Carovka, ministre e Punës dhe Politikës Sociale, e cila thotë se deri më tani për personat me nevoja të veçanta nuk është biseduar për aspektin e potencialeve të tyre. "Për ata është folur vetëm si problem, si një individ që të harxhojë para nga buxheti", thotë ajo ndërsa apelon që të këta persona të përfshihen në shoqëri, kurse nxënësit dhe personeli arsimor duhet të adaptohet me pamje të fëmijëve në karrocë, por edhe të dimë si të komunikojmë dhe të sillemi me atë fëmijë. Carovka mbështet idenë se nëse njerëzit me ndonjë aftësi të kufizuar izolojnë, atëherë humbim si shoqëri, kurse me përfshirjen e tyre shkolla, kopshte e gjetiu fillon të zhvillohet edhe shoqëria.

Javë e bukur



Nga
Nazim RASHIDI

Nuk ndodh shpesh që për disa ditë, një javë a më shumë, të ndeshem, të shoh dhe të takoj kaq shumë njerëz, tanët, të krijuar nga rrethanat dhe përvojat tona, me jetë dhe përditshmëri si e jona, e që kanë arritur të shpërthejnë aq shumë...

Nuk ka event më të përfolur prej ditësh, eko e të cilin ende vazhdon dhe kjo është ndeshja finale në Ligën e Kampioneve mes Liverpoolit dhe Real Madridit. Ende në murin tim në Facebook, më shfaqet zemërimi i fansave të shumtë me atë që i ndodhi ose nuk i ndodhi Sergio Ramos-it të Real Madridit me përballjet e tij "jo sportive" qoftë me Loris Karius qoftë me Mohamed Salah të Liverpoolit gjatë finales të madhe. Shoh përplasje verbale mes fansash se pse UEFA nuk do të ndërmarrë gjë ndaj Ramos, e të tjera komente si këto që kanë të bëjnë me një prej eventeve më të shikuar në rruzullin tokësor.

Janë këto evente që lidhin botën dhe që krijojnë një dimension universal duke shkaktuar madje edhe ndarje edhe brenda një fisi, shoqërie a kombi kur bëhet fjalë se cilin ekip mbështet. Është një leksion i mirë se pasioni disa herë tejkalon do paradigma të përcaktuara më herët në konstruktet tona për shoqërinë apo dhe etninë. Të tilla efekte jep futbolli, të cilin anglezët i referohen me fjalët "lojë e bukur". Por veç futbollit e bukur ishte hapja e kësaj finaleje të madhe.

Në mbamendjen kolektive tonën por dhe të gjithë botës në tru, si një tatuazh, kanë mbetur pamjet spektakolare të mini koncertit të Dua Lipës. Nuk ka ndodhur ndonjëherë që fansat e futbollit të miksohen aq shumë me art e muzikë dhe po si rrallë herë shihje prej tyre se si në një anë shanin e mbrojnë ekipin e tyre dhe si në anën tjetër i gëzoheshin një artisteje shqiptare. Ishte dhe ende është një javë e bukur me gjithë prezencë shqiptare

nëpër botë. Disi e paimagjinueshme, por jo e pa mundur.

Nuk dua të jem as romantik e aq më shumë euforik, por nuk është se ka ndodhur që për një periudhë kaq të shkurtër kohore të ketë kaq shumë vetëdije për prezencë shqiptare në botë dhe këtë s'ka se si mos e vëmë re. Por sigurisht që gjurmë janë lënë dhe më herët.

Mu dha mundësia që në Tiranë të shoh një ekspozitë librash të vjetër kryesisht fate, Bibla dhe Kuranë të krijuar ndër shekuj dhe tejet të lashtë por që kanë pasur impakt të madh. Kodikët e Shqipërisë njihen dhe janë një fond me rëndësi botërore për historinë e zhvillimit të letërsisë së vjetër biblike, liturgjike. Pra rëndësia e tyre është botërore. Dhe e theksoj këtë se sepse impakti dhe gjurma shqiptare ka qenë e pranishme ndër shekuj, por disa herë kur ajo është e fshehur në libra e biblioteka nuk është se e vëmë re. Ky është ai momenti që krijon gëzim dhe ekzaltim kur Dua Lipa këndon në finalen e Ligës së Kampioneve që mbështjell të tërë, por në fakt po aq "share" do të duhet të kishte pasur edhe ekspozita me librat e lashtë, sepse impakti i tyre ka qenë ndër shekuj madje duke determinuar zhvillimet që rrjedhin dhe sot. Kjo pasuri që shfaqet në ekspozitën e quajtur "Urtësi e pashuar"

shfaq vëllime të rralla dhe të moçme të trashëgimisë që kemi në latinisht, shqip, greqisht, osmanisht, persisht. Po kaq i madh është ndikimi edhe pse i heshtur dhe shpesh edhe i fshehur. Por që është dëshmi se mbase s'është edhe aq çudi që shqiptarët sot mund të lënë gjurmë në botë se këtë e paskan bërë edhe më herët, por në forma dhe medie të tjera. Ose me fjalë të tjera e kanë bërë në rrjetet sociale të kohës, që kanë qenë librat dhe bibliotekat. Kur del nga kjo ekspozitë, që është e vendosur në qendër të Tiranës, tek ish shtëpia e diktatorit Enver Hoxha, dielli dhe temperaturat e larta si në filmat fantastiko-shkencor, të teleportojnë e të hedhin në kohën e tashme. Je i rrethuar menjëherë me lokale dhe zhurma ku sfondi muzikor popullor sërish është i një shqiptareje. Kënga dominante e kësaj vere filloi të marrë dhenë, e sërish ka lidhje me futboll dhe botën. Është ajo e Era Istrefit, që këndon bashkë me Will Smith dhe Nicky Jam. Himni i botërorit Rusi 2018, "Live it up" do të na shfaqet nga të gjitha anët sa do të na mërzhitet, por ky realiteti i krijimeve dhe ndikimeve shqiptare duket se s'ka të ndalur këtë javë e më hodhi nga e tashmja në lashtësi e prapë.

Dhe realisht për kaq pak ditë s'ka pasur kaq vetëdije për kaq shumë

impakt shqiptar. Dhe nuk mbaroi këtu. Java po më vë në dijeni edhe për personalitet të tjera, nga fusha të tjera që gjithashtu lënë gjurmë, por që nuk janë si këngët me të cilat përplasesh lehtë edhe kur nuk do.

Anri Sala, gjithashtu shfaqti një vepër në Tiranë. Pas disa muajsh do të jetë edhe në Shkup.

Dua Lipa, Rita Ora, Era Istrefi i artit modern botëror është Anri ynë. Konsiderohet si një nga artistët më të rëndësishëm të artit modern. S'ka galeri me rëndësi globale ku nuk ka ekspozuar dhe nuk lë mundësi pa shfrytëzuar që të shprehë dhe krijojë edhe në hapësirat tona duke i bërë ata qendra të këtij ndikimit global që vijon prej nga ne e shkojnë përtej.

Siç është dhe impakti edhe i Agon Hamzës, një filozofi i ri në moshë, nga Prishtina, por që citohet nga filozofët më në zë të së tashmes tonë, në rrafsh global. Edhe ai, duke jetuar dhe vepruar këtu, pranë nesh, arrin të përçojë perspektivat më tharmin e vendit ku krijon dhe ti transformojë në mendime universale. Dhe një sqarim, idetë filozofike që krijohen e determinojnë njerëzimin, impaktin e kanë shumë më vonë, a? Se ne sot jetojmë në fakt idetë e funksionimit të shoqërisë të shprehura nga filozofë shekuj më parë. Pra idetë e Hamzës por dhe të tjerëve, shqiptarë, po aq kontribuues në

filozofi, por që janë si librat e kodikëve, të heshtur e të thelluar në shkronja e tekste, do të kenë impakt edhe në të ardhmen. Është mirë të jemi të vetëdijshëm për këtë. Sigurisht ka dhe shumë të tjerë që kontribuojnë. Por përmend këta të dy, se brenda javës edhe ata ishin në Tiranë. Dhe realisht s'më ndodh shpesh që për disa ditë, një javë a më shumë, të ndeshem, të shoh dhe të takoj kaq shumë njerëz, tanët, të krijuar nga rrethanat dhe përvojat tona, me jetë dhe përditshmëri si e jona, e që kanë arritur të shpërthejnë aq shumë, sa të na kalojnë, neve, vetveten dhe të shërbejnë për gjithë njerëzimin. Më duket vetja si Uta Ibrahim, në majë të botës. E cila po këtë javë edhe ajo, sfidoi dhe hipi edhe në një majë tjetër të Himalajeve. Asnjë alpiniste shqiptare se ka bërë këtë gjë më parë.

Paralelisht me këtë realitet, që më dha një javë të bukur, është dhe ai i përditshmërisë të pisët, me intriga, politikë dhe probleme. Por them se ditët e bukura që jo shpesh vinë kaq shpesh, kaq afër njëra tjetrës, duhen festuar. Hmmm, po si? Normal me muzikë. Të dielën më 3 qershor, në Tiranë, ka koncert Rita Ora. Wowwww, çfarë javë e bukur!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 30 maj | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Të gjithë duan respekt, dhe sidomos Vladimir Putini



Nga
Kathleen PARKER

Reklamata e Facebook të blera nga Rusia gjatë fushatës së 2016-ës dhe të publikuara nga Kongresi këtë muaj zbulojnë qëllimin e qartë për të bërë kërdi në Shtetet e Bashkuara dhe duhet t'i bëjnë amerikanët të jenë të kujdesshëm dhe të ndihen të turpëruar. Ata gjithashtu dërguan një mesazh të qartë amerikanëve për komplimentet e Presidentit rus Vladimir Putin: Ju ngatërroheni me mua, unë do të ngatërrohem me ju. Ne i kemi lejuar vetes të jemi të prekshëm ndaj një shfrytëzimi të tillë të mediae sociale duke dështuar të kontrollojmë pasionet tona të manipuluar lehtësisht dhe me vetëdijen tonë. Dhe presioni i vazhdueshëm i presidentit Trump ndaj mediae legjitime dhe padurueshmëria e bazës së tij për ta përqaftuar këtë mesazh, me siguri i shërbejnë mirë Putinit dhe punonjësve të tij.

Infiltrimi brenda mendjes së Amerikës nuk ishte aq gjeniale sa ishte e lehtë. Modeli rus ishte në thelb Trumpian: Dëgjoni atë që njerëzit janë të shqetësuar, pastaj hidhni zjarr mbi të. Nëse emigracioni ju ka shqetësuar, mund të keni parë një reklamë në Facebook që paraqet një shenjë "No Invaders Allowed". Ose, në qoftë se racizmi është afër zemrës tuaj, mund të kishit parë një arkivol me flamur me

fjalët: "Një sulm tjetër i tmerrshëm ndaj policisë nga një aktivist i lëvizjes (Black Lives Matter)". Nëse besoni se një fitore e Hillary Clinton do të çonte në një shoqëri pa perëndi, mund të kishit parë një reklamë që përshkruante Satanin duke bërë mundje dore me Jezuin. Satanai thotë: "Nëse fitoj unë, Clinton fiton!"; Jezusi: "Jo, nëse ndihmoj unë!"

Pa lënë karrigen e tij, Putini mundi të depërtoj në psikologjitë amerikane, të përforcojë paragjykimet dhe të nxisë ritme të mjaftueshme për të krijuar një bazë – ose, mundësisht, një turmë. Ai pa dyshim shijoi shijen e kësaj fuqie. Ndërsa Putin vërtetë nuk pëlqen Clinton, nuk është e qartë nëse atij i pëlqen Trump në një mënyrë ose tjetër. Një komplot rus? Sigurisht, por duket gjithnjë e më shumë që, përveç disa përpjekjeve amatore nga njerëzit e Trump për të hedhur pluhur kundër Clinton, konspiracioni ishte kryesisht midis rusëve.

Dhe duket qartë në retrospektivë se kur hakerat hynë në fushatën e Clinton dhe Komitetit Kombëtar të Demokratëve dhe morën në dorë përmbajtjen e tyre, Putin po e linte Clintonin të kuptonte se çfarë mund të bënte: Nëse do të zgjidhej, ajo do ta merrte atë seriozisht.

Ndërkohë, Sturm und Drang e amerikanëve kundër Rusisë ka një

ndjenjë refleksive ndaj saj. "Urretja ndaj Rusisë është si hipja në një biçikletë," tha duke qeshur Nina Khrushcheva, mbesa e ish-kryeministrit sovjetik Nikita Khrushchev dhe profesoresh e marrëdhënieve ndërkombëtare në New School në Nju Jork. Ajo ka argumentuar që nga zgjedhja e Trump se Rusia po përpiqej të zbulonte dobësinë e Amerikës dhe të demonstronte sa lehtë Putin mund të ushtronte pushtetin e tij pa pasur nevojë të përdorte asgjë.

Ashtu si kolegu i tij i SHBA, Putini nuk është aq i komplikuar. Një përvojë e vogël me psikoanalizën ndihmon disi, por historia ndihmon shumë. Mos më ndaloni nëse e keni dëgjuar këtë më parë: një histori që Presidenti Xhorxh W. Bush më tha përsëritet. Putin e kishte ftuar Bushin në Rusi pas vizitës së tij në Crawford, Teksas, ku të dy nxituan rreth fermës në kamionin e W. Kam një fotografi të të dyve të ulur krah për krah, duke u zgërdhirë si djem duke anashkaluar shkollën.

Putini kishte vënë re Terrierin skocez të familjes Bush, Barney, dhe donte t'i tregonte presidentit të SHBA qenin e tij. Siç tregoi Bush, një kafshë gjigante (një Labrador) erdhi në drejtim të tij dhe filloi të rrotullohej. Pas disa xhiro, Putini buzëqeshi dhe tha, "Më i madh, më i fortë,



Putini kishte vënë re Terrierin skocez të familjes Bush, Barney, dhe donte t'i tregonte presidentit të SHBA qenin e tij. Siç tregoi Bush, një kafshë gjigante (një Labrador) erdhi në drejtim të tij dhe filloi të rrotullohej. Pas disa xhiro, Putini buzëqeshi dhe tha, "Më i madh, më i fortë, më i shpejtë, më i keq se Barney". Bush e kuptoi këtë moment dhe e lejoi që ta udhëzojë atë në marrëdhëniet e tij me presidentin rus. Ai kuptoi se Putini kishte uri për respekt, që ai dëshironte të njëjhej si

më i shpejtë, më i keq se Barney". Bush e kuptoi këtë moment dhe e lejoi që ta udhëzojë atë në marrëdhëniet e tij me presidentin rus. Ai kuptoi se Putini kishte uri për respekt, që ai dëshironte të njëjhej si

një fuqi e barabartë, nëse jo më e madhe se, Bush. Megjithëse Bush i dha Putinit respekt-me-mosbesim, pasardhësi i tij nuk e bëri.

Distanca e presidentit Obama ndaj Putinit, i kombinuar me dënimin e Clinton për zgjedhjet e Rusisë si sekretare e shtetit, ndoshta i dha Putinit nxitjen për të luftuar përsëri në mënyrën e vet. Sipas pikëpamjes së Khrushcheva, Putini nuk mendon se ka bërë ndonjë gjë të gabuar. Sa për rusët e zakonshëm, ata e gjejnë këtë histori mjaft zbavitëse. Khrushcheva vëren se ish bashkatdhetarët e saj ose e duan ose e urrejnë Amerikën, me pak dritë në mes. Megjithatë, shumica dërrmuese nuk e kuptojnë se përse amerikanët vazhdojnë të mbështeten në jashtëzakonshmërinë e tyre historike.

Shumë vende na kanë parë të gënjejnë dhe të ndërhyjnë në punët e tyre. Kanë parë që ne pushtojmë kombe dhe instalojmë baza ushtarake. Krenaria jonë e madhe për epërsinë e mirësisë sonë mund të shihet nga të tjerët si mburrje arrogante. Në fund të ditës, të gjithë duan respekt, asgjë më shumë, me sa duket, sesa diktatorët dhe presidentët e zgjedhur padrejtësisht, si Putini. Në mënyrë të kujdesshme, ne vërejmë se ata do të bëjnë gjithçka për të marrë atë.

(The Washington Post)

Tensionet mes SHBA dhe Iranit ndihmojnë Rusinë



Nga
Bernard GUETTA

Gjërat nuk do të ndryshojnë brenda natës, por vizita e Emmanuel Macron në Rusi, e caktuar për në 25 maj, mund të ndryshojë reagimin zinxhir të ngjarjeve që po ndodhin në botë. E gjitha filloi më 8 maj, kur Donald Trump njoftoi tërheqjen e SHBA nga marrëveshja bërthamore e firmosur në vitin 2015 me Iranin, nga fuqitë e mëdha. Aleanca e Atlantikut është ndarë, sepse evropianët - duke filluar me Francën, Gjermaninë dhe Mbretërinë e Bashkuar - e kanë dënuar vendimin e Uashingtonit dhe janë gjendur në mospërrthje të plotë me aleatin e tyre amerikan, dhe më pranë Rusisë, Kinës e madje edhe Iranit, me vullnetin e tyre për të mos braktisur kompromisin e vitit 2015.

Në të kaluarën, Franca ishte në kundërshtim me Shtetet e Bashkuara dhe aksi franko-gjerman



kishte bërë një front të përbashkët, për të kundërshtuar aventurën e Xhorxh Bushit në Irak, por një çarje totale mes Shteteve të Bashkuara dhe Evropës: kjo është një risi absolute. Asgjë e tillë nuk ishte parë ndonjëherë. Ndër të tjera, kjo është një ndarje të thellë, për shkak se amerikanët (dhe e përsëritën më 21 maj) kanë për qëllim të ndalojnë kompanitë europiane, që të vazhdojnë tregtinë me Iranin, duke

kërcënuar me sanksione.

Përveç pasojave mbi NATO-n, deklarata e Donald Trump ka pasur pasojë të mëdha në Lindjen e Mesme, duke bërë që Arabia Saudite të bëhet aleate me amerikanët dhe izraelitët, ndërsa Irani e ka mirëpritur zgjedhjen kundër rrymës të evropianëve. Udhëheqësit e Iranit jo vetëm që kanë frikë të përjashtohen nga tregtia ndërkombëtare, por mes reshtave lënë të kuptohet



Gjërat nuk ndryshojnë nga njëra ditë në tjetër, por tridhjetë orët që Emmanuel Macron do të kalojnë në Shën Petersburg, do të duhet të ndiqen me vëmendje

që, nëse Evropa do të sfidojë bllokadën e SHBA mund të jenë të gatshëm për të hapur, siç është kërkuar nga Franca, negociatat e reja mbi raketat, krizat rajonale dhe të ardhmen e marrëveshjes bërthamore, që do të skadojë në vitin 2025.

Vështirësia e Teheranit është e dukshme dhe e vë Rusinë në një

pozitë, për të marrë më shumë lëshime nga Irani, në kushtet e një marrëveshjeje paqeje në Siri. Donald Trump, në thelb, e forcon pozitën e Putinit në Lindjen e Mesme. Por kjo nuk është e gjitha. Le të kthehemi në Evropë. Kontinenti i vjetër, i udhëhequr nga Franca, mund t'i tregojë Putinit se ka ardhur koha për të hapur një proces stabilizimi në Lindjen e Mesme me evropianët, sukcesi i të cilës do të mund të rikthente besimin midis Bashkimit Evropian dhe Federatës Ruse, duke i sjellë dy fuqitë, një ditë, drejt një marrëveshjeje sigurie dhe bashkëpunimi, të tilla si ato që ekzistonin midis Bashkimit Sovjetik dhe perëndimorëve. Gjërat nuk ndryshojnë nga njëra ditë në tjetër, por tridhjetë orët që Emmanuel Macron do të kalojnë në Shën Petersburg, do të duhet të ndiqen me vëmendje.



THIRRJE PUBLIKE
PËR NDAJJE TË KONCESIONEVE PËR HULUMTIME TË DETAJUARA GJEOLGJIKE TË LËNDËVE TË PARA MINERALE
5/2018

Shkup, maj 2018

Në bazë të nenit 28 paragrafi 1 e Ligjit për koncesione dhe të partneritetit publik dhe privat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 6/12, 144/14, 33/15, 104/15 dhe 215/15), nenit 10 paragrafi 2 të Ligjit për Lëndët e para të mineraleve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/12, 25/13, 93/13, 44/14, 160/14, 129/15, 192/15, 39/16, 53/16, 120/16 dhe 189/16), Vendimit për fillim të procedurës për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale nr. 44-1761/1 të datës 06.03.2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/2018), Komisioni për zbatim të procedurës për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale publikon

THIRRJE PUBLIKE
PËR NDAJJE TË KONCESIONEVE PËR HULUMTIME TË DETAJUARA GJEOLGJIKE TË LËNDËVE TË PARA MINERALE
5/2018

1. Koncedent është Republika e Maqedonisë - Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

2. Lëndë e kësaj thirrje publike është ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale të lokaliteteve nga Vendimi për fillim të procedurës për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale nr. 44-1761/1 të datës 06.03.2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/2018), edhe atë:

- "Tërnicë" Komuna e Studeniçanit, për lëndë të parë minerale – rërë dhe zhavorr;
- "Fabrika Kvatro" – Komuna e Kumanovës për lëndën e parë minerale – ujë mineral;

3. Koncesioni për hulumtime të detajuara gjeologjike ndahen për periudhë prej:

- dy vjet për lëndë të para minerale jo metalike dhe
- dy vjet për ujë mineral

4. Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë të gjitha subjektet e vendit dhe të huaj juridike dhe konkursime të cilët do të marrin dokumentacionin tenderues përmes sistemit elektronik www.e-koncesii.mk dhe do ti plotësojnë kushtet në pajtim me përcaktimet në dokumentacionin tenderues.

5. Në dokumentacionin tenderues janë të përbajtura të dhëna në lidhje me lokalitetet për të cilat jepen koncesionet për hulumtime të detajuara gjeologjike, si dhe vlera e ofertës së projektit koncesionues i shprehur si shumë e vlerësuar fillestare e koncesionit dhe kushte që duhet të plotësohen nga ana e koncesionerit.

6. Ofertuesit duhet domosdo përmes sistemit www.e-koncesii.mk të dorëzojnë dokumentacionin e skanuar në vijim për të dëshmuar kushtet personale, profesionale dhe financiare që duhet ti plotësojnë për pjesëmarrje në Thirrjen publike:

1) Dokument për veprimtari të regjistruar dhe gjendja aktuale
- Për subjektet e vendit juridike: dokument për veprimtari të regjistruar dhe gjendja aktuale nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;

- Për subjektet e huaj juridike: dokument nga organi kompetent – vërtetim se gjendet në regjistrin zyrtar tregtar që udhëhiqet nga ana e organit kompetent të shtetit ose vërtetim nga organi kompetent për certifikim që i plotëson kushtet të përcaktuara me ligj;

2) Informata për gjendje ekonomiko-financiare të subjektit
- Për subjektet e vendit juridike: Informata për gjendje ekonomiko-financiare të subjektit të cilin e jep Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, raportet pozitive financiare, së paku për vitin e fundit. Nëse subjekti juridik është i regjistruar në periudhë më të shkurt se kjo, raportet financiare dorëzohen për periudhë prej regjistrimit;

- Për subjektet e huaj juridike: raporti pozitiv revizor nga institucioni revizor me repute të regjistruar për kryerje të revizionit. Raporti revizor të përmbajë të dhëna për punën e përgjithshme ekonomike të ofertuesit të huaj për vitin e fundit. Nëse subjekti juridik është i regjistruar në periudhë më të shkurt se kjo, raportet financiare të dorëzohen për periudhë prej kohës së regjistrimit;

3) Certifikatë për tatimet dhe kontributet e paguara
- Për subjektet e vendit juridike: të dhëna nga Drejtoria për të hyra publike e Republikës së Maqedonisë;
- Për subjektet e huaj juridike dokument të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.

4) Dokument se ndaj personit nuk ka procedurë se është në falimentim

- Për subjektet e vendit juridike të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
- Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.

5) Dokument se ndaj personit nuk ka procedurë se është në likuidim

- Për subjektet e vendit juridike të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
- Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.

6) Dokument se nuk i është shqiptuar dënim për vepra penale:
- Për subjektet e vendit juridike të dhënë për vendin penal gjyqësor të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;

- Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.

7) Dokument se nuk i është shqiptuar dënim në procedurë kundërvajtje ndalesë për kryerje të detyrës profesionale:

- Për subjektet e vendit juridike të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë;
- Për subjektet e huaj juridike të dhënë nga organi kompetent i shtetit prej nga vjen.

8) Deklaratë të vërtetuar në noter nga personi përgjegjës se personi juridik ose anëtar i organit të tij për menaxhim ose organi

mbikëqyrës nuk janë të dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për veprat penale në vijim: korrupsion, mashtrim dhe larje parash; (ANEKS GJ)

- Për ofertuesit e huaj është e nevojshme që deklarata e tillë të jetë e vërtetuar në noter, ose nga ndonjë organ tjetër derisa në shtetin prej nga vjen ekziston institucion i tillë që kryen vlerësimin e llojeve të tilla të deklaratave.

9) Deklaratë, të vërtetuar në noter, se subjektit juridik duke përfshirë edhe subjektet e huaja juridike me filial të shënuar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë më herët nuk i është marrë koncesion për hulumtime të detajuara gjeologjike ose eksploitim të lëndëve të para minerale, si subjekt juridik që është i lidhur me atë subjekt juridik; (ANEKS Z)

10) Për konzorcium është e nevojshme çdo anëtar i grupit të plotësojë të gjitha kushtet personale, profesionale dhe financiare të kësaj pike.

Vetëm ofertat e ofertuesve të cilët janë të vlerësuar si të aftë do të jenë lëndë e evaluimit.

7. Ofertuesit domosdo përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë duhet të dorëzojnë Garancinë tenderuese në origjinal më së voni në ditën dhe orën e hapjes publike të ofertave.

8. Oferta e tërësishme duhet të jetë në gjuhën maqedonase. Dokumentacioni shoqëruar i ofertës, e cila kërkohet në pajtim me dokumentacionin tenderues, duhet të jetë e skanuar nga origjinali. Ofertuesit të cilët do të zgjidhen si më të volitshëm duhet të dorëzojnë në origjinal dokumentacionin të cilin më herët e kanë të skanuar dhe të vendosur në ueb portalin www.e-koncesii.mk, në afat prej 5 ditëve nga dita e pranimit të kumtesës dhe Vendimit për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm. Nëse bëhet fjalë për ofertues të huaj, ky dokumentacion duhet të përkthehet nga ana e përkthyesit të autorizuar gjyqësor në gjuhën maqedonase. Dokumentacioni nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga dita e hapjes së Thirrjes Publike, përveç se Raportit revizor.

9. Secili ofertues mund të ofrojë vetëm një pako ofertuese për lokalitetet e theksuar nga Thirrja publike.

10. Dokumentacioni tenderues merret në mënyrë elektronike nga ueb portalin: www.e-koncesii.mk. Të drejtë për marrje të dokumentacionit tenderues ka çdo subjekt i cili do të regjistrohet në ueb portalin: www.e-koncesii.mk. Të drejtë për pjesëmarrje në procedurën e mëtuajtshme të Thirrjes publike ka çdo subjekt i regjistruar në ueb portalin: www.e-koncesii.mk, i cili ka marrë dokumentacionin tenderues, ka aplikuar me ofertë të vet dhe ka dorëzuar dëshmi për pagesë të realizuar për dokumentacionin e marrë tenderues. Dokumentacioni tenderues mund të merret në portalin: www.e-koncesii.mk

11. Ofertat duhen të jenë me afat të vlefshëm për një vit duke filluar nga data e hapjes publike.

Për të aplikuar në thirrjen publike, ofertuesi i interesuar është i obliguar që të paguajë mjete të pakthyeshme në shumë prej 6.000,00 (gjashtë mijë) denarë, të skenohet fletëpagesën dhe ta postojë përmes sistemit në www.e-koncesii.mk.

Pagesa duhet të bëhet në interes të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, me shenjë: për dokumentacion tenderues për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale sipas Vendimit për fillim të procedurës për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale nr. nr. 44-1761/1 të datës 06.03.2018 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/2018):

Llogaria trezore: 100000000063095

Llogaria e pagesës: 840 06163

Shifra e të hyrave dhe programi: 724125-00

Deponent: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë

Numri tatimor: 4030000392597

Për ofertuesit e huaj:

Ministria e ekonomisë

Banka popullore e Republikës së Maqedonisë

Bul. Kuzman Josifovski Pitu nr. 1

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

SWIFT BIC: NBRM MK 2X

IBAN: MK07 1007 0100 0028 009

12. Ofertat dorëzohen përmes portalit www.e-koncesii.mk, ndërsa vetëm Garancia tenderuese dorëzohet përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë.

13. Afati për parashtrimin e ofertave dhe Garancisë tenderuese është më së voni deri më 10.07.2018 deri në ora 10.00.

14. Hapja publike e ofertave do të bëhet më datë 10.07.2018 në ora 10.00, në lokalitetin e Ministrisë së ekonomisë me adresë në rr. Jurij Gagarin nr. 15 Shkup. Do të shqyrtohen vetëm ofertat të dorëzuara përmes sistemit www.e-koncesii.mk dhe garancia tenderuese e dorëzuar përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë.

15. Pajoja e ofruar duhet të përmbajë gjërat në vijim:

- Letër për ofertë,
- Garanci tenderuese dhe
- Dokumente me të cilat dëshmohet plotësimi i kushteve personale, profesionale dhe financiare të ofertuesit, të theksuara në pikën 6 të kësaj thirrje publike.

16. Gjatë zgjedhjes së ofertuesit më të volitshëm do të shqyrtohen vetëm ofertat që e përmbajnë dokumentacionin e plotë në pajtim me Dokumentacionin tenderues.

17. Kriteri sipas të cilit do të bëhet zgjedhja e ofertës më të volitshme është kompensimi më lartë i ofruar i koncesionit, por jo më i ulët se çmimi fillestar për lokalitetin dhe lëndën e parë minerale teknogjene të kësaj Thirrje publike.

Kushti për vlerësimin e ofertave është Garancia e rregulluar tenderuese.

18. Ankandi publik përmes sistemit për ankand elektronik www.e-koncesii.mk, do të mbahet më 13.07.2018 prej ora 10:00.

19. Obligimet e koncesionerit do të përcaktohen në Marrëveshjen për koncesion për hulumtime të detajuara gjeologjike. Koncesioneri është i obliguar që hulumtimet e detajuara gjeologjike të kryejë në pajtim me ligjet dhe rregullat në fuqi të Republikës së Maqedonisë.

20. Qeveria e Republikës së Maqedonisë: mund të kryejë ndryshim ose plotësim të dokumentacionit tenderues, më së voni 15 ditë para kalimit të afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave, të mos ndajë koncesionet ose plotësisht të ndërpresë procedurën.

21. Mënyra e evaluimit të ofertave:
Dorëzimi i ofertave bëhet përmes portalit www.e-koncesii.mk, gjegjësisht vetëm Garancia tenderuese dorëzohet përmes arkivit të Ministrisë së ekonomisë.

Evaluimi bëhet për të gjitha ofertat të dorëzuara deri më 10.07.2018 deri në ora 10:00.

Evaluimi i ofertave do të realizohet në dy mënyra, edhe atë:
Në hapin e parë kontrollonhet kompletimi dhe validiteti i Dokumentacionit të domosdoshëm.

Nëse vërtetohet se dokumentacioni nuk është i kompletuar, oferta financiare nuk shqyrtohet dhe ofertuesit nuk do ti lejohet pjesëmarrje në ankandin elektronik.

Në hapin e dytë, pas vërtetimit të kompletimit dhe validitetit të dokumentacionit nga ana e Komisionit, shqyrtohet oferta financiare dhe lejohet qasje në sistemin për pjesëmarrje në ankandin elektronik. Secili ofertues në sistem mund të shohë rangimin e tij aktual në relacion me ofertat financiare dhe mund të ofrojë në pajtim me rregullat e definuara të publikuara në sistemin www.e-koncesii.mk.

Komisioni do të përpilojë Raport të evaluimit të ofertave, në të cilin do të përshkruhet procedura gjatë evaluimit, ankandi elektronik (ankandi), vërejtjet eventuale dhe arsyetimet e Komisionit.

22. Organi kompetent për shqyrtimin e ankesave në procedurën për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale është Komisioni shtetëror i ankesave për furnizime publike (bul. "Ilinden" nr. 63 A, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë). Ankesa mund të shtrohet në afat prej tetë ditëve nga dita e:

- publikimit të Thirrjes publike për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale në lidhje me të dhënat, veprimet ose lëshimet për ndërmarrjen e veprimeve nga Thirrja publike;

- evaluimi i ofertave, në lidhje me veprimet ose lëshimet e ndërmarrjes së veprimeve në lidhje me dokumentacionin tenderues, gjegjësisht procedurën për evoluimin e ofertave dhe ankandit;

- pranimit të vendimit me të cilin vendoset për të drejtë individuale nga procedura për ndarje të koncesionit për hulumtim të detajuar gjeologjik të lëndëve të para minerale në lidhje me vërtetimin e aftësisë së paraqitjeve për pjesëmarrje ose evaluim të ofertave dhe vendimit dhe

- informatë për parregullsi gjatë procedurës së ndarjes së koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike të lëndëve të para minerale, më së voni në afat prej një viti nga dita e mbarimit të procedurës së realizuar.

23. Për të gjitha çështjet në lidhje me këtë thirrje publike kandidatët e interesuar mund të drejtohen tek personat e autorizuar për kontakt:

Florent Çiçe tel: +389 2 3093 481
e-mail: florent.c@economy.gov.mk

Lupçe Efnusev tel: +389 2 3093 520
e-mail: ljupce.efnusev@economy.gov.mk

Komisioni për realizim të procedurës për ndarje të koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike për lëndët e para minera



NJOFTIM për ndërrimin e selisë

Shoqëria për shërbime të komunikimit ONE.VIP DOOEL Shkup njofton shfrytëzuesit dhe biznes partnerët e vet, institucionet dhe tërë publikun se nga data 01.06.2018 selia e kompanisë do të transferohet në adresë të re:

**Ploshtad Presveta Bogorodica 1
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë**

Për komunikim pa pengesë, nëse keni nevojë për ndonjë korrespondencë me shkrim ose përgatitje dhe dorëzim të dokumenteve në ONE.VIP DOOEL Skopje, Ju lutemi përdorni adresën e re të selisë.

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015-teksti i pastruar) dhe nenit 142 paragrafi 1 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013), UD Drejtori i IPKÇF "Majski Cvet" Manastir publikon

SHPALLJE PUBLIKE Për punësim për kohë të pacaktuar

1. Edukator për fëmijët e moshës prej 2-6 vjeç – një (1) realizues për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme

-Profesor i diplomuar i lartë/sipëror për edukim parashkollor, edukator i diplomuar për fëmijë të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar të shkallës VII/1 ose me arsim të lartë të mbaruar përkatës për edukatorë dhe me licencë valide për edukator.

- pa përvojë pune

- licencë valide për edukatorë

Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat ndahen në 30 orë për punë të drejtpërdrejta me fëmijë, dhe koha e mbetur për aktivitete tjera, prej ditës së hënë deri ditën e premte; orari i kohës së punës caktohet në mënyrë të shkallëzuar në kuadër të orarit të punës prej ora 5:30 deri në ora 18:00.

Neto pagesa bazë është 19.581,00 denarë për përgatitje sipërore profesionale ose 18.515,00 për përgatitje të lartë profesionale.

2. Përkëdhelës – tre (3) realizues për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme

- PMP – arsim të mesëm katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës

- pa përvojë pune

- licencë valide për përkëdhelës

Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat janë të shpërndara në 35 orë për punë drejtpërdrejta me fëmijë, ndërsa koha tjetër për aktivitete tjera prej ditës së hënë deri ditën e premte; orari i punës është me shkallë në kuadër të orarit të punës prej ora 5:30 deri në ora 18:30.

Neto pagesa bazë është 14.780,00 denarë.

Krahas kushteve të posaçme të theksuara kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme ligjore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Lutje

- Diplomë (Certifikatë), Dëftesë për arsimin e mbaruar përkatës (original ose kopje të vërtetuara);

- Licencë valide (për edukator ose përkëdhelës)

- Certifikatë të shtetësisë së RM (jo më të vjetër se gjashtë muaj);

- Certifikatë të lindjes

- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën do dënohet për veprë penale dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

Shpallja zgjatë pesë (5) ditë pune nga dita e publikimit të saj.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej dyzetepesë (45) ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentacioni i kompletuar të dorëzohet në adresën: IPKÇF "Majski Cvet" – Manastir, rr. "Smilevski Kongres" pn, Manastir.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IPKÇF "MAJSKI CVET"
MANASTIR

Këshilli për ndarje të shpërblimit shtetëror "Sv. Kliment Ohridski" shpallë **KONKURS**

për ndarje të shpërblimit shtetëror "Sv. Kliment Ohridski" në vitin 2018

Me shpërblimin shtetëror 'Sv. Kliment Ohridski' jepet mirënjohje më e lartë për të arriturat shumëvjeçare në fushën e edukimit, arsimit, kulturës, artit, shëndetësisë, mbrojtjes dhe përparimin e ambientit të njeriut dhe veprimtari sociale.

Shpërblimi shtetëror u ndahet individëve, grup krijuesish, ekipeve, institucioneve, shoqërive tregtare dhe shoqatave të qytetarëve.

Shpërblimi shtetëror sipas kushteve të përcaktuara në konkurs mund t'u ndahet edhe shtetasve të huaj, grup krijuesish, ekipe dhe institucione nga jashtë me interes publik në Republikën e Maqedonisë.

Individit të shpërblyer i ndahet: diplomë dhe shumë të hollash.

Secilit anëtar të grupit ose ekipit të shpërblyer të krijuesve u ndahen diploma dhe pjesë të barabarta të shumës së parave.

Institucionit, shoqërisë ose shoqatës tregtare të qytetarëve të shpërblyera u ndahen diplomë dhe pllaketë.

Shuma e të hollave të shpërblimit shtetëror 'Sv. Kliment Ohridski' arrin dhjetë (10) rroga mujore mesatare në Republikën e Maqedonisë të paguara tre muajt e fundit të vitit aktual.

Shpërblimi shtetëror 'Sv. Kliment Ohridski' sipas rregullit, ndahet çdo vit.

Në një vit mund të ndahen më së shumti deri në pesë (5) shpërblime.

Iniciativë për ndarjen e shpërblimit shtetëror 'Sv. Kliment Ohridski' mund të parashtrihen: institucionet, shoqëritë tregtare, shoqatat qytetare dhe qytetarët.

Parashtruesit e iniciativës për ndarjen e shpërblimit shtetëror duhet në detaje të arsyetojnë iniciativën. Në tekst duhet të jenë të përmbajtura edhe: të dhëna të sakta biografike, adresë të saktë banimi (adresa-rruga, numri, vendi, qyteti, shteti), të dhëna për rezultatet e arritura në fushën në të cilën është arritur e realizuara dhe të dhëna të tjera të cilat llogariten se do të kontribuojnë në vlerësim.

Parashtruesi i iniciativës duhet të vendosë emrin dhe mbiemrin e plotë, titullin, firmën, adresën dhe numrin e telefonit.

Teksti i iniciativës (i kompletuar) të dorëzohet në 20 kopje, ndërsa punimet (librat, publikimet etj) trajtohen si shtojca dhe duhet të dorëzohen në një (1) kopje.

Iniciativat duhet të dorëzohen në adresën në vijim:

Ministria e kulturës e Republikës së Maqedonisë – Këshilli për ndarje të shpërblimit shtetëror 'Sv. Kliment Ohridski', rr. 'Gjuro Gjakoviq' nr. 61 – Shkup, Republika e Maqedonisë.

Konkursi zgjatë prej 1 deri më 30 qershor 2018.

Iniciativat e pakompletuara dhe iniciativat dhe propozimet (punimet, librat, publikimet etj) të dorëzuara pas afatit të përcaktuar për praninë në konkurs nuk do të merren parasysh.

**Këshilli për ndarje të shpërblimit të
"Sv. Kliment Ohridski"**

Ankesat ndaj punës së Eulex-it për mungesë aftësish dhe kompetencash u shtuan. Por edhe për pagesat e mëdha të personave që shumë pak i njohin rrethanat lokale. Kryetari i bashkisë në Prishtinë është ankuar se prokurorët e Eulex-it nuk interesohen shumë për dokumentet e tyre që dëshmojnë korrupsionin në dhënien e tenderëve

Shtypi gjerman i kushton vëmendje të posaçme situatës në Kosovë, largimit të EULEX-it dhe rrugëve të reja të refugjatëve në Ballkan.

"Ajo që pushtetmbajtësit kërkojnë kaheerë në Kosovë do të ndodhë në qershor: Misioni i Eulex-it do të largohet, por do të mbetet një mision i vogël këshillues".

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, thotë se tani ata edhe vet mund t'i kryejnë këto punë.

"Nuk kemi nevojë për një mision tjetër të huaj me të drejta ekzekutive".

"Eulex-i ka qenë misioni më i madh i Bashkimit Evropian deri tani. Dikur ka pasur në Kosovë deri në 2000 policë, gjykatës dhe doganierë, ndërsa buxheti vjetor ka qenë rreth 200 milionë euro. Misioni është zvogëluar shumë herë, ndërsa aktualisht në Kosovë ka rreth 800 nëpunës, me një buxhet prej 60 milionë. Kosovarët e kanë përshëndetur ardhjen e Eulex-it me

MEDIAT GJERMANE: EULEX-I NUK DO T'I MUNGOJË ASKUJT



shpresë se misioni do të vendosë barazinë para gjyqeve dhe do të mundësojë ndarjen e pushtetit. Pas heqjes së autonomisë së Kosovës në vitin 1989 nga autoritetet e Serbisë, në Kosovë nuk ka pasur shtet juridik. Ndërsa raporte demokratike nuk ka pasur as më parë. Misioni kishte paralajmëruar në fillim se do të ndiqen të gjithë, pavarësisht funksionit politik që kryejnë. Ato thoshin se do të peshkojnë edhe "peshq të mëdhenj".

"Por shumë shpejt erdhi dëshpërimi. Proceset spektakolare munguan. Ankesat ndaj punës së Eulex-it për mungesë aftësish dhe kompetencash u shtuan. Por edhe për pagesat e mëdha të personave që shumë pak i njohin rrethanat lokale. Kryetari i bashkisë në Prish-

tinë është ankuar se prokurorët e Eulex-it nuk interesohen shumë për dokumentet e tyre që dëshmojnë korrupsionin në dhënien e tenderëve. Shumë shpejt erdhën edhe akuzat për korrupsionin e vet Eulex-it [...] Shkrimet negative të mediave për Eulex ishin po ashtu pjesë e fushatës kundër tij. Këtë fushatë e kanë nisur qarqet politike në Kosovë, por edhe opozita majtiste, e cila këtë mision e sheh si një instrument të represionit kolonialist."

"Në verën e vitit 2014, prokurorja e Eulex-it, Maria Barnie doli në opinion me pohimet për korrupsionin dhe ryshfetin e marrë nga dy kolegë të saj nga mafia e Kosovës. Kjo rezultoi me kërkesën e raportit të detajuar. Juristi fran-

cez Jean Pole Jeake konstatoi se akuzat e saj janë të pabaza, por kërkoi reforma. Reformat përfunduan vetëm me ndërrimin e funksioneve dhe uljen e numrit dhe të kompetencave të autoriteteve të Eulex-it".

"Ish-shefi i sektorit ekonomik Andrea Kapusela ka shkruar në vitin 2015 një libër ku thuhet se prokurorët e misionit u kanë ikur hetimeve të ndjeshme, ku ishin të përzier edhe kërret e politikës. Ai konstaton se ky ishte çmimi i ruajtjes së stabilitetit politik në Kosovë. Me fjalë të tjera, ndjekja e denjë penale do të thoshte edhe 'regime change' (ndryshimin e pushtetit). Përfaqësuesit e BE nuk kanë dashur t'i futen këtij rreziku", shkruan NZZ. /DW/



Dërgohet në Kuvendin e Kosovës Statuti për Trepçën

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka ka bërë të ditur se në mbledhjen e qeverisë është miratuar dhe dërguar në Kuvendin e Kosovës, Statuti për Trepçën.

Me këtë rast ministri ka deklaruar se kështu është duke u hapur rruga drejt themelimit të Trepça Sh.A dhe njëkohësisht zhvillimi i këtij gjiganti ekonomik.

Llluka tha se bashkë me status janë dërguar edhe informatat shtesë të deponuara nga Sindikata të cilat do të trajtohen nga Kuvendi i Kosovës.

Lidhur me këtë kryeministri, Ramush Haradinaj në mbledhjen e sotme ka thënë se kur të votohet ky status në Kuvend, do të jetë momenti i madh për Kosovën.

Postimi i plotë nga Llluka:

"Me propozim të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, sapo miratuar dhe dërguar në Kuvendin e Kosovës Statutin për Trepçën, duke hapur kështu rrugën drejtë themelimit të Trepça Sh.A. dhe njëkohësisht zhvillimin e këtij gjiganti ekonomik.

Së bashku me statut, janë dërguar edhe informatat shtesë të deponuara nga Sindikata të cilat do të trajtohen nga Kuvendi i Kosovës.

Falenderoj anëtarët e Bordit Mbikëqyrës për punën intensive gjatë këtyre dy muajve. Urime Mitrovicë!"

Nuk më vjen keq për shqiptarët që kërkojnë azil në Europë

Vitet e fundit qindra mijëra shqiptarë kanë provuar të marrin azil në vendet e Bashkimit Evropian, në disa vite duke pasur numrin më të lartë të aplikimeve.

Kryeministri shqiptar po përsëriste të njëjtën teori në France 24, që kjo është diçka normale, që emigrimi për një punë më të mirë është një fenomen i njohur në të gjithë botën, kur gazetarja e ka

pyetur: A nuk ju vjen keq për ta? Përgjigjia e Ramës ka qenë mohuese. "Të më vijë keq? Jo, sepse historia tregon se vendet më të pasura të EU kanë qenë të varfëra, por njerëzit kanë emigruar, kanë ndihmuar familjet, kanë mësuar gjera të reja dhe janë rikthyer duke pasuruar vendet e tyre" u shpreh kryeministri.

Me qëllim, Edi Rama ngatrron

emigrimin e njerëzve për një punë dhe për një jetë më të mirë me aventurën ku u futën qindra mijëra shqiptarë duke jetuar në kampet e azilantëve në Gjermani, Francë, Danimarkë, Holandë etj.

Shumë prej tyre kanë mbijetuar në kushte mizerabël duke braktisur shtëpitë dhe qytetet ku jetonin prej vitesh për shkak të taksave, mungesës së spitaleve,



krimin, korrupsionit dhe mungesës së shpresës për një jetë më të mirë. /lapsi.al

POLITIKANËT DHE ARTISTËT QË MORËN KREDI SHTETI SI TË PASTREHË

Mbi 140 zyrtarë dhe ish-zyrtarë të lartë, por edhe artistë kanë marrë kredi shteti nga Enti Kombëtar të Banesave. Pra janë trajtuar si të pastrehë. Mes tyre ka edhe emra të njohur, ish-kreu i SHISH Visho Ajazi, këngëtarja Vikena Kamenica, ish-ministri Spiro Ksera, etj. Së fundmi është vendosur që ata të përjashtohen nga falja e kësteve të mbetura të kredive.

mnistia parashikohet në nenin 77, pika 5 e ligjit të ri për strehimin social. "Familjeve të shpërngulura për shkak të ndërtimit të



veprave publike dhe në pamundësi financiare, të cilat kanë përfutuar kredi nëpërmjet Entit

Kombëtar të Banesave, u falen detyrimet monetare, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të

Ministrave", thuhet në ligjin e miratuar nga Parlamenti.

Ndërkaq, varianti i parë i projektligjit, parashikonte përfshirjen në amnisti edhe të kategorive të tjera. Varianti i parë parashikonte: "Familjeve të shpërngulura për shkak të ndërtimit të veprave publike dhe kategorive të tjera në pamundësi financiare, të cilat kanë përfutuar kredi nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, u falen detyrimet monetare, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave".

Gjatë shqyrtimit, ligjvënës

kanë hequr togfjalëshin 'kategori të tjera', duke e kufizuar amnistinë. Shqiptarja.com që ka publikuar edhe listën shkruan se me 'kategori të tjera' mund të përfitonin edhe mbi 140 zyrtarë, duke përfshirë deputetë, drejtorë etj., të cilët kanë marrë kredi si të pastrehë nga Enti Kombëtar të Banesave, ndonëse sot posedojnë disa shtëpi luksoze dhe makina deri në vlerën e një banese. Gjithsesi, në mënyrë përfundimtare, familjet që do t'u falen këstet e mbetura të kredive do të përcaktohen me vendim qeverie./Shekulli

Jemi në prag lufte me Gazën

Militantë palestinezë kanë ndërmarrë të martën sulmet më të rënda me prita kundrejt Izraelit që prej luftës së vitit 2014 në Gaza, ndërsa forcat izraelite janë kundërpërgjigjur me sulme ajrore në një përshkallëzim të luftimeve pas javëve të tëra të dhunshme në kufi.

Tre ushtarë izraelitë janë plagosur copat e predhave pas shpërthimeve të fuqishme, sipas ushtrisë izraelite, pas dhjetëra mortaja e raketa u lëshuan nga Rripsi i Gazës, duke shkaktuar rënien e alarmit paralajmëruar në zonën jugore të Izraelit përgjatë

të gjithë ditës.

Sa u përket viktimave mes palestinezëve, ende nuk ka raporte zyrtare. Izraeli e ka thënë prej kohësh se nuk do të tolerojë të tilla sulme, ndaj dhe avionët luftarakë kanë goditur më shumë se 30 objektiva që u përkisnin grupeve të armatosura, përfshi edhe një tunel në ndërtim e sipër ndërkufitar, sipas ushtrisë hebreje. Ajo akuzon drejtpërdrejt lëvizjen që dominon Gazën, Hamas, si dhe një grup xhihadist islamik pro Iranit, për nisjen e sulmeve.

Në fakt, përgjegjësinë për prita e ngritura nuk e ka marrë ende

asnjë organizatë, edhe pse ky reagim vjen pasi xhihadistët islamikë janë zotuar të hakmerren për vrasjen e 3 prej pjesëtarëve të tyre gjatë së dielës, në zjarrin e artilerisë së rëndë të hapur nga Izraeli.

Kryeministri Benjamin Netanyahu mblodhi shefat e tij të sigurisë dhe ministrin e Shërbimeve Sekrete, Israel Katz, e tha se vendi ishte "në pikën më të afërt të pragut të luftës", që prej konfliktit 7-javor me militantët palestinezë, 4 vite më parë.

"Nëse zjarri nga Gaza nuk nalet, do të na duhet të përshkallëzojmë përgjigjen tonë dhe kjo



mund të çojë drejt një përkeqësimi të ndjeshëm të situatës", tha Katz në "Army Radio".

Daoud Shehab, një zëdhënës i xhihadistëve islamikë, tha se zyrtarë egjiptianë kanë qenë në kontakte me grupin në përpjekje për të rikthyer qetësinë. Ai tha se ky

grup nuk dëshiron që dhuna të përshkallëzohet, por fajësoi Izraelin për ndezjen e gjakrave.

"Nëse Izraeli zotohet për qetësi dhe heq dorë nga çdo lloj forme agresioni ndaj popullit tonë në Gaza, atëherë edhe ne do të ruajmë qetësinë", tha ai.



Ukraina fajëson Rusinë për vrasjen e gazetarit

Gazetari dhe shkrimtari rus, kritik i ashpër i Kremlinit, Arkadi Babchenko u vra dje në mbrëmje në Kiev, ku kishte mërguar pasi ishte ndjerë i kërcënuar. Ai kishte denoncuar rolin e Rusisë në konfliktin në lindje të Ukrainës.

Kryeministri i Ukrainës Volodymyr Groysman, ka akuzuar Rusinë duke thënë se qëndron prapa vrasjes së gazetarit rus në Kiev, Arkady Babchenko.

"Jam i bindur se makina totalitare e Rusisë nuk e ka falur atë se ka qenë i sinqertë dhe ka pasur principe", ka shkruar ai. Kritiku i Kremlinit u qëllua në apartamentin e tij gjatë ditës së djeshme. Rusia ka kërkuar hetim për rastin, mirëpo ka shkruar se "krimet e përgjakshme" janë bërë pjesë e përditshmërisë për "regjimin në Kiev". Marrëdhëniet në mes të Rusisë dhe Ukrainës mbeten te tensionuara duke ndjekur atmosferën e pas aneksimit të Krimesë nga Rusia, në vitin 2014.

GAZSJELLËSI TRANS ADRIATIK MBI 72 PËR QIND I PËRFUNDUAR

TAP është një gazsjellës ndërkufitar 878 kilometra i gjatë, i cili është në ndërtim e sipër, që shtrihet nga kufiri greko-turk për të kaluar në Greqi, Shqipëri dhe Detin Adriatik për në Itali.

Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) është përfunduar më shumë se 72,5 për qind deri në fund të prillit të këtij viti, duke përfshirë gjithë inxhinierinë, prokurimin dhe ndërtimin, tha Lisa Givert, shefja e komunikimit në projektin TAP.

Givert tha për Anadolu Agency (AA) se projekti TAP po vazhdon sipas planit.

TAP është një gazsjellës ndërkufitar 878 kilometra i gjatë, i cili është në ndërtim e sipër, që shtrihet nga kufiri greko-turk për të kaluar në Greqi, Shqipëri dhe Detin Adriatik për në Itali. Në pikën e hyrjes, TAP do të lidhet me Gazsjellësit Trans Anatolian (TANAP) në Turqi.

Givert njoftoi se në Greqi deri në mes të muajit maj, 539 kilome-



tra të rrugës së tubacionit është pastruar, rreth 525 kilometra të gypave janë lidhur, mbi 514 kilometra janë salduar, 434 kilometra të rrugës është rimbushur dhe rreth 331 kilometra janë duke u rikthyer në gjendjen e mëparshme.

"Në Shqipëri, rreth 193 kilometra janë pastruar dhe niveluar përgjatë rrugës, 186 kilometra të tubacionit është lidhur, 180 kilometra janë salduar dhe rreth 162 kilometra janë rimbushur. Rreth 120 kilometra janë duke u rikthyer në gjendjen e mëparshme", tha Givert.

"Kjo do të thotë se në mes të

Greqisë dhe Shqipërisë, TAP ka pastruar dhe niveluar 95 për qind të korridorit të saj, rreth 733 nga 765 kilometra. Përveç kësaj, kemi salduar 90 për qind të gypave të çelikut dhe rreth 78 për qind të tubave tashmë janë nën tokë", shtoi ajo.

Givert vuri në dukje se progresi në Itali aktualisht përfshin aktivitetet e lejes së dytë në përputhje me lejen fillestare të Ministrisë së Ekonomisë të dhënë më 20 maj 2015.

"Kontraktori i TAP-it, Saipem, aktualisht po punon në zonën e mikro-tunelit. Pas përfundimit të shumicës së punëve përgatitore,

ata tani janë gati të përfundojnë gërmimin e gropës, në mënyrë që të mundësohet ndërtimi i mikro-tunelit", tha ajo.

Kompania e projektit TAP AG është konstruktori, pronari dhe operatori i projektit. Partnerët e projektit përfshijnë BP (U.K.), Snam SpA (Itali), Kompania e Korridorit Jugor të Gazit (Azerbajxhan), ku secila zotëron 20 për qind të aksioneve. Fluxys SA (Belgjikë) ka një pjesëmarrje prej 19 për qind, Enagas (Spanjë) ka 16 për qind interes dhe Axpo Trading (Zvicër) ka një pjesëmarrje prej 5 për qind./AA

Italia pa qeveri, përgatiten zgjedhjet e parakohëshme

Kryeministri i sapozgjedhur i Italisë Carlo Cottarelli do të takohet me presidentin e vendit, mes raportimeve se zgjedhjet e parakohshme mund të thirren për të zhbllokuar ngërçin politik.

Mediat raportojnë se Cottarelli, një ish-ekonomist i FMN-së, nuk

ka arritur të sigurojë mbështetje nga partitë e mëdha politike dhe nuk mund të votohet as të betohet.

Presidenti Sergio Mattarella mund të zgjedhë të anashkalojë emërimin e një qeverie të parakohshme dhe të thërrasë zgjedhjet në korrik. Të dielën, dy partitë populiste

të Italisë dështuan të formonin një kabinet qeveritar. Perspektiva e zgjedhjeve të reja dhe mundësia e partive euroskeptike për forcimin e pozitës së tyre kanë goditur tregjet financiare dhe kanë ngritur shqetësime rreth stabilitetit të Eurozonës.





Nga Qerim LITA

AUTONOMIA POLITIK-TERRITORIALE E SHQIPTARËVE NË MAQEDONI (3)

AKTIVITETET PËR JETËSIMIN E AUTONOMISË SHQIPTARE

"Shqiptarët në Maqedoni nuk janë kundër pavarësisë së Maqedonisë dhe njohjes së sajë nga ana e Bashkësisë Evropiane dhe e shteteve anëtare të saj, me kusht që edhe atyre tu njihet Autonomia Politiko-territoriale si hap kah zgjidhja e drejtë dhe e barabartë e çështjes shqiptare, në pajtimin me Aktin Final të Helsinkut 1975 dhe Kartës së Parisit për një Evropë të re (1990), dokumente këto që e njohin të drejtën e vetëvendosjes për secilin popull..."

Dy ditë pas përfundimit të referendumit (14 janar), Komisioni qendror për organizimin e Referendumit, në selinë e Kuvendit të APTSHM-së (Gostivar) organizoi një pres konferencë, me ç'rast u theksua se përkundër përpjekjeve të organeve policore për ta penguar mbajtjen e tij, i njëjti përfundoi me një sukses të jashtëzakonshëm. Nga gjithsej 383.894 votues shqiptarë të regjistruar në 17 komunat prkatëse, në votim kishin dalë 361.627, prej tyre 361,263 kanë votuar "PRO" Autonomisë Politike -Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni, 57 "KUNDËR" dhe 307 fletëvotime të pavlefshme.

Gjithnjë sipas të dhënave të Komisionit, krahas 17 komunave të përmendura, referendumi ishte organizuar edhe për qytetarët shqiptarë me punë të përkohshme në Kosovë, Slloveni, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë si dhe 15 shtetet e Evropës Perëndimore, ShBA, Kanada dhe Australi. Referendumi u përcoll edhe nga disa gazetar të agjencive ndërkombëtare si: "Zëri i Amerikës", "Frans Pressi", "Elefrotipia", agjencitë telegrafike të Austrisë, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe të ShBA-ve. Referendumin e madhështoi prezenca e një delegacioni të lartë të ShBA-ve, në krye me ish kongresistin dhe lobistin e njohur shqiptar, Jozef Diogardi, i shoqëruar nga kryetari i Kongresit të Fondacionit të Lirë, Pol Weriç, gazetari Xhon Fonda, Osman Osmani dhe Mark Lleshi. Ky delegacion drejtpërdrejt i njoftua me pozitën e pavolitshme të shqiptarëve në Maqedoni, ku siç thuhet në Informatën e Komisionit Qendror për Informim "vetë ata qenë dëshmitarë në Strugë dhe Kërçovë se si policia i konfiskonte kutitë e votimeve dhe materialet votuese si dhe keqtrajtimin e anëtarëve të Komisionit votues". Nga po kjo polici, thuhej në vazhdim të informatës "edhe atë vetë disa herë u keqtrajtuau duke ua kontrolluar valixhet e tyre gjatë udhëtimit prej Gostivari për në Kumanovë".

Është me rëndësi të theksohet se me rastin e mbajtjes së Referendumit, Kuvendit të APTShM-së, i aritën shumë telegrame dhe letra përsëritëse nga disa personalitete të rëndësishme ndërkombëtare, që me këtë rast po e veçojmë letrën e ministrit për Punë të Jashtme të Belgjikës, atë të ministrit për Punë të Jashtme të Irlandës, Lordit Karington, shoqatës Shqiptaro-Amerikane, Jozef Diogardi etj.

Suksesi aq i madh që u arrit në Referendum, nxiti udhëheqjen e Kuvendit të APTShM-së të ndërmerri hapa konkret drejt jetësimin të tij. Menjëherë pas përfundimit të Referendumit, Kryesia e Kuvendit,

mbajti mbledhje në të cilën u vendos të grumbullohen 150.000 nënshkrime, që ishte parakusht për ngritjen e iniciativës për ndryshimin e Kushtetutës. Për këtë qëllim, dy komisione: Komisioni për hartimin e tekstit për ndryshimin e Kushtetutës si dhe Komisioni për përcaktimin e shtrirjes së Autonomisë, iu rekomandua që sa më parë që është e mundur, t'i kryejnë detyrat dhe obligimet e tyre. Në kuadër të Komisionit të parë u përfshinë edhe një numër i konsiderueshëm i ekspertëve shqiptarë, profesor të njohur të Universitetit të Prishtinës, siç ishin: Esat Stavileci, Gazmend Pula, Zejnula Gruda, Iliaz Kurteshi etj., me ndihmën e të cilëve së shpejti u përgatit teksti, përkatësisht "Propozimi për ngritjen e iniciativës për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë", i cili përbëhej prej tetë (8) pikave:

"1. Me preambulën e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë të shprehet e vërteta historike se popuj konstituiv të Republikës së Maqedonisë janë populli maqedonas dhe shqiptar, të cilët gjatë historisë kanë luftuar bashkërisht për liri nacionale dhe shtet të përbashkët.

2. Republika e Maqedonisë të ndërtohet si shtet modern, social, demokratik i qytetarëve dhe popujve të barabartë dhe sovran me ndërtimin e përmbytjeve të atilla të Kushtetutës që do të sigurojnë dhe garantojnë:

a) Përdorim të barabartë zyrtar të gjuhëve të kombeve dhe nacionaliteteve në të gjitha nivelet;

b) Përfshirje proporcionale në organet shtetërore dhe pushtetin lokal;

c) Status të barabartë në lëminë e arsimit, shkencës, kulturës dhe veçorive nacionale nëpërmjet të garantimit të të drejtave për shkollim në gjuhën amtare në të gjitha nivelet, formimin e institucioneve nacionale për kultivimin e kulturës nacionale, historisë dhe traditave si dhe përdorimit të lirë të simboleve kombëtare.

3) Rendi juridik efikas, si garancë për siguri juridike të qytetarëve dhe kolektiviteteve nacional me ndarje strikte të pushtetit ligdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

4. Organizimi dhe funksionimi i pushtetit të mbështetet në njësitë lokale dhe rezultatet e zgjedhjeve

të lira dhe demokratike.

5. Krijimi i mekanizmit kushtetuese për mbrojtjen e garancave kushtetuese. Në këtë kuptim Kuvendi i R. së Maqedonisë të jetë dydomësh: Dhoma e qytetarëve dhe Dhoma e kombeve dhe kolektiviteteve nacionale në të cilat konsensusi do të jetë kriteriumi themelor i vendosjes.

6. Status i barabartë në lëminë e informimit nëpërmjet të së drejtës së kombeve dhe kolektiviteteve nacionale për informim në gjuhën e tyre amtare.

7. Konstituimi i sistemit ekonomik stabil juridiko-kushtetues, i mbështetur në ekonominë e tregut dhe pronës juridiko-shtetërore me instrumente të ndërhuara për siguri individuale dhe kolektive, ekonomike dhe sociale të qytetarëve dhe kolektiviteteve nacionale.

8. Të pranohet dhe garantohet në mënyrë juridiko-kushtetuese e drejta me aktet ndërkombëtare të miratuara, organizimi i autonomive politike të kombeve dhe nacionaliteteve që jetojnë në R. e Maqedonisë me ndërtimin e kaptinës së veçantë në Kushtetutën e Maqedonisë".

Në fund, teksti i përkrahuesve shkaqet themelore, rreth kërkesës për ndryshimin dhe plotësimin të Kushtetutës, disa prej të cilave po i paraqesim në vazhdim: "degradimi i popullit shqiptar në pakicë nacionale; mohimi i subjektivitetit të tij konstituiv të shtetit dhe e drejta e tij për vetëpërcaktim; pabarazia e tij me kombin maqedon në të gjitha fushat; mohimi i autoktonisë së tij; mosrespektimi i vullnetit politik të shqiptarëve të shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe demokratike; mospërfshirja e tij proporcionale në organet e pushtetit shtetëror... etj."

Ndërkohë, edhe Komisioni për përcaktimin e shtrirjes së Autonomisë, hartoi projektin me titull "Vazhdimësia e elementit shqiptar në Maqedoninë e sotme". Fillimisht projekti përcaktonte kufijtë, përkatësisht shtrirjen e shqiptarëve, ku thuhej shprehimisht: "Populli shqiptar shtrihet edhe në një hapësirë të gjerë të Maqedonisë së sotme, e cila fillon nga Kumanova me rrethinë, duke kaluar nëpër Shkup, pjesërisht nëpër Veles, Prilep, Krushevë dhe disa vende të tjera të Maqedonisë Lindore, ndërsa në Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Dibër, Prespë, Ohër vazhdon që të banojë

duke mbaruar me Manastirin". Sipas hartuesit të Projektit, shtrirje e popullit shqiptar nga Lindja shkon mes lumenjve Treska dhe Vardar, në drejtim të Veriut nga Morava Jugore dhe drejtohet nga Veriu në Jeni Pazar, përkatësisht, Pazarin e Ri dhe del në Tivar. "Popullata shqiptare - theksohej në Projekt - gjithmonë ka qenë shumicë në këto hapësira në krahasim me grupet e tjera etnike të Maqedonisë së sotme, e në veçanti, në raport me popullin maqedonas". Një rëndësi të veçantë i kushtohet edhe autoktonisë së shqiptarëve, e cila siç vihej në dukje, datonte që nga parahistoria dhe antika kur shqiptarët njiheshin si "Pellezgjë e Ilirë", ndërsa një kohë gjatë Mesjetës së hershme e më vonë, nën emrin "Arbëresh" dhe së fundi si "Shqiptarë". Rrëzimi i sistemit monist, sipas hartuesve të Projektit "ngjalli shpresë të madhe të popullit shqiptar në Maqedoni", se më në fund "do t'i siguroj të gjitha të drejtat kombëtare", ngjashëm sikurse edhe maqedonasi, mirëpo edhe kësaj radhe mbeti i degraduar, madje "nuk iu pranua as statusi i cili i qe garantuar në Mbledhjen e KAÇKM-së, të vitit 1944, as me atë të Kushtetutës së vitit 1974, që të jetë element shtetëformues". I gjetur në këtë pozitë, theksohej në fund të dokumentit: "Populli shqiptar, u përcaktua nëpërmjet Referendumit të mbajtur më datë 11 dhe 12 janar të vitit 1992, me ç'rast 99% të votuesve u deklaruan për Autonomi Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni".

Një dokument tjetër me rëndësi paraqet letra e kryetarit të Kuvendit të APTShM-së, Gjyliaz Fejzulahut, dërguar më 14 shkurt të vitit 1992 deri te Komisioni i Arbitrazhit, të cilën në vazhdim po e japim në formë të shkurtuar:

"...Me interes të veçantë lexuam pjesën e Raportit për njohjen e Republikës së Maqedonisë nga ana e Bashkësisë Evropiane dhe shteteve anëtare të sajë.

Me keqardhje konstatojmë se në raportin e Komisionit të arbitrazhit nuk janë marrë në konsiderim faktet e pakontestueshme natyrore, historike dhe aktuale të jetës dhe të veprimit të afro 40% të popullatës së tërësishme në këtë Republikë e cila i përket kombit shqiptar, e që me datë 11 dhe 12 janar 1992

nëpërmjet Referendumit u deklarua për Autonomi Politiko-territoriale në trojet e veta etnike.

Në raportin e Komisionit të Arbitrazhit të Bashkësisë Evropiane për Jugosllavinë u nënçmuan dhe u injoruan këto fakte të pamohueshme:

- se shqiptarët në Maqedoni jetojnë në trojet e veta etnike si popull autokton;

- se shqiptarët në Maqedoni i karakterizon kompaktësia e tyre etnike dhe territoriale;

- se shqiptarët në Maqedoni paraqesin një etnikum të veçantë nacional gjuhësor dhe kulturor;

- se shqiptarët në trojet e veta etnike janë popull shumicë në regjionin përkatës;

- se statusi sovran dhe shtetformues i popullatës shqiptare i garantuar me nenin 1 të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë nga viti 1974, me Kushtetutën aktuale është degraduar në nivelin e pakicës nacionale dhe kështu populli shqiptar barazohet me pakicat etnike, simbolikisht të përfaqësuara në strukturën nacionale të Maqedonisë - turqit, romët, vlllehët etj.

- se mbi të drejtat njerëzore kolektive nacionale të shqiptarëve dhe nacionaliteteve tjera, nuk ekziston mekanizëm mbrojtës - konsensus;

- se të drejtat dhe liritë njerëzore individuale dhe kolektive të Maqedonisë sipas Kushtetutës në fuqi, janë të palimitueshme, kurse ato të tjerëve në mënyrë taksative limitohen ose përcaktohen me ligje të veçanta.

Të gjitha këto fakte u nënçmuan dhe u injoruan me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë të aprovuar më 17 nëntor të vitit 1991.

Me këtë rast shprehim bindjen tonë se shqiptarët në Maqedoni nuk janë kundër pavarësisë së Maqedonisë dhe njohjes së sajë nga ana e Bashkësisë Evropiane dhe e shteteve anëtare të saj, me kusht që edhe atyre tu njihet Autonomia Politiko-territoriale si hap kah zgjidhja e drejtë dhe e barabartë e çështjes shqiptare, në pajtimin me Aktin Final të Helsinkit 1975 dhe Kartës së Parisit për një Evropë të re (1990), dokumente këto që e njohin të drejtën e vetëvendosjes për secilin popull..."

(vijon në numrin e ardhshëm)

JA PSE SARKOZY E VRAU GADAFIN!

Synimet franceze ndaj naftës libiane. Nganjëherë gjërat janë shumë më të thjeshta nga sa mendohen

Misioni i NATO-s në Libi sigurisht që nuk është ndonjë gjë e re, pasi është dëshiruar nga qeveria franceze e Presidentit të atëherëshëm Nicolas Sarkozy, që pak ditë pas shpërthimit të revoltave kërkoi një mbledhje urgjente të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të marrë masat e nevojshme ndaj represionit të ushtruar kundër rebelimeve nga ana e regjimit të Muammar Gheddafi. Për shumë, një ngut që zbulonte motivacione të diktuar nga kalkulime të thjeshta të brendshme me shumë sesa vullnet real për t'i dhënë fund veprimit gjakatar të filluar nga Raisi libian. Zgjedhjet e afërta dhe popullariteti në rënie drastike i Presidentit, nevoja për ta zgjeruar fetën petrolifere të Përtejalepeve dhe vullneti për t'i dhënë fund traktatit të "bezdisshëm" të miqësisë dhe bashkëpunimit italo-libian të 2008 janë vetëm disa prej objektivave që e kanë shtyrë Francën të veprojë në Libi. Vlen të bëhet një hap prapa. Tensionet midis Kolonelit dhe Parisit janë të vjetra, mjafton të kujtos kontrastet në luftën e gjatë me Çadin, që ka vazhduar gjatë gjithë viteve '80 dhe e kulmuar në atentatin e vitit 1989 kundër avionit DC 10 të kompanisë franceze UTA, i shpërthyer në qiejt e Nigerit duke vrarë 170 persona.

Ardhja e Sarkozy në Elize dukej sikur i paraprinte një faze të re hapjesh me vendet e bregut jugor të Mesdheut, përfshi këtu edhe Libinë. Emblematik roli i luajtur nga Presidenti francez dhe nga bashkëshortja e atëherëshme e tij Cecilia për lirimin e 5 infermiereve bullgare, fillimisht të dënura me vdekje e më pas me burgim të përjetshëm me akuzën se kishin infektuar 400 fëmijë me virusin HIV në spitalin El-Fathi të Bengasi. Pas 8 vitesh burg, infermieret u lëshuan në korrikun e 2007 edhe falë ndërmjetësimit të çiftit të Elizeut që kishte shkuar shumë herë në Libi për të folur me Gheddafi dhe me të bijën e dashur të tij Aisha. Loja u fitua nga Franca kundër Romano Prodi, që ishte shpenzuar që të arrinte një zgjidhje diplomatike për "incidentin". Disa muaj më vonë, midis njëmijë polemikave, Gheddafi e kishte ngritur tendën e tij berbere përpara Elizeut, duke firmosur kontrata për mbi 10 miliard dollarë që do t'i mundësonin Francës t'i shiste një flotë të tërë ajrore luftarake, e prodhuar nga



kolosi i aeronautikës franceze Dassault dhe një megainvestim për të ndërtuar centrale bërthamore në Tripoli dhe rrethinat e tij. Në valën e raporteve të riqepura midis Francës dhe Gheddafi, banka Paribas kishte blerë në fundin e 2010 19% të libianes "Sahara Bank", me një rritje të kapitalit të filiales franceze "BNP Paribas" në Libi baraz me 146% të fondeve të mëparshme në dispozicion dhe me garancinë e operacioneve. Nga ana tjetër, ka pak për t'u habitur. Franca i shet armë Gheddafi qysh nga vitet '70, siç bëjnë edhe shumë vende të tjera, midis të cilave edhe Italia.

Në janarin e 1970 Parisi nënshkroi një kontratë me qeverinë e Tripolit për dhënie të një avioni jet mirage. Që fillimi i një raporti të frytshëm që, midis ulje ngritjeve të shumta, ka vazhduar për shumë vite. Megjithatë, fërkimet nuk u zhdukën. Libia nuk hiqte dorë nga ndërhyrja në grindjet afrikane, shpesh në prizmin antifrancez, nga konflikti në Sierra Leone deri në ndërhyrjet paqëtuuese në Darfour, Kenya, Niger dhe Mali. Pavarësisht përpjekjeve diplomatike, Raisi kishte refuzuar që të futej në projektin e madh francez të Bashkimit për Mesdheun, i konsideruar një formë e re kolonializmi. Jo vetëm kaq, për lideri libian nuk i kishte përmbushur kurrë detyrimet e marrëveshjes së 2007, duke preferuar të respektonte Traktatin Italo-Libian, falë të cilit fuste në xhep çeqe vjetore prej 250 milion dollarësh për t'i shpenzuar në vepra infrastrukturore, të gjitha në përfitim të kompanive italiane.

Megjithatë Sarkozy i kishte provuar të gjitha, duke përfshirë deri edhe Emiratet e Bashkuara Arabe, të gatshme që të stërvisin pilotët libianë për avionët francezë "Rafale" dhe për të bashkëfi-

nancuar operacionin duke rinovuar flotën e vet me tashmë të përmendurën Dassault.

Pastaj do të ndodhte edhe çështja e monedhës panafrikane. Në një prej emailave të dërguar Hillary Clinton dhe të botuara nga DASH-i me 31 dhjetor 2015, midis gjërave të tjera, funksionari Sidney Blumenthal zbuloi se Gheddafi donte të zëvendësonte frangën Cfa, e përdorur në 14 ish koloni, me një tjetër monedhë panafrikane, një iniciativë që rrezikonte të krijonte pavarësinë ekonomike e Afrikës Veriore me valutën e re. Një tjetër motiv i mundshëm i ndërhyrjes franceze del disa vjet pas vdekjes së Raisit. Me 6 mars të vitit 2015 ish Ministri i Brendshëm Claude Gueant, një prej bashkëpunësorëve më të ngushtë të Nicolas Sarkozy, është vënë në gjendje ndalimi në kuadër të hetimeve lidhur me financimet e supozuara të Gheddafi për fushatën presidenciale që çoi "Sarko" në Elize në 2007. Ndoshta edhe për këtë, i ndërhyrës si i goditur prapa krahëve, në një intervistë të dhënë Fausto Biloslavo për "Il Giornale", Koloneli deklaroi: "Mendoj se Sarkozy ka një problem çrregullimi mendor. Ka thënë gjëra që mund të dalin vetëm nga një i çmendur". Së fundi, ai që i ka dhënë stimul të mëtejshëm ndërhyrjes franceze në Libi ka mundësi të ketë qenë edhe vullneti i Francës për të rifuoruar influencën e saj politike në rajon, duke promovuar imazhin e një vendi jo më në pazar me autokratët e vjetër, por e gatshme që të investonte pas kërkesave për liri e demokraci të popullsisë "të bregut jugor".

Nga ana tjetër, Parisi kishte humbur brenda pak kohës Egjiptin dhe Tunizinë, shtyllat e strategjisë së tij diplomatike. Kishte

rast më të mirë se Libia për të rikuperuar kredit në atë Mesdhe në erupcion? Ndoshta është mirë të mos lëshohesh shumë në koniuktura të tjera, por, gjithësesi, shembujt mund të vazhdojnë. Por kaq mjafton për të kuptuar motivet franceze. Provë është se qysh me 13 prill të 2011 (domethënë përpara vdekjes së Gheddafi) Sarkozy kishte pritur me fshehtësi të madhe Fatah Younis, gjeneralin e CNT-së – i vrarë në Bengasi në rrethana akoma pak të qarta në korrikun e 2011 – ka mundësi që të diskutonte garanci për tenderat e ardhshëm energjistikë. Me llogaritë në dorë, rezultojnë gjithçka më e thjeshtë: përpara fillimit të luftimeve, prodhimi i naftës i Libisë shkante në pothuajse 1.6 milion fuçi naftë në ditë, rreth 2% e prodhimit botëror. Nga këta, rreth 52% ishte në dorën e 35 kompanive të huaja, të kryesuar nga italia ENI, që në 2010 me 267000 fuçitë e naftës në ditë kishte qenë e para ndaj gjermanes Wintershall dhe francezes Total, respektivisht me nga 79000 dhe 55000 fuçi në ditë. Kështu pra nuk habit aspak fakti që Nicolas Sarkozy, pasi ka mbështetur fuqimisht CNT-në në luftën "clirimtare" libiane, është paraqitur menjëherë për të kërkuar hesapin nën syrin vigjilent e Christophe de Margerie, CEO-ja i grupit Total. Atëherë e përditshmja franceze "Libération" foli deri për një marrëveshje të nënshkruar nga Mahmoud Shammam, zëdhënësi i CNT-së, i gatshëm që t'i jepte Francës 35% të kontratave të reja petrolifere libiane. Lajm më pas i hedhur poshtë nga palët, por që të paktën insinuoij një dyshim.

Kusuri është histori e vonshme. Pas vitesh pritjeje të fajshme edhe Franca e Presidentit Hollande vendos që të aderojë në planin

e Kombeve të Bashkuara për qeverinë e marrëveshjes kombëtare të drejtuar nga Fayed al-Sarraj. Por edhe në këtë rast është e vështirë që të gjendet në ndërhyrjen e Elizeut ndonjë koherencë, veç në mos dëshirohet të interpretohet në një optikë të thjeshtë interesi kombëtar. Me ekuilibrimin e lindur klasik, në selinë e Kombeve të Bashkuara Franca ishte shprehur e gatshme që të mbështeste GNA-në, por ndërkohë ka vazhduar të mbështesë Khalifa Haftar dhe sponsorët e tij rajonalë.

Është e përditshmja "Le Monde" ajo që ka zbuluar "sekretin" në shkurtin e vitit 2015, duke zbuluar ekzistencën e forcave speciale franceze me qëndrim në bazën e Benina, në afërsitë e Bengasi, në mbështetje të gjeneralit të Cirenaica në aksionet kundër IS-it dhe milicive të tjera islamiste besnike të Tripolit. Nga ana tjetër, avancimi i shpejtë i ushtrisë së Haftar drejt Bengasi nuk do të kishte ndodhur po të mos ishin ndihmat e konsiderueshme të francezëve (dhe të anglezëve), por edhe të Egjiptit të al-Sisi dhe të paktën të sauditëve dhe emiratave, që përveç furnizimit me armë kanë hyrë garant lidhur me pagesat egjiptiane. Ravijëzohej kështu gjithnjë e më qartë roli francez në aksion lindor të konfliktit libian: armët e Përtejalepeve, shtylla egjiptiane, milicitë e Haftar dhe garancitë e Gjirit. Mund të themi "chapeau" nëse këto afera të lulëzuara të mos kishin lindur mbi gërmadhat e marrëveshjeve unitare të Kombeve të Bashkuara të cilat Franca i kishte miratuar.

Tani mbetet për t'u sqaruar motivi i gjithë këtij nxitimi. Edhe një herë akoma mjafton të ndiqet rruga e naftës. Objektiv i francezëve ishte ai i aksesit në rezervat e naftës të Cirenaica, duke rifilluar aktivitetet nxjerrëse, duke zgjeruar rrezet e atyre eksploruese të nisura në 2011 pas rënies së Raisit, ndoshta duke shikuar edhe një çikë më tej drejt pellgut të Sirte që është i mbushur me resurse. Është këtu që, në heshtjen e shkretëtirës dhe larg syve kureshtarë, kompani franceze, pse jo edhe amerikane, angleze, gjermane e spanjolle po investojnë shuma të konsiderueshme në aktivitete eksploruese në zonën e Brega, në Gjirin e Sirte, ku do të jenë të pranishme shumë kompani angleze; në Zillah, që shikon një aktivitet të fortë francez, ashtu si edhe në Beida e Kufra të Cirenaica, sa për të dhënë disa shembuj. Nganjëherë gjërat janë shumë më të thjeshta nga sa mendohen.

(Pjesë nga libri "Incognita Libia. Cronache di un Paese sospeso", botuar nga FrancoAngeli, shkruar nga analistja Michela Mercuri)

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159 dhe 164-b i Ligjit për mbrojtje shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/12,145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16) , Pëlqimin për punësim nga Ministria e financave nr. 18-5658/2, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 02-225/1 të datës 29.05.2018 nga U.D Drejtori medicinal Këshilltar shkencor d-r spec. Niko Beqarkovski i IPSH Klinika universitare për toksikologji – Shkup publikon

SHPLLJE PUBLIKE

Për punësim të punëtorëve shëndetësor me arsim sipëror

1. IPSH Klinika universitare për toksikologji – Shkup ka nevojë për punësim të:
1.1 **dy (2) personave në vendin e punës – doktor të medicinës specialistë të mjekësisë interne.**

1.2 **dy (2) personave në vendin e punës – doktor të medicinës specializant të mjekësisë interne**

2. Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore

- Të jetë shtetas i RM,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
- Të mos i jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

3. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

Për kandidatët nën pikën 1.1

-arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të mbaruar të VIII/1 – Fakulteti i mjekësisë

- provim të dhënë profesional
- provim të dhënë të specializimit
- licencë për punë
- me përvojë pune
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më së shpeshti të përdorura në Bashkimin evropian (angleze, gjermane dhe frënge) të nivelit B2 sipas Kornizës referente të përbashkët për mësim, ligjërime dhe vlerësim të gjuhëve (Common European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment) (në tekstin e mëtejshëm: CEFR dhe të posedojë certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit B2 të CEFR, gjegjësisht IELTS me 5-6 pikë FCE, BEC, ILEC, IKFE, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 500 pikë, TOEFL CBT së paku 175 pikë ose TOEFL IBT së paku 60 pikë ose DELF, TCF, TEF, ose Goethe-Zertifikat, TestDaF.

- Njohja e gjuhës së huaj, përveç certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave të përdorura ndërkombëtarisht, dëshmohej edhe me vërtetim për cikël të parë, të dytë ose të tretë të studimeve në një prej 200 fakulteteve më lartë të ranguar në Shanghai Ranking - ARWU (Academic Ranking of World Universities) të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane), për të cilat studime kandidatët posedon diplomë të nostrifikuar.

Për kandidatët nën pikën 1.2

- arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të mbaruar të VIII/1 – Fakulteti i mjekësisë

- provim të dhënë profesional
- licencë për punë
- me ose pa përvojë pune
- sukses të arritur mesatar nga të gjitha lëndët e të gjitha cikleve të studimeve universitare që ka mbaruar kandidati prej së paku tetë (në tekstin e mëtejshëm: suksesi mesatar) dhe
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më së shpeshti të përdorura në Bashkimin evropian (angleze, gjermane dhe frënge) të nivelit B2 sipas Kornizës referente të përbashkët për mësim, ligjërime dhe vlerësim të gjuhëve (Common European

Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment) (në tekstin e mëtejshëm: CEFR dhe të posedojë certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit B2 të CEFR, gjegjësisht IELTS me 5-6 pikë FCE, BEC, ILEC, IKFE, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 500 pikë, TOEFL CBT së paku 175 pikë ose TOEFL IBT së paku 60 pikë ose DELF, TCF, TEF, ose Goethe-Zertifikat, TestDaF.

-Njohja e gjuhës së huaj, përveç certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave të përdorura ndërkombëtarisht, dëshmohej edhe me vërtetim për cikël të parë, të dytë ose të tretë të studimeve në një prej 200 fakulteteve më lartë të ranguar në Shanghai Ranking - ARWU (Academic Ranking of World Universities) të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane), për të cilat studime kandidatët posedon diplomë të nostrifikuar.

4. Orari i punës prej 40 orë në javë dhe neto pagesë fillestare prej:

- Për kandidatin nga pika 1.1 është 38.654,00 denarë
- Për kandidatin nga pika 1.2 është 29.717,00 denarë.

5. Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen kandidatët obligohen të parashtrijnë dokumentet në vijim

Për kandidatin nga pika 1.1

- fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- biografi të shkurtë (CV)
- njohja e gjuhës së huaj dëshmohej me parashtrimin e një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave të përdorura ndërkombëtarisht: BULATS, CAE, IELTS, FCE, BEK, PET, KET, ILEC, TOEFL PBT, TOEFL CBT, TOEFL IBT për gjuhën angleze, gjegjësisht DELF, DALF, TCF, TEF, BULATS për gjuhën frënge, gjegjësisht Gete Certifikatë (Goethe-Zertifikat), TestDaF dhe BULATS për gjuhën gjermane ose certifikatë të njohur tjetër ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose organizate tjetër ndërkombëtare të nivelit B2 të Kornizës së përbashkët referente për mësim, ligjërime dhe vlerësim të njohjes së gjuhëve (CEFR).

-Kandidatët të cilët kanë mbaruar ciklin e parë, të dytë ose të tretë të studimeve nga sfera e medicinës në një prej 100 fakulteteve më të mirë të ranguar në Shanghai Ranking-ARWU (Academic Ranking of World Universities) nuk kanë nevojë të përmbushin kushtet e posaçme nga pika 3 e kësaj shpallje, as edhe për punësimin e tyre realizohet procedurë për selektim të kandidatit.

- certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, original ose kopje të vërtetuar në noter

- certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, original ose kopje të vërtetuar në noter

- certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, original ose kopje të vërtetuar në noter

- certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, original ose kopje të vërtetuar në noter

- certifikatë për provim të dhënë profesional, original ose kopje të vërtetuar në noter

-certifikatë për provim të dhënë specialistik

- licencë për punë, original ose fotokopje të vërtetuar në noter.

Për kandidatin nga pika 1.2

- fletëparaqitje me të dhënat për kontakt

- biografi të shkurtë (CV)

-Diplomë me sukses mesatar

- njohja e gjuhës së huaj dëshmohej me parashtrimin e një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave të përdorura ndërkombëtarisht: BULATS, CAE, IELTS, FCE, BEK, PET, KET, ILEC, TOEFL PBT, TOEFL CBT, TOEFL IBT për gjuhën angleze, gjegjësisht DELF, DALF, TCF, TEF, BULATS për gjuhën frënge, gjegjësisht Gete Certifikatë (Goethe-Zertifikat), TestDaF dhe BULATS për gjuhën gjermane ose certifikatë të njohur tjetër ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose organizate tjetër ndërkombëtare të nivelit B2 të Kornizës së përbashkët referente për mësim, ligjërime dhe vlerësim të njohjes së gjuhëve (CEFR).

-Kandidatët të cilët kanë mbaruar ciklin e parë, të dytë ose të tretë të studimeve nga sfera e medicinës në një prej 100 fakulteteve më të mirë të ranguar në Shanghai Ranking-ARWU (Academic Ranking of World Universities) nuk kanë nevojë të përmbushin kushtet e posaçme nga pika 3 e kësaj shpallje, as edhe për punësimin e tyre realizohet procedurë për selektim të kandidatit.

- certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, original ose kopje të vërtetuar në noter

- certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, original ose kopje të vërtetuar në noter

- certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, original ose kopje të vërtetuar në noter

- certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, original ose kopje të vërtetuar në noter

- certifikatë për provim të dhënë profesional, original ose kopje të vërtetuar në noter

- licencë për punë, original ose fotokopje të vërtetuar në noter.

-vërtetim se kandidati ka regjistruar specializimin për Medicinë interne

Kandidatët të cilët kanë përfunduar arsim përkatës jashtë vendit duhet të posedojnë:

• Diplomë të nostrifikuar me arsim përkatës

• Dokument për ekuivalencë të notave, të dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Orari i punës organizohet me ndërrime ose kujdestari dhe zgjatë 40 orë në javë, pagesa do të paguhet në pajtim me Marrëveshjen individuale kolektive.

6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.

7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e Komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.

8. Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur do të realizohet provim në pajtim me Ligjin për mbrojtje shëndetësore.

9. Fletëparaqitja së bashku me tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe telefoni për kontakt, të parashtrihen deri në IPSH Klinika universitare për toksikologji – Shkup rr. Vodnjanska nr. 17, përmes postës ose në arkivin e IPSH Klinika universitare për toksikologji – Shkup, ndërsa me shenjë Për shpalljen publike për punësim.

IPSH Klinika universitare për toksikologji – Shkup



rr. 8-ma Udarina Brigada nr. 14, 1000 Shkup
tel. (02) 55 11 690, (02) 55 11 691
office@videolottery.mk

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005; 106/2008; 161/2008; 114/2009; 130/2009; 149/2009; 50/2010; 52/2010; 124/2010; 47/2011; 11/2012; 39/2012; 13/2013; 25/2013; 170/2013; 187/2013; 113/2014; 20/2015; 33/2015; 72/2015; 129/2015 dhe 27/2016), Shoqëria për rregullimin e lojërave të fatit Videolotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë – Casinos Austria SHPK Shkup, publikon

SHPLLJE PUBLIKE Për pranimin e punëtorëve për kohë të pacaktuar

Shoqëria për rregullimin e lojërave të fatit Videolotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë – Casinos Austria SHPK Shkup ka nevojë për punësim të punëtorëve për kohë të pacaktuar për vendet e punës në vijim:

1. BASHKËPUNËTOR I PAVARUR PËR FURNIZIME PUBLIKE - 1 (një) realizues me kualifikimet në vijim:

- Arsim sipëror – Fakulteti juridik – shkallë të VIII/1 të mbaruar ose së paku 240 kredi sipas SETK
- Përvojë pune: 3 (tre) vjet përvojë pune
- Njohje të gjuhës angleze ose gjuhë tjetër të huaj
- Njohje të office aplikacioneve dhe shfrytëzimit të internetit
- 40 orë pune në javë prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orari i punës prej ora 08 e 00 deri në ora 16 e 00
- Provim të dhënë të pozitjes të kategorisë B

2. KËSHILLTAR I DREJTORIT GJENERAL PËR KOORDINIM DHE IMPLEMENTIM TË PROJEKTEVE - 1 (një) realizues me kualifikimet në vijim:

- Arsim sipëror – shkallë të VII të mbaruar nga sfera e shkencave shoqërore
- Përvojë pune: 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion
- Njohje të gjuhës angleze ose gjuhë tjetër të huaj
- Njohje të office aplikacioneve dhe shfrytëzimit të internetit
- 40 orë pune në javë prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orari i punës prej ora 08 e 00 deri në ora 16 e 00
- Provim të dhënë të pozitjes të kategorisë B

3. BASHKËPUNËTOR I PAVARUR PËR ÇËSHTJE FINANCIARE - 1 (një) realizues me kualifikimet në vijim:

- Arsim sipëror – Fakulteti ekonomik – shkallë të VIII/1 të mbaruar ose së paku 240 kredi sipas SETK
- Përvojë pune: së paku 3 (tre) vjet përvojë pune
- Njohje të gjuhës angleze ose gjuhë tjetër të huaj
- Njohje të office aplikacioneve dhe shfrytëzimit të internetit
- 40 orë pune në javë prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orari i punës prej ora 08 e 00 deri në ora 16 e 00
- Provim të dhënë të pozitjes të kategorisë B

Afati për paraqitjen e kandidatëve është 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes.

Me kandidatët e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim në të cilën do të përcaktohet kohëzgjatja e punës provuese, jo më gjatë se gjashtë muaj.

Afati në të cilin punëdhënësi do të bëjë zgjedhjen është 7 (shtatë) ditë pune, pas kalimit të afatit për paraqitje të kandidatëve. Nëse në shpalljen publike paraqiten më shumë se 200 kandidatë për vendin e punës zgjedhja do të realizohet në afatet e caktuara me ligj.

Kandidatët për vendin e lartpërmendur të punës krahas fletëparaqitjes me biografi të shkurtë duhet të parashtrijnë edhe dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura edhe atë:

- diplomë ose certifikatë për përgatitjen e mbaruar profesionale
- vërtetim për përvojën e punës me përgatitjen e kërkuar profesionale
- certifikatë të shtetësisë.

Dëshmitë parashtrihen në original ose kopje të vërtetuar në noter. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i parregulluar dhe i pakompletuar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm kandidatët t'i parashtrijnë përmes postës deri në:

Shoqëria për rregullimin e lojërave të fatit Videolotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë – Casinos Austria SHPK Shkup, rr. "8-ma Udarina Brigada" nr. 14, 1000 Shkup (Ndërtesa afër Ambasadës italiane në Qendër).



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nënpusëve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nënpusëve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të trejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 65/2018

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Ministrinë e Shëndetësisë“ për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B03000 Ndihmës udhëheqës i Sektorit për punë të përgjithshme 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VIA sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike, bibliotekë dhe dokumentim dhe shkencat ekonomike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditë e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30
- Rroga neto: 31.331,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1. Kushtet e lartpërmendura në shpalljen publike duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës. Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faja e internetit e Agjencisë. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – të: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – të. Ai inicohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

EKSPERIMENTET E PANUÇIT DËSHTOJNË SËRISH

KOSOVA LEKSION FUTBOLLI SHQIPËRISË

Vëllazërorja ka shkuar për Kosovën, që i dha një leksion mjaft të ashpër Shqipërisë, duke e mposhtur 3-0, një rezultat ky që tregon edhe njëherë qartësisht dështimin e eksperimenteve të Panuçit, ndërsa kuqezinjtë tregojnë qartësisht se nuk janë gati për të garuar denjësisht në Ligën e Kombeve



Elseid Hysaj

Kemi zhvilluar një nga ndeshjet më të dobëta dhe i lamë mundësi Kosovës të bëjë atë që donte në fushë. Jam dakord që kemi zhgënjyer dhe do të duhet të tregonim tjetër angazhim në fushë.



Arbër Zeneli

Kemi luajtur shumë mirë si ekip dhe unë arrita të shënoj dy gola. Jam i lumtur për paraqitjen. Ishim mobilizuar dhe prisnim të zhvillonim një ndeshje të mirë. Sot u angazhuam dhe arritëm të shënojmë 3 gola, duke marrë një fitore të bukur

Një ditë pas fitores së thellë 3-0 të Kosovës me Shqipërinë atmosfera të "Dardanët" është mjaft pozitive. Këtë e tregon në intervistën për "Sport Neës" portieri Samir Ujkani, që gjithsesi u bën thirrje shokëve të skuadrës të qëndrojnë me këmbë në tokë, sepse betejat e vërteta për përfaqësuesen më të re evropiane nisin në shtator me sfidat e "Nations League". "Atmosfera ka qenë shumë e mirë, ishte ndeshje shumë pozitive dhe kemi mbetur të kënaqur. Kemi qëndruar deri vonë bashkë me familjarët. Duhet të kthehemi me këmbë në tokë dhe të punojmë me trajnerin për ndeshjen që na presin në shtator për Ligën e Kombeve. Besoj se me Shqipërinë ishte ndeshja më e mirë për ne. Mentaliteti ka qenë shumë i

mirë në të gjitha fazat, kemi treguar se kemi talent dhe se mund të luajmë duke e përballuar presingun dhe duke dalë mirë përpara. Shpresoj se do të vazhdojmë kështu". Entuziazmin ndoshta të tepruar të futbollistëve të Kosovës sigurisht që duhet ta frenojë trajneri Shallandes. Dhe, nga fjalët e Ujkanit kuptohet që e ka bërë mirë punën e tij. "Trajneri është shumë i lumtur me paraqitjen tonë, por kërkon të jemi ke këmbë në tokë, sepse prej shtatorit do të nisim Ligën e Kombeve. Miqësorja me Iranin? Të shohim çdo të ndodhë. Me Iranin do të luajmë një ndeshje të madhe, sepse është një skuadër që luan në Botëror. Do të jetë një test shumë i madh", deklaroi Ujkani.

Në anën tjetër, Trajneri i

Kombëtares së Shqipërisë, Kristian Panuçi ka folur për humbjen miqësore me Kosovën. Ai tha se kritikak për këtë ndeshje janë të drejta, ndërsa për këtë fajin nuk e kalon askund, por e mban atë për vete. "Sot të gjitha kritikak e botës janë shumë të drejta. Përgjegjësia është e gjitha e imja. Nuk kemi luftuar nuk kemi bërë asgjë", tha ai. "Mendova që mos e karikoj shumë skuadrën, ta shtyje shumë përpara. Mendova që nuk ishte e domosdoshme kundër Kosovës. Kemi dhënë një shfaqje të shëmtuar. Unë marr përsipër të gjitha përgjegjësitë e mia". Në pyetjen se a duhet dikush ta ndezë zjarrin, e ndez dot zjarrin, Panuçi u përgjigj: "Jam unë ai që duhet ta bëj. Jam marrë shumë letë gjatë javës. Tashmë e në vijim do të

jetë një tjetër melodi. Përgjegjësinë e mbaj vetëm unë. Mici dhe Trashi 2 mbrojtës të majtë që mund t'iu bënin punë. Kjo është gjëja më e rëndë dhe më e shëmtuar që humbet duke mos luftuar. Ardha në ekipin kombëtar nuk është një vend punë. Duhet forcë karakter. Sot ka munguar dëshirë", deklaroi trajneri italian. Ndërkohë, Odise Roshi ishte sërish një nga lojtarët që jo vetëm nuk doli në lojën e tij, por ashtu si ndaj Norvegjisë, u zëvendësua para se të përfundojë pjesa e parë. Fieraku pranoi lojën e dobët, por mohoi të ketë probleme në dhomat e zhveshjes. "Është e vërtetë që humbëm me rezultat mjaft të thellë, duke marrë një leksion të ashpër. Kemi bërë dy ndeshje katastrofike dhe duhet të kthejmë faqe urgjen-

tiisht. Jam shumë i mërzitur për këtë që po ndodh. Besoj se do të arrijmë t'ia dalim. Sa i përket zëvendësimit Po, edhe me Norvegjinë u zëvendësua në të njëjtën minutë, por nuk e kuptova arsyen. Mund të them që nuk e kam pritur aspak mirë këtë", deklaroi Roshi.

Shkupi merr licencën, mund të luaj në Liga Evropë



Shkup, 30 maj - Skuadra e FC Shkupi, e cila sezonin e përfundoi në pozitën e katërt, edhe zyrtarisht do të luajë në garat evropiane, respektivisht "Europa League". Edhe pse pjesëmarrja në këtë kompeticion të garave në fillim u vë në dyshim, kjo tani ka marr fund dhe klubi është pajisur me licencën e nevojshme për pjesëmarrje në "Europa League". Dokumentet e

nevojshme drejtuesit e klubit nga Çairi i kanë dorëzuar në shtëpinë e futbollit (FFM) dhe tani të qetë bashkë me tifozët e tyre, mund të presin kundërshtarin dhe rikthimin në arenën evropiane pas 14 viteve. Kujtojmë, pos FC Shkupit në "Europa League" do të luajnë edhe Rabotnički dhe Vardari, ndërsa në Ligën e kampionëve do të na përfaqësojë KF Shkëndija. (B.K.)

TAJSON FURY VLERËSON BOKSIERIN SEFER SEFERI

Këta shqiptarët janë shumë, shumë të vështirë për t'u mundur

Tajson Fury beson se Sefer Seferi nuk do të jetë kundërshtar i lehtë për t'u përballur. Anglezi (25 fitore, 0 humbje, 18 me nokaut) i kthehet boksit pas dy vite e gjysmë pauzë, e shikon përballjen me shqiptarin (23 fitore, 1 humbje, 21 me nokaut) si shumë serioze. "Këta tipat shqiptarët janë shumë, shumë të vështirë për t'u mundur. Ja pse zgjodha dikë që është shumë i vështirë", u shpreh Fury. "Kam nevojë për runde sepse kohë që nuk kam boksuar, e kam pritë këtë për shumë kohë. Kam nevojë për runde. Nuk kam nevojë për një nokaut pas 10 sekondash. Kam nevojë për dikë të vështirë, dikë që duron grushtet, më sulmon dhe më vendos nën presion. Jam duke e marrë atë shumë seriozisht. Kjo është një përballje botërore për



mua. Të gjithë ata që vijnë të përballen me mua janë sfidë për titullin. Mendoj se është i mirë, mjaftueshëm i mirë. Një njeri që ka 24 ndeshje dhe ka humbur vetëm një me pikë dhe nuk është nokautuar kurrë, nuk është i lehtë. Por, nëse mendoj që jam aq i mirë sa që jam, duhet ta munda atë

qetësisht", ka thënë Fury. Ndryshe, përballja mes Fury dhe Seferit do të zhvillohet me 9 qershor "Manchester Arena", e vlefshme për peshat e rënda. Humbja e vetme në karrierën e shqiptari ka qenë nga Manuel Çarr, për titullin ndërkombëtar "WBA" të peshave të rënda, në shtatorin e vitit 2016.

THIRRJE PËR OFERTA
Ministria e punës dhe politikës sociale
Projekti i kompensimit të kushtëzuar në të holla – UPN projekt
(Kredi nr. 7735-MK)

Furnizim të pajisjeve kompjuterike për Ministrinë e punës dhe politikës sociale dhe për qendrat për punë sociale

Nr. ref. MK/UPN # 2.1.26

1. Këtë ftesë për oferta e përcjellë shpallja për furnizime për këtë projekt të publikuar në edicionin e "UN Development Business", me nr. 766, të 16 janarit të vitit 2010 (edicioni i shtypur) dhe të publikuar në mënyrë elektronike më 17 dhjetor 2009.

2. Republika e Maqedonisë ka fituar kredi nga Banka ndërkombëtare për renovim dhe zhvillim (IBRD) për realizimin e Projektit të kompensimeve të kushtëzuara në të holla dhe ka për qëllim që një pjesë të mjeteve të fituara nga kjo kredi t'i shfrytëzojë për pagesë sipas marrëveshjes për "Furnizim me pajisje kompjuterike të Ministrisë së punës dhe politikës sociale dhe qendrat për punë sociale".

3. Ministria e punës dhe politikës sociale fton ofertuesit e kualifikuar të parashtrorin oferta për furnizim me pajisje kompjuterike për Ministrinë e punës dhe politikës sociale dhe qendrave për punë sociale.

4. Procesi i furnizimit do të realizohet në pajtim me metodën e furnizimit "Tenderi i hapur nacional në pajtim me Udhëzimin e Bankës botërore: "Furnizime me mjete të fituara nga IBRD Hua dhe IDA Kredi, maj 2004, reviduar në tetor të vitit 2006" dhe është i hapur për të gjithë ofertuesit nga shtetet e kualifikuara siç është i definuar në dokumentacionin tenderues.

5. Ofertuesit e interesuar mund të marrin informacione shtesë prej ora 08:30 deri në ora 16:30 në adresën në vijim: Ministria e punës dhe politikës sociale, Dame Gruev 14, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë, tel. +389(0)23296-291, e-mail adresa: sanja.andovska@mtsp.gov.mk.

6. Kualifikimet e kërkuara:

(a) Aftësia financiare

Ofertuesi duhet të parashtrorin certifikatë të dhënë nga Drejtoria për të hyra publike me të cilën konfirmohet se ofertuesi ka paguar të gjitha obligimet e tij tatimore, gjegjësisht vërtetim për tatime të paguara, kontribute dhe pagesa të tjera publike, jo më të vjetër se 30 ditë nga data e publikimit të kësaj Thirrje për oferta. Në rast të investimit të përbashkët (Joint Venture) ky kriter do të konsiderohet si i përbushur nëse të gjithë partnerët përbushin këtë kërkesë..

(b) Përvojat dhe kapacitetet teknike

1. Ofertuesi duhet të parashtrorin dokumente (listë të marrëveshjeve të lidhura me përshkrim, vlerë të marrëveshjeve, emri i klientit dhe personi për kontakt për konfirmim të referencës) me të cilët konfirmohet se në 3 vitet e fundit, gjegjësisht në vitet 2017, 2016 dhe 2015 në mënyrë të suksesshme ka realizuar së paku 1 (një) marrëveshje për dërgim të pajisjes kompjuterike të ngjashme me atë që është lëndë e këtij furnizimi.

Vlera e përgjithshme e marrëveshjes duhet të jetë së paku i njëjtë ose më i madh se vlera e ofertës. E realizuar në mënyrë të suksesshme është ajo marrëveshje tek i cili pajisja e kontraktuar është porositur në tërësi (100%). Lista e parashtruar e marrëveshjeve duhet të jetë e shoqëruar me vërtetime për obligimet e kontraktuara të realizuara. Në rast të investimit të përbashkët (Joint Venture) ky kriter do të konsiderohet i përbushur nëse partneri udhëheqës përbushë këtë kërkesë.

2. Ofertuesi duhet të parashtrorin dëshmi me shkrim se me formën aktuale të veprimit merret në tri vitet e fundit para datës së publikimit të kësaj Thirrje për oferta. Dokumenti i parashtruar nuk duhet të jetë më i vjetër se 3 (tre) muaj nga data e publikimit të kësaj Thirrje për oferta. Në rast të investimit të përbashkët (Joint Venture) ky kriter do të konsiderohet si i përbushur nëse partneri udhëheqës e përbushë këtë kërkesë..

Të gjitha dokumentet duhet të parashtrorin në origjinal ose kopje

7. Ofertuesit e interesuar mund të marrin dokumentacion tenderues me parashtrimin e kërkesës në e-mail adresën në vijim: sanja.andovska@mtsp.gov.mk

8. Të gjitha ofertat duhet të jenë të shoqëruara me **garanci bankare në shumë prej 200.000,00 MKD.**

9. Ofertat duhet të parashtrorin në adresën: Ministria e punës dhe politikës sociale (arkivi në përdhese), rr. Dame Gruev nr. 14, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë, më së voni deri në ora 11:00 më datë **29.06.2018**. Parashtrimi elektronik i ofertave nuk lejohet. Ofertat e vonuara do të refuzohen.

10. Ofertat do të hapen publikisht në prezencë të përfaqësuesve të ofertuesve të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në hapjen publike e cila do të mbahet më datë **29.06.2018 në ora 11.15** në adresën në vijim: Ministria e punës dhe politikës sociale, kati 4, dhoma për konferenca nr. 1, rr. Dame Gruev nr. 14, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë.

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1 dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15-tekst i pastruar), nenit 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18) dhe Pëlqimit nga Ministria e financave nr. 18-5253/2 të datës 29.05.2018, U.D Drejtori i IPKÇF "Aco Karamanov" – Radovish, publikon

SHPALLJE PUBLIKE
PËR PUNËSIM PËR KOHË TË CAKTUAR TË PUNËS

1. Një (1) person në vendin e punës përkëdhelës për kohë të caktuar të punës deri më 31.12.2018.

Shkalla e arsimit: Arsimit mesëm i mbaruar katër vjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës,
 - me ose pa përvojë pune,
 - neto pagesa mujore prej 14.779,00 den
 - orari ditor i punës i shkallëzuar prej ora 08.00-16.00 dhe prej ora 10.00 – 18.00 prej të cilave 7 orë punë me fëmijë.
 Orari javor i punës për vendin e punës është 40 orë, (8 orë në ditë prej ditës së hënë deri ditën premte)

Së bashku me lutjen kandidatët duhet të parashtrorin edhe dokumentet në vijim:

-Dëshmi për arsim të mbaruar dhe licencë valide për përkëdhelës,
 -Certifikatë të shtetësisë,
 -Dokument se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
 -Dokument, se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me çka është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligj është përcaktuar sjellje diskriminuese.

Shpallja zgjatë pesë (5) ditë pune nga data e publikimit.
 Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditë pas kalimit të shpalljes.
 Lutja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të parashtrorin deri në IPKÇF "Aco Karamanov" – Radovish, rr. "Aco Karamanov" nr. 54, Radovish.

Fletëparaqitjet të cilat nuk do të parashtrorin në afatin e caktuar dhe fletëparaqitjet të cilat nuk i përbajnë dokumentet e kërkuara, do të konsiderohen si të dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara dhe nuk do të merren parasysh.

U.D Drejtor,
 L. Trencëva

Në bazë të nenit 172 dhe 176 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/2018), nenit 9 dhe 10 të Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" (Fleta universitare nr. 274/13), ndërsa në pajtim me Vendimin e Këshillit mësimor-shkencor nr. 08-6/141 të datës 28.5.2018, Dekani i Fakultetit arkitektonik - Shkup, publikon

KONKURS

Për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor, të grupit të lëndëve nga sfera mësimore-shkencore: *projektimi arkitektonik dhe dizajni*, nën numrin 20100 sipas Klasifikimit të njësive, sfera, fushave dhe degëve të hulumtimit, të harmonizuara me OECD dhe UNESCO.

Kushtet: Kandidatët duhet të përbushin kushtet e përgjithshme të parapara me nenin 166 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 82/2018), kriteret për zgjedhje në titujt si kushte të posaçme, të parapara në Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fleta universitare nr. 274/13, të publikuar në ueb faqen e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi") dhe kushtet e parapara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Fakultetin arkitektonik - Shkup (të publikuar në ueb faqen e Fakultetit).

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: biografi të shkurtër, deklaratë se i përbushin kushtet e përgjithshme dhe të posaçme, dokumente që dëshmojnë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme dhe certifikatë të shtetësisë. Dokumentet të parashtrorin në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Zgjedhja e mësimdhënësit bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fleta universitare nr. 274/13).

Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit. Mësimdhënësi i zgjedhur lidhë marrëdhënie pune për kohën për të cilën zgjidhet. Konkursi zgjatë 8 ditë nga data e publikimit. Fletëparaqitjet së bashku dokumentacionin e kompletuar parashtrorin përmes arkivit të Fakultetit, ose përmes postës në adresën: bul. Partizanski Odredi nr. 24, Shkup. Informacione shtesë në numrin e telefonit 02 3116 367.

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup
 Fakulteti arkitektonik - Shkup

NJOFTIM PËR PUBLIKIM

Njoftohen të gjithë personat e interesuar fizik dhe subjektet juridike (vendas dhe të huaj), që SH.A. për komunikacion postar "Posta e Maqedonisë" -Shkup, në pronësi shtetërore, shpall njoftimin nr.02/2018 për shitjen e hapësirës afariste në Republikën e Maqedonisë (hera e pare) përmes sistemit elektronik për ankand publik.

Shpallja do të zbatohet në pajtim me Ligjin për shitje dhe qiradhënie të ndërtesave dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 13/13, 69/13, 104/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15, 61/15 dhe 129/15, 6/16, 106/16 dhe 21/18) dhe Vendimit për shitje të hapësirës afariste në pronësi të Shoqatës Aksionare për komunikacion postar "Posta e Maqedonisë" -Shkup, në pronësi shtetërore, të sjellur nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë nr. 44-309/1 prej datës 24 prill 2018 (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 78/18)

Shpallja do të jetë e paraqitur në ueb faqen e sh.a. për komunikacion postar "Posta e Maqedonisë", në pronësi shtetërore : www.posta.mk dhe në ueb faqen e sistemit elektronik për shitje dhe qiradhënie: www.deloven-prostor.mk, prej datës 01.06.2018 (dita e premte) deri me datën 30.06.2018 (dita e shtunë).

Sh.A. për komunikacion postar
 "Posta e Maqedonisë" -Shkup

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 1 e Ligjit për marrëdhënie pune dhe nenit 77-g të Ligjit për kulturë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, ndërsa në pajtim me planin vjetor për punësim për vitin 2018 dhe pëlqimit të planit të dhënë nga Ministria e kulturës, IN Enti për mbrojtje të përmendoreve të kulturës dhe Muze – Prilep, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE nr. 1/2018
Për punësim të 8 kandidatëve për kohë të përcaktuar të punës

- IN Enti për mbrojtje të përmendoreve të kulturës dhe Muze – Prilep publikon shpallje publike për punësim të 8 kandidatëve për kohë të përcaktuar të punës.
 - Historian i artit**, një (1) realizues,
 - Historian**, një (1) realizues,
 - Dokumentues**, një (1) realizues,
 - Konservues-etnolog**, një (1) realizues,
 - Arkeolog**, një (1) realizues,
 - Referent për botim, prezantim dhe mirëmbajtje të pajisjeve kompjuterike**, një (1) realizues,
 - Shitës**, dy (2) realizues.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të përbushin edhe kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Ligjin për kulturë për ofruesit e shërbimeve nga sfera e kulturës të kategorisë G dhe D:

- Për vendin e punës me numër rendor 1: 240 SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar - Historia e artit/Arkeologji;
- Për vendin e punës me numër rendor 2: 240 SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar - Historia e artit; Shkencat historike;
- Për vendin e punës me numër rendor 3: 240 SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar - Historia e artit/Arkeologji, Arsimit;
- Për vendin e punës me numër rendor 4: 240 SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar - Etnologjia dhe etnogeneza, Historia e artit/Arkeologji;
- Për vendin e punës me numër rendor 5: 240 SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar - Historia e artit/Arkeologji;
- Për vendin e punës me numër rendor 6: shkalla VI/1 ose arsim të mesëm të mbaruar – Arsimit/Teknika kompjuterike dhe informatika/Dizajn grafik;

Kushtet e posaçme të përcaktuara me Ligjin për kulturë për personat ndihmës-teknik për nivelin B1 janë:

- Për vendin e punës me numër rendor 7: së paku arsim të mesëm katërvjeçar, gjegjësisht arsim të mesëm trevjeçar – të mesëm – gjimnaz, PMP – ekonomik – juridik dhe tregti;
- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë.

- Së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrorin: diploma për arsim të mbaruar, shtetësisia dhe letërnjoftimi.
- Shpallja zgjatë 5 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor.
- Kandidatët, fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme t'i parashtrorin në arkivin e IN Entit për mbrojtje të përmendoreve të kulturës dhe Muze – Prilep ose përmes postës në adresën: rr. "Aleksandar Makedonski" nr. 142, Prilep, më së voni deri në ora 16,00 në ditën e fundit të shpalljes.
- Materialet e parashtruar në shpallje nuk kthehen.
- Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruar pas afatit nuk do të shqyrtohen.
- Për rezultatet nga shpallja kandidatët do të informohen me shkrim.

IN Enti për mbrojtje të përmendoreve të kulturës dhe Muze – Prilep



REPUBLIKA E MAQEDONISË
 SHKOLLA FILLLORE KOMUNALE
SANDO MASEV – STRUMICË
KOMUNA E STRUMICËS
 nr. 04-282/1
 29.05.2018

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015, 27/16 dhe 35/2018) nenit 20-a dhe 20-r të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 11/18), nenit 24 të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në SHFK Sando Masev – Strumicë nr. 01-103/3 të datës 11.02.2015, Pëlqimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së RM për mjetet e miratuara financiare nr. 12-12701/10 të datës 25.01.2018, Planit të miraturar vjetor për punësim për vitin 2018 dhe Vendimit nr. 09-281/1 të datës 29.05.2018 të sjellë nga ana e drejtorit të shkollës, SHFK Sando Masev – Strumicë publikon:

SHPALLJE nr. 1/2018
Për punësim të kuadrin jomësor për kohë të përcaktuar të punës

- OBN 04 01 A01 002 – mirëmbajtës të higjienës me orar të plotë të punës - 3 realizues dhe**
- OBN 04 01 A01 002 – mirëmbajtës të higjienës me orar të plotë të punës - 1 realizues me:**
 - 40 orë punë në javë, gjegjësisht 20 orë punë në javë koha e punës në kuadër të javës pesëditore të punës edhe atë ndërrimi i parë me fillim prej ora 06 deri në ora 14 dhe ndërrimi i dytë prej ora 12 deri në ora 20, me neto pagesë fillestare prej 12,000 denarë.
 - Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të përbushin edhe kushtet në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës:
 - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, të kenë arsim fillor/të mesëm të mbaruar, me ose pa përvojë pune,
 - vërejtje: Në pajtim me planin vjetor për punësim në SHFK Sando Masev-Strumicë për vitin 2018, punësimet parashihen për: Maqedonas(e) 4.
 - Shpallja do të zgjasë 5 ditë pune, afati fillon të rregullohet nga data e publikimit të shpalljes në shtypin ditor.
 - Kandidatët duhet të parashtrorin:
 - Fletëparaqitje në letër, e cila duhet të përmbajë: të dhënat për kandidatin dhe letër të shkurtë motivuese,biografi të shkurtë, deklaratë për përbushje të kushteve të përgjithshme për vendin e punës duke shënuar Po/Jo për secilin kusht veç e veç, deklaratë për përbushje të kushteve të posaçme për vendin e punës duke shënuar Po/Jo për secilin kusht veç e veç.
 - Dëshmi për arsim të mbaruar,
 - Certifikatë të shtetësisë,
 - Dëshmi për përvojë të punës nëse e ka.
 - Dokumentet duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.
 - Procedura për përzgjedhje do të realizohet nga ana e komisionit i cili do të përpilojë rang listë të kandidatëve, të cilët i përbushin kushtet për punësim në vendet e punës të theksuara në shpallje.
 - Zgjedhja do të realizohet më së voni në afat prej 15 ditëve pas përfundimit të shpalljes.
 - Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme si dhe dëshmitë për përbushje të kushteve, të parashtrorin në formë me shkrim drejtpërdrejtë në arkivin e SHFK Sando Masev – Strumicë gjatë ditëve të punës në periudhë prej ora 8:00 deri në ora 14:00.
 - Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruar pas afatit nuk do të shqyrtohen.

SHFK Sando Masev – Strumicë

Drejtor
 Dragica Spasova

Shpallje

Shitet shtëpia në Gazi Babë me sipërfaqe prej 100m2, posedon 4 dhoma, bodrum dhe oborr, e rinovuar në gjendje shumë të mirë, çmimi 52.000 euro me mundësi për marrëveshje kontakt tel. 078-353-988

MENAXHERI TRONDIT BAJERN MUNIHUN



LEVANDOVSKI DËSHIRON TË LARGOHET

“Robert mendon se ka nevojë për një ndryshim dhe një sfidë të re në karrierën e tij. Menaxherët e Bajernit e dinë këtë”, tha Zahavi për “Sport Bild”

Agjenti i Robert Lewandowski ka zbuluar se polaku e ka njoftuar Bajern Munihun për dëshirën e tij,

që të largohet nga klubi. 29-vjeçari ka kohë që është lidhur me një lëvizje te Real Madridi dhe për këtë ka emëruar Pini Zahavi, si agjentin e tij, në fillim të këtij viti, mes zërave që mund të largohet nga Bundesliga. Zahavi ishte përgjegjës për ndërmjetësimin e transferimit të Neymar, prej 222 milionë euro nga Barcelona te PSZH, verën e kaluar. Bajern Munihu ka mohuar një qasje nga Real Madridi për sulmuesin, por raportet e kanë lidhur polakun, gjithashtu, me një numër klubesh elitë të Evropës, duke përfshirë

Manchester Junajtedin, Çellsin dhe PSZH. Lewandovski u kurorëzua golashënuesi më i mirë i Bundesligës për herë të tretë në pesë sezona, duke shënuar 180 gola në total, në fluturimin më të lartë të Gjermanisë, pasi fitoi titullin e tij të gjashtë në Bundesligë. Zahavi beson se sulmuesi ka arritur gjithçka që mundet me Bajernin, pasi ka mbërritur edhe në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve, për t'u eliminuar nga kampionët e Realit. “Robert mendon se ka nevojë për një ndryshim dhe një sfidë të re në karrierën e tij, – tha

Zahavi për “Sport Bild”. – Menaxherët e Bajernit e dinë këtë”. Pavarësisht spekulimeve të përsëritura, stafi i Bajern Munih kishte pritur që Lewandovski të qëndronte në klub, pas Kupës Botërore, me trajnerin e ri, Niko Kovaç, duke marrë përgjegjësinë e drejtimit për sezonin 2018-2019. Në fillim të majit, shefi ekzekutiv, Karl-Hainz Rummenigge, u bëri thirrje tifozëve të mos shqetësohen me mundësinë e largimit të sulmuesit, pasi ai është nën kontratë në “Allianz Arena” deri më 2021.

Derbi milanez për sulmuesin e Lionit

Një nga katër milionë ndjekësit e Memfis Depaj në “Instagram” i ka sugjeruar: “Eja në Milano”. Nuk është specifikuar nëse te Milani apo te Interi, por faktikisht ekziston një derbi mes dy ekipeve të luajnë në “San Siro”, për të marrë sulmuesi holandez. Depaj ka një kontratë deri në vitin 2021 me Lionin dhe në sezonin e kaluar kanë shënuar 22 gola në 51 ndeshje. Emri i tij është përfshirë në listën e drejtorit sportiv të Inter, Piero Ausilio, krahas Domenico Berardit, Matteo Politanos dhe Simone Verdit. Lion ka pretendime të mëdha financiare, por nëse Depaj kërkon largimin, atëherë klubi francez mund të pajtohet me 30 milionë euro, ndërsa paga e tij është 4.2 milionë euro në sezon. Ish-lojtari i Junajted mund të jetë zëvendësuesi ideal i Perishiq dhe Kandreva, në pritje të rritjes të Karamoah, me “Champions League” në mes. Megjithatë, Depaj është një ëndërr e vjetër e Milanit. Kuqezinjtë e kanë ndjekur gjatë gjithë sezonit dhe kanë pasur disa herë kontakte me të. Teorikisht, ai është objektivi kryesor i skuadrës së Gattuso, por Milani nuk mund të bëjë asnjë lëvizje para se të marrë përgjigjen e UEFA-s për “fair play financiar”. Gjithsesi, derbi i Milanos për Depaj ka filluar.

PSZH i ofron Ronaldos rrogë të barabartë me Messin

Fjalët e Kristiano Ronaldos nga fusha e blertë e stadiumit të Kievit (ishte shumë bukur që të luaja me Real Madridin. Në ditët e ardhshme, unë do të flas...) nuk kanë rënë në vesh të shurdhër. Interesi është zgjuar për yllin portugez ndër klubet më të mëdha në Evropë. I pari që ka pasur dëshirë për të reaguar është PSZH. Klubi francez e dëshiron KR7 dhe ia ka transmetuar këtë Real Madridit, tashmë. Kampionët e Ligue 1 kanë një ëndërr të madhe, të kenë një “trident” sulmues me Ronaldo, Neymar dhe Mbappe. Parisienët i ofrojnë portugezit një pagë prej 45 milionë eurosh neto, shumë e barabartë me atë që merr Messi te Barcelona. Megjithatë, kjo



dëshirë e presidentit Al Khelaifi ka dy pengesa. Nga njëra anë, vetë Real Madridi, që nuk do ta shesë yllin e vet, por kjo vlen për aq kohë

sa ajo shërben për të hapur derën e daljes së Neymar drejt “Bernabeu”. Ronaldo ka një klauzolë 1.000 milionë euro, por çmimi që

duhet të paguajë PSZH nuk do të kalojë 150 milionë euro. Problemi tjetër për klubin francez, për të nënshkruar me Kristiano Ronaldo, është hulumtimi, i cili është dorëzuar nga Komiteti i Kontrollit Financiar të UEFA-s në vazhden e “dopingut financiar” të mundshëm në kontratat e tij të sponsorizimit. Një sanksion si ai, që mori në vitin 2014, do të reduktojë ndjeshëm mundësitë e klubit francez në tregun e transferimeve. Kavani, Guedes dhe Di Maria janë tre nga emrat, tashmë në dalje nga “Parc des Princes” për të rritur të hollat, por, në mënyrë që të përballet me nënshkrimin e Kristiano Ronaldos, duhet të shesë më shumë.



Publicitet

Në bazë të nenit 101 paragrafi 1 alineja 7 e Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e RM nr. 79/09,36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18) nenit 15 paragrafi 1 alineja 7 e Statutit të IP Qendra ndërkomunale për punë sociale e Qytetit të Shkupit, Këshilli drejtues pranë IP Qendra ndërkomunale për punë sociale e Qytetit të Shkupit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.05.2018, ka sjellë

VENDIM

Anullohet shpallja publike për zgjedhje të drejtorit të IP Qendra ndërkomunale për punë sociale e Qytetit të Shkupit

1. Anullohet shpallje publike për zgjedhjen e drejtorit të IP Qendra ndërkomunale për punë sociale e Qytetit të Shkupit, të publikuar më datë 28.05.2018 (e hënë), në gazetën ditore “Nova Makedonija”, “Sllloboden Peçat” dhe “Koha”.

2. Vendimi futet në fuqi në ditën kur sillet.

Kryetar i Këshillit drejtues
Vladimir Bislimovski

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. “7 korriku” nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar.

Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

MESSI MINIMIZON SHANSET ARGJENTINËS

NUK JEMI FAVORITË NË BOTËRORIN E RUSISË



Messi pohon se Argjentina nuk është ndër favoritët për ta fituar trofeun, edhe pse të besuarit e Jorge Sampaolit do të jenë në kërkim të Kupën së tretë Botërore

Lionel Messi "fut në frigorifer" shanset e Argjentinës në Kupën e Botës së kësaj vere, megjithëse këmbënguli se gjigantët e Amerikës së Jugut janë një ekip i madh dhe do të përballen me dinjitet në Rusi. Nënkampionia e Botës në fuqi, që doli e dyta në Botërorin e Brazilit, para katër viteve, Argjentina, i shtoi përgatitjet e saj për turneun e Rusisë, që starton muajin e ardhshëm, me një fitore rutinë prej 4-0, në Buenos Aires, të martën. Messi ishte hero në "La Bombonera". Kapiteni i Argjentinës dhe superstari i shë-

noi tre gola, i ndihmuar nga Sergio Aguero për ta kompletuar "pokerin" në këtë miqësore ndërkombëtare. Argjentina do të përballlet me Izraelin më 9 qershor, përpara se të shkojë kokë më kokë me Islandën, Kroacinë dhe Nigerinë në Grupin D të Kupës së Botës, ku kampionët kryesorë: Gjermania, Brazili, Franca dhe Spanja, janë ndër favoritët. Messi tha se Argjentina nuk është ndër favoritët për ta fituar trofeun, edhe pse të besuarit e Jorge Sampaolit do të jenë në kërkim të Kupën së tretë Botërore. "Unë jam

shumë mirënjohës për të gjithë njerëzit, kemi ndier gjithmonë mbështetjen e të gjithëve, jo si herë të tjera, që kemi marrë fyerje, —tha Messi, i cili me kombëtaren ka shënuar 64 gola. — Ne të gjithë shkojmë në Rusi për të njëjtën arsye, fitimin e Kupës së Botës. Kjo është ëndrra jonë, e vendit që përfaqësojmë. Ne nuk jemi favoritë, por jemi shumë të mirë. Po stërvitemi dhe përmirësohemi dita-ditës. Kemi lojtarë të mirë dhe po bëhemi më të fortë, për të luftuar si të barabartë me të gjithë", shtoi më tej ai.

Pesë herë fituesi i "Topit të Artë" shtoi më tej: "Në një Kupë Bote, logjika thuhet nuk materializohet kurrë. Ne duhet të synojmë të fitojmë ndeshjen e parë, e cila është më e rëndësishmja, sepse do të na japë paqe mendore. Askush të mos ketë dyshime se do të provojmë gjithçka, siç na pyesin gjithmonë njerëzit. Ne po shkojmë me një skuadër të madhe, që po bëhet e fortë edhe në nivel individual. Po përballemi me një mundësi të bukur dhe do të kërkojmë maksimumin", përfundoi Messi.

Brajant rrëfen sekretet e tij në një libër

Pasi shkëlqeu në karrierën e tij si basketbollist dhe pasi fitoi çmimin Oskar si producent i filmit vizatimor me metrazh të shkurtër, tani Kobe Brajant do të provojë aftësitë e tij edhe si shkrimtar. Ish-basketbollisti i Lejkers, 5 herë kampion në NBA, ka bërë me dije se këtë vit do të publikojë librin e tij me titullin "The Mamba Mentality: How I Play" (Mentaliteti i Mamba, ja se si kam luajtur). Libri që ka si autor Kobe Brajant do të dalë në shitje me 23 tetor, libër ku ish-basketbollisti reflekton për 20 vite karrierë si profesionist me Lakers. Në libër do të përfshihen edhe mjaft fotografi të shkrepura nga Andrew D. Bernstein, fotografi zyrtar i Lejkers. Ndërsa hyrja e librit do të mbajë firmën e një tjetër ikone të NBA-së, trajnerit Fil Xhekson dhe të ish-shokut të skuadrës Pau Gasol.



SIPAS FIZIOTERAPISTËVE TË LIVERPULIT

Sallah do të mungojë të paktën tre javë



Mohamed Sallah duhet të qëndrojë jashtë fushave për të paktën tre javë dhe y nuk është një lajm i mirë për Egjiptin në pritje të Kupës së Botërorit. Sulmuesi i Liverpoolit ka dalë mes lotëve për shkak të një dëmtimi në shpatull të pësuar në finalen e "Champions League" kundër Real Madridit dhe mund të mungojë në dy ndeshjet e para të Kupës së Botës. Ky lajm është dhënë nga Ruben Pon, një nga fizioterapistët e Liverpoolit për "LEquipe". Kështu, Sallah do të qëndronte jashtë fushave deri në 16 qershor dhe nuk do të mund të

luajë në ndeshjen e parë kundër Uruguait, që do të luhet më 15 qershor. Dy ndeshjet e tjera do të luhen më 19 qershor kundër Rusisë dhe 25 qershor kundër Arabisë Saudite. A do të arrijë të rikuperojë në kohë për ndeshjen e dytë apo do të jetë në dispozicion vetëm për ndeshjen e tretë dhe të fundit të grupeve? Hektor Kuper, shokët e tij të skuadrës dhe tifozët egjiptianë e shpresojnë me gjithë zemër. Do të ishte një humbje e madhe për Egjiptin, që do të kthehet të luajë në Kupën e Botës nga 1990-a, dhe për Botërorin.

Karius merr ofertë nga skuadra italiane e Serie C



Loris Karius nuk po kalon ditët më të mira të karrierës. Portieri i Liverpoolit ka qenë një nga protagonistët negativë të finales së "Champions League" kundër Real Madridit. Tani, në mënyrë të papritur, ka ardhur propozimi i një skuadre italiane për "Të Kuqtë": bëhet fjalë për Rimini, që sapo ka siguruar kalimin në Serie C, që ka ftuar Karius të transferohet në Romagna për një sezon. Presidenti i ekipit, Giorgio Grassi, i ka shkruar një letër portierit gjerman: "22 qershorin e ardhshëm, Loris Karius do të mbushë 25 vjeç. Do të më pëlqente ta

prisnim portierin gjerman për disa ditë në Rimini", lexohet në faqen zyrtare të Rimini-t. "Dua t'i bëj një dhuratë për ditëlindjen: një vit kontratë me Rimini FC, vendi ideal për të gjetur qetësinë e duhur dhe besimin në vete. Por duhet të jetë e qartë, nuk do ta ketë të lehtë, sepse do të luftojë për vendin e titullarit me një portier të madh si Françesko 'Ciçio' Skotti. Gjithsesi, do të gjejë një familje të madhe dhe një qytet që do ta mbështesë në mënyrë që të kthehet të jetë mes më të mirëve mes profesionistëve", shkroi Presidenti i ekipit, Giorgio Grassi.

Buffon merret vesh me PSZH, por gjithçka varet nga UEFA

Është gjithçka një çështje e mbyllur. Gjilanluigji Buffon i ka thënë po Paris Sen Zhermenn dhe ka gjetur akordin me drejtuesit e klubit francez për një kontratë 2-vjeçare nga e cila pritet të përfitojë 8 milionë euro në sezon. Edhe pse marrëveshja mes palëve është arritur prej disa ditësh martesë mes

tyre nuk mund të celebrimet ende për faktin se Buffon është në pritje të përgjigjes së UEFA-s, nëse do të skualifikohet ose jo për reagimin e ashpër që pati ndaj gjyqtarit Oliver në fund të sfidës ndaj Realit të Madridit në "Champions League". Nëse bëhet realitet frika më e madhe e Buffon që është një dë-

nim ekzemplar nga ana e UEFA-s atëherë kalimi i tij tek Paris Sen Zhermen mund të dështojë pasi 40-vjeçari italian po transferohet në Francë me një objektiv të vetëm të provojë sërish për të fituar trofeun e UEFA "Champions League", këtë herë me fanellën e PSZH pasi me atë të Juves nuk ia doli dot.

DASHI 21. mars - 20. prill
Përfitoni nga yjet që janë në anën tuaj sot për të marrë në dorë një situatë të pasigurt sentimentale dhe të bëni gjithçka për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme për marrëdhënien në çift! Nëse jeni vetëm dhe kërkon aventura, kjo ditë ofron shumë mundësi për ju. Në aspektin profesional sot është një ditë e rëndësishme për të realizuar objektivat tuaja.

DEMI 21. prill - 21. maj
Një ditë e vështirë për jetën tuaj personale. Marrëdhënia juaj në çift mund të përjetojë momente kritike, dhe do ju duhet të punoni shumë për t'i dhënë zgjidhje. Prania e Hënës, Marsit dhe Jupiterit i jep mundësi beqarëve për të pritur momentin e duhur me qetësi dhe durim për të krijuar lidhje. Në punë është mirë të jeni i kujdesshëm.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Dita e sotme për çiftet Binjakë do të jetë rutinë dhe pa lajme të rëndësishme. Nëse gjatë kësaj periudhe ju ka munguar dashuria dhe vëmendja e partnerit/es, sigurohuni të gjeni pikën kyçe ku çalon lidhja. Beqarët do kenë njohje të reja dhe do të tërhiqen nga një person. Në punë mos bëni hapa të rrezikshëm.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Dita nuk do të jete qetë, edhe pse me Hënën në shenjën tuaj ju nuk mund të gjeni dot një ekuilibër. Ju gjithashtu jeni mjaft të shqetësuar gjatë kësaj periudhe, kështu bëni mirë ta distancooni pak veten nga dashuria. Për beqarët do të jetë një ditë e paharrueshme, takimet do të jenë spektakolare! Me Marsin në Shigjetar mund të përqendrohni te puna me perspektiva të reja.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Ditë fantastike nga shumë pikëpamje. Jeta emocionale ju favorizon në shumë gjëra sot, veçanërisht rimëkëmbjen e marrëdhënies në çift. Ata që janë vetëm do të hedhin hapa të shpejtë për të krijuar një lidhje. Në punë mund të fitoni pikë të reja dhe të merrni përsëri në dorë frenat e disa situatave që dukej sikur i kishit lënë mënjanë.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Ju do të keni shumë mundësi për të rifituar kontrollin e ndjenjave tuaja. Romantizmi do të jetë në nivelin më të mirë duke ju falur shumë emocione në çift. Beqarët sot do të jenë më shumë se kurrë e gatshëm për të përballuar seriozisht njohjet e reja. Perspektiva juaj dhe qartësia mendore në punë do ju ndihmojnë të kryeni projektet tuaja.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Sot për ju do të jetë një ditë e qetë, por jo pa surpriza dhe kuriozitet. Do të përjetoni një marrëdhënie të shkëlqyer, dashuria me partnerin/en është e thellë dhe kjo ju mbush me gëzim! Nëse jeni vetëm, do të duhet të punoni shumë për të bërë arritje të reja. Nëse keni probleme në punë, së shpejti do t'i zgjidhni ato. Fitoni besimin e atyre që duan të punojnë me ju.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Yjet bëjnë gjithçka për të mundësuar një ditë të shkëlqyer për ju. Sot edhe ata që janë në një histori dashurie do të përjetojnë momente gëzimi të cilat do ju falin vetëm lumturi. Nëse jeni vetëm do të duhet të mendoni për situatën tuaj. Hiqni të gjitha pasiguritë. Ju jeni shumë të kualifikuar në punë, por duhet të hiqni dorë nga negociatat e vështira.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
E mërkura nuk parashikohet një ditë favorizuese për ju. Shmangni ekzagjerimet me fjalët që mund të përdorni gjatë një diskutimi me partnerin/en tuaj dhe përpiquni të mbani impulsivitetin përbrenda jush. Beqarët do të gjejnë sot kënaqësi në sport, aktiviteti fizik do t'ju bëjë mirë. Në punë do të bëni mirë të bashkëpunoni me kolegët tuaj.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Ndiqni imagjinatën tuaj dhe mos u kushtëzoni nga ndonjë situatë e pakëndshme që po përjetoni. Kjo gjë do të sjellë gëzim në marrëdhënien tuaj në çift. Beqarët do të jenë në gjendje të marrin stimuj të rinj nga një miqësi e re. Kreativiteti juaj në punë nuk do të mungojnë dhe yjet parashikojnë që do jeni shumë produktivë.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Me Hënën në kuadraturë rrezikoni të gaboni. Sot nuk do të jeni në gjendje të përqendrohni në konkretizimin e ndjenjave tuaja. Më mirë të prisni para se të merrni një vendim ju që jeni në çift. Beqarët do tregohen të hapur ndaj ftesave për takime. Stabiliteti juaj i fituar në punë do t'ju ndihmojë të rrisni të ardhurat.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Mundohuni të ruani qetësinë në jetën tuaj edhe nëse jeni duke përjetuar një histori dashurie të pakënaqshme. Ndoshta së shpejti çdo gjë ndryshon dhe lumturia do të kthehet! Emocione të bukura po vijnë edhe për beqarët, me hijeshinë tuaj do të bëni për vete shumë persona. Hëna e favorshme sot ju ndihmon të ndiheni më të përgatitur për t'u përballur me vështirësitë në punë.

Mensur Mamuti	RITËM KOMEDIANI ANGLËZ, ATKINSON	T	MONEDHA BRITANEZE I PAPAËSTËR	F	BANKING INDUSTRY ARCHITECTURE NETWORK	QYTET NË SHBA, AFER NJU JORKUT	LUMË NË AUSTRI	KALIUMI	SËMUNDJE E MENJËHERSHME DHE E RËNDË	KOHA										
SHTETI MË JUGOR IAFRIKËS (FOTO 1)																				
BRIT. E SHPALLI R.J.A. NË VITIN 1910 (SUVERENITET)								NDAJFOLJE PYETËSE												
								THEMELUESI I QENDRËS EVROPIANE NË VITIN 1652												
								ANË E BOTËS QË LËSHON ERË TE MIRE												
QYTETI I QENDRËS SË PARË TË FRIKËS SË JUGUT, MË 1652																				
NEGACION (HUAJ)			GJALLËRISHËM (MUZIKË)																	
											TETOVA E VJETER, ENEUMI									
											RADIO VALE							FLUORI NATO (FRENGJ.)		
											PARAARDHËS IZELANDËS SË RE									
											"KUNDËR"									
											KOHA		KANCER FURKË, PAJANDËR							
ARMË SHPËRTHYËSE																				
SHKRONJAT E PARA THIRRJE TELEFONIKE								AZOTI QË NGRIHET NATEN NGA VARRI												
KOHA	VË KËMBËN NË TOKË	QYTET NË SHQIPËRI FABRIKA E AUTOMJETEVE E MARIBORIT	B	RENDI	NGUTJE, NXITIM															
THAHET (LUMI)					KTHESA, LAKORJA AKTORI AUSTRALIAN, BILL					KALI ISHALËS										
VENDROJË								GALIUMI MELIHATE AJETI												
SHTETI, NËN KOLONINË E SË CILËS ISHTE SHTETI JUGOAFRIKAN, BRITANIA... (2)								NËNAT IMPULSI												
LITRI		SEKT I VEÇANTË FETAR I MUSLIMANËVE																		

ZGJIDHJET: T, F, REPUBLIKA J, DOMINION, KU, KAPSTAD, JUG, NO, ANIMATO, ENEA, RV, F, MAOR, ANTI, RAK, MINA, AB, N, B, AXHELE, SHTER, LAKU, KARAKOLL, GA, F, MADHE, ËMAT, L, TARIKATI.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

3		2	1			8		4	6	5			8	4		7	1	
1	4			2				3	9	3				5			4	
											7					9		
			1	3		2			6	7					1		2	
		2						4										
6			9		1	5				1	9		2				3	8
											6						5	
7	3			5				9	1	5				9				3
5		6	8			4		7		2	3			7	8		6	9

Shumë i lehtë: 372195864, 145628739, 869437215, 451372986, 927586143, 683941572, 214769358, 738254691, 596813427. Mesatar: 659384271, 312759684, 874612395, 783961542, 425837916, 196245738, 968423157, 547196823, 231578469.

Çdo i dyti shqiptar shpenzon më shumë sesa fiton

Pak më shumë se gjysma e shqiptarëve shpenzojnë më shumë para se që kanë të ardhura, thotë një studim i fundit i Bankës Qendrore të Spanjës. Ky studim titullohet "anketa e kompetencave financiare" dhe tregon se, 54% e shqiptarëve deklarohen se gjatë 12 muajve të fundit, shpenzimet e tyre kanë qenë më të larta se të ardhurat. Te të ardhurat ndërkohë hyjnë të gjitha, pra veç pagës edhe të ardhurat nga remitencat, qiratë apo burime të tjera. Ndërkohë më pak se gjysma e atyre që janë në deficit, pra që shpenzojnë më shumë se ç'fitojnë, ose më saktë 41% e tyre, deklarohen se e



financojnë këtë deficit nëpërmjet borxhit. Ky borxh mund të jetë si në formën e kredive bankare, ashtu edhe në formën e huamarrjes ndaj të afërmeve apo miqve. Përqindja i referohet në të gjitha rastit totalit të popullsisë dhe jo vetëm popullsisë së rritur, gjë që i bën edhe më alarmante shifrat. Shqipëria është një ndër të paktat vende të marra në analizë, dhe e vetmja në Ballkanin Perëndimor, kështu që raporti nuk ofron

një bazë krahasimore me të ngjashmit. Gjithsesi në raport me vendet e tjera të Evropës, me 54% të popullsisë në deficit, Shqipëria ofron normën e tretë më të lartë në Evropë, pas Gjeorgjisë dhe Bjellorusisë. Ndër të tjera, mesatarja e vendeve të marra në analizë fiksohet në 35%, mesatarja e vendeve të OECD në 28% dhe mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian në 27%, pra saktësisht sa gjysma e normës së Shqipërisë.

Starbucks mbylli 8000 lokale, dërgon punonjësit në trajnim për racizëm



Zinxhiri amerikan i kafeneve Starbucks ka mbyllur dje mbi 8000 lokale në SHBA, për t'u mundësuar punonjësve të kalojnë trajnimin për paragjykimet racore. Pas incidenteve të prillit, kur dy burra të zinj u arrestuan në një nga vendet e Starbucksit në Filadelfia, udhëheqësit e kompanisë kërkuan falje dhe u takuan me dy burrat, por gjithashtu morën ekspertë për të formuluar një plan trajnimi të detyrueshëm për 175.000 punonjës për paragjykimet racore.

Pse nuk duhet t'u jepni hua familjarëve apo miqve

Çka do të bënit po të merrnit një kërkesë për t'i dhënë hua para një miku apo një familjari? Ka shumë arsye përse atyre mund t'u duhen paratë dhe ju premtojnë se do t'i kthejnë në periudhë të shkurtër, sepse do të marrin pagën apo po presin para të tjera. Megjithatë, një studim i ri i kryer në Irlandë ka treguar se rreth 385 milionë euro të dhëna hua mes miqve dhe familjes kanë mbetur të paguara. Shuma mesatare që një person ka huazuar e që nuk e ka kthyer prapa është 216 euro. Edhe më keq janë disa shtete tjera, si Britania e Madhe e Amerika. Në Britani 10 për qind e borxheve totale të njerëzve janë nëpër familjarë me mesatare të shumës së pakthyer prapa prej 415 funteve. Në SHBA, 184 miliardë dollarë janë të huazuara nga "Banka e Familjes dhe Miqve" çdo vit. Këto shifra kanë treguar po ashtu se borxhet që s'po kthehen po shkaktojnë probleme mes miqve e familjarëve. Sipas një organizate që merret me borxhet, 33 për qind e njerëzve që



kanë hyrë në këtë organizatë, kanë raportuar për probleme se kanë marrë para nga miqtë apo të afërmit, 16 për qind kanë thënë se marrëdhëniet me huadhënësin kanë ndikuar në familje dhe 3 për qind kanë pranuar se lidhja me mikun apo familjarin është prishur tërësisht. "Limerick-leader" shkruan se problemi kryesor për moslarje të borxheve është te huadhënësi që i thotë huamarrësit se "mi kthe kur të kesh mundësi". Sipas këtij shkrimi, duhet patjetër që huadhënësi t'ia caktojë një periudhë kohore për kthimin e parave, ose të paktën që të kryejë pagesat përgjatë një periudhe në disa këste.

Revolucioni i Coca-Cola, shet pije alkoolike në Japoni



Coca-Cola ka nisur për të parën herë në histori prodhimin e pijeve alkoolike, që korenspondon me një pije alkoolike me limontë hedhur në treg në Japoni. Kjo është një përpjekje për të kapur tregje dhe konsumatorë të rinj. E para në botë në tregun gjigant të pijeve, kompania nga SHBA shiti tre pije me limon të lëngshëm të hënën, duke i dhënë jetë revolucionit të

saj. Produkti synon një treg në rritje të "pijanecëve" të rinj, sidomos grave. Të përshkruara nga Coca-Cola si "unike" në historinë 125-vjeçare të kompanisë, të tre pijet alkoolike të prodhuara kanë nga 3% deri në 8% alkool. Në përputhje me traditën e kompanisë, receta është e ruajtur me kokfortësi, por pijet janë modeluar në bazë të pijes popullore Chu-Hi të

Japonisë, zakonisht një përzjerje e shpirtit lokal dhe një sërë aromash frutash. Chu-Hi, një shkurtime për "shochu highball", janë shitur si një alternativë për birrën, duke u provuar veçanërisht në masë të gjerë tek femrat. Kompanitë lokale si Suntory, Asahi dhe Kirin aktualisht dominojnë sektorin për pije të konservuara Chu-Hi. Shijet më të njohura janë agrumet e forta si grejpfrut ose limon, ndërsa kjo e fundit është shija që Coca-Cola tani dëshiron të shpërndajë duke vendosur diktatin në treg. Coca-Cola thotë se nuk ka plane për të nxjerrë pijet e reja në tregjet jashtë Japonisë. Pijet Alcopop boomed në Evropë dhe në Mbretërinë e Bashkuar në vitet 1990, por edhe Smirnoff Ice dhe Bacardi Breezer u bënë jashtëzakonisht popullore. Ato ishin të diskutueshëm dhe inkurajuan të rinjtë për të pirë më shumë alkool për shkak të shijes së butë.

70 - Romakët pushtojnë murin e parë të Jerusalemit.

1564 - Beteja e Gotlandit: Lubeku dhe Danimarka mundin Suedinë.

1659 - Holanda, Anglia dhe Franca nënshkruajnë Traktatin e Hagës.

1665 - Rabini i Jerusalemit Sabatai Zevi shpall veten Mesi.

1727 - Franca, Anglia dhe Holanda nënshkruajnë Marrëveshjen e Parisit.

1759 - Provinca e Pensilvanisë ndalon të gjitha prodhimet teatrale.

1847 - Hapet hekurudha Rotterdam-Hagë.

1879 - Hapet Madison Square Garden.

1923 - Kina dhe BRSS këmbëjnë diplomatët.

1937 - Anijet luftarake të Gjermanisë bombardojnë Almerinë në Spanjë.

1961 - Xhon Kenedi viziton Charl de Gol në Paris.



Shkrimet e para për liqenin rozë në ishullin Middle në Australi datojnë nga viti 1802, kur hidrografi britanik Matthew Flinders arriti në ishull gjatë rrugës së tij drejt Sydneyt. Gjatë shekullit 19, ishulli Middle u vizitua edhe nga gjuetarë të fokave dhe balenave. Një grup shkencëtarësh në vitin 1950 kërkoi shkaqet pse liqeni Hillier ka ngjyrën unike rozë. Mostrat nga uji i liqenit nuk përmbajnë gjurmë të algave, të cilat u japin ngjyrë ujit, transmeton ksp. Megjithatë, spekulohet se ngjyra rozë e liqenit është rezultat i sasisë së lartë të kripës dhe pranisë së bakterit rozë - halobakteri. Për dallim nga liqenet tjera që ndryshojnë ngjyrën në pajtim me temperaturat, liqeni Hillier gjatë gjithë vitit ruan ngjyrën e njëjtë.

BURRI DHE PSIKIATRI

I ankohet burri psikiatrit:

- Më ndihmo doktor, nuk mund ta shoh më me sy gruan time!
- Po e shoh se paskan përfunduar ditët e mira në lidhjen tuaj. Gjërat do të bëhen keq e më keq. Mendoj se do t'ju ndihmonte nëse shkoni në det.
- Jo bre doktor. E keqja është se ajo di not.



Breshka, gomari dhe prindi kanë fatin të mbajnë samarin tërë jetën në shpinë. (Dritëro Agolli)